LIBRË

E

SHËRBESAVE TË SHËNTA

TË

KISHËS ORTHODOXE

KTHYER NGA GËRQISHTIA

PREJ

PRIFTIT ORTHODOX FAN S. NOLI

BOSTON, MASS.

1909

ВКЭН

LIBRË

E

SHËRBESAVE

TË SHËNTA

TË

KISHËS ORTHODOXE

KTHYER NGA GËRQISHTIA

PREJ

PRIFTIT ORTHODOX FAN S. NOLI

BKSH

BOSTON, MASS.

1909

BKSH

SHËNTËRISË SË TIJ

KRYEPESHKOPIT DHE ATIT T'IM

IMZOT PLATON

SI SHËNJË REVERIMI DHE MIRËNJOHJEJE

KËTË VEPRË I DEDIKOJ

KTHENJËSI

BKSH

BKSH

PARËTHËNJE

Po u fal Shqipëtarëve Orthodoxë këtë librë e cila ësht' e dyta, dhe pandeh që përdorja e saj do t' i siellë një shërbim vëndit tonë. I kam dhënë zotim kombit t' im t' u ap vëllezërve të mi bashkëfetarë librat më të nevojshime për të praktikuar faljen e tyre më gjuhën kombëtare, dhe zotimin t' im do t' a mbaroj ndofta brënda në pak kohë, në qoftë se Shqipëtarët janë gatî të më ndihin, sikundër më ndihnë më të shtypurit e këtyre dy librave.

Më të kthyer të kësaj libre u-përpoqa të mos largohem nga texti gërqisht dhe besoj që u dhashë Shqipëtarëve një kthim exakt të lutjeve të kishës Orthodoxe. Natyrisht, nukë munt të mbetesha i kënaqur nga kthimet e vietëra të atdhetarit të shkëlqyer Z. K. Kristoforid, dhe u-përpoqa t' i ndreq atô që hynë në këtë librë pas përparimit që ka bërë gjuha shqipe që nga koh' e tij, pa mohuar që pun' e tij qe një ndihmë dhe themelî për mua.

Shtova dhe ca hymne të Lutjesores si dhe Zbritësoret e Motit, të cilat janë shumë të nevojshime nga që thohen po-thua-se ç' dô të Dielë.

Shpërej se shpejt do t' kupëtohet nevoja e librave të tiera që po pregatit, dhe kiô gjë do t' më bëjë të punoj me më shumë mall e qëndrim.

KTHENJËSI.

PREGATITEN KËTÔ TRI LIBRA :

1. Libr' e të kremteve të motit.
2. Triodi dhe Pesëdhjetorja.
3. Apostujtë dhe Ungjijtë që thohen të Dielave dhe të kremteve.

Ndihma për këtô libra dërgohen në këtë drejtim :

Rev. Fan S. Noli
28 Park sq.
Boston, Mass., U. S. A.

BKSH

SHËNTËRIA E TIJ
IMZOT PLATONI

BKSH

MBRËMËSORE

Der' e Bukur hapet, Prifti qëndron përpara Alltarit me Temianicën dhe Diaku me birinë.

DIAKU nis :

Ngre-u, ô Zot, bekô.

Dhe PRIFTI thotë :

Lavdî Trinisë së Shëntë, së Bashkëqënurshme, Jetëdhënëse dhe së Pandarë, për gjithmonë, tanî e përherë e në jetë të jetëve.

VALLEJA përgjigjet :

Amen.

Prifti temianis tërë Kishën dhe njerëzinë kur këndohet Psalmi Nisëtor (104), dhe passi mbaron së temianisuri qëndron përpara Derës së Bukur karos dhe thotë pshehtazi Urimet e Dritës.

KËNDONJËSI thotë :

Ejani t' i falemi e t' i biem nër këmbë Perëndisë, Mbretit tonë.

Ejani t' i falemi e t' i biem nër këmbë Krishtit, Perëndisë dhe Mbretit tonë.

Ejani t' i falemi e t' i biem nër këmbë vetë Krishtit, Perëndisë dhe Mbretit tonë.

PSALM 104.

Bekô Zotin, ô shpirti im. O Zot, Perëndia ime, fort tepër u-madhove ; je veshur me nder e me madhë-

rî. Ti që heth përmi vetëhe dritën posi robë ; ti që shtrin qiellin posi kurtinë : Ay që ndërton dhomat e tija të lartat nd' ujërat : bën retë qerret e tij dhe ecën mi fletët e erës : Bën ëngjëjt' e tij frymëra dhe meshëtarët e tij flagë prej ziarri.

Ay që qëndroj dhenë mi themelit' e saj që të mos tundet jetë pas jete. E mbulove me avushën, posi me robë : ujërat qëndruan mi malet. Prej qërtimit tënt iknë : prej zërit të bubullimës s'ate u-hoqnë me nxitim : Hipnë mi malet, zbritnë ndë fushat, n' atë vënt që i themelove. Vure kufî që nuk do t'a kapërxejnë, as do të kthehen për të mbuluar dhenë. Ay që dërgon burime nër përrënjtë që të shkojnë për mes maleve : Pinë ujë gjith' egërsirat e fushës : gomarët e egër shuajnë etjen e tyre : Pranë atyre kanë të ndënjurit shpest' e qiellit, edhe apin zë në mes të degave. Ay vadit malet prej vëndeve të tij të larta : dheu nginjet nga pemët e punëve të tua. Ay që bën të mbijë bar për bagëtinë, dhe barishtë per shërbimin e njerësve, që të nxierë bukë prej dheut ; edhe verë që gëzon zëmërën e njeriut, vaj për të ndritur faqen dhe bukë që forcon zëmërën ë njeriut. U-nginjnë drut' e Zotit : dëllinjat e Libanit që mbolli : Atje ku bëjnë folê zoqtë : sa për shtërkun, bredhat janë ndënjia e tij. Malet e lartë për dhit' e egëra ; gurët janë pështetje për lepurat.

Bëre hënën për motet : dielli njeh të perënduarit e tij. Lëshon errësirë e bëhet natë ; n' atë shkojnë gjith' egërsirat e pyllit. Këlyshët e luanëve ulërijnë

për të rrëmbyer, e për të lypur prej Perëndisë ushqimin e tyre : Len dielli ; hiqen më nj' anë edhe bien e flenë ndëpër shtrofkat e tyre : Del njeriu në punën e tij dhe në mundimin e tij gjer mbrëmanet.

Sa u-madhuan punët e tua, ô Zot ! të gjitha i bëre me urtësî ; dheu është plot me kriesat e tua : Ay det i math e i gjerë ; atje janë shtërpënj që s' kanë numër, shtaza të vogëla bashkë me të mëdha : Atje shkojnë lundra : atje është Leviathani që krijove për të luajtur ndë të. Gjithë këtô shpërejnë më ty që t' u apësh ushqimin më kohë. Atë që u ep, e mbledhin ; ti hap dorën, atô nginjen së mirash : Ti kthen faqen më nj' anë, atô përzihen : u ngre frymën, shuhen, edhe kthehen në baltë të tyre : U dërgon frymën tënde, ndërtohen, edhe përsërit faqen e dheut.

Qoftë lavdi' e Zotit për gjithë jetën : u-gëzoftë Zoti për punët e tija. Ay që shtie sytë mi dhet, edhe dridhet : ayprek malet, edhe nxierin tym. Do t' i këndoj Zotit sa të rroj ; do t' i psall Perëndisë s' ime sa të jem. Mëndimi qoftë i ëmbël përpara tij : unë do t' gëzohem për Zotin. U-shofshin fajtorët prej dheut edhe të paudhët mos qofshin më. Bekô Zotin, ô shpirti im. (Prapë.) Dielli njeh të perënduarit e tij. Lëshon errësirë e bëhet natë.

Sa u-madhuan punët e tua, ô Zot ! të gjitha i bëre me urtësî.

Lavdî Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Alleluia, alleluia, alleluia, lavdî ty ô Perëndî *(tri herë)*, ô Zot, shpresa jonë, lavdî më ty.

Passi mbarohet Psalmi Nisëtor, thotë Litanin' e madhe DIAKU, ose në mos pastë, PRIFTI :

Më paqje le t' i lutemi Zotit.

VALLEJA :

Mëshirô, ô Zot.
Për paqjen që lartazi...
(Shëkô në Meshë.)

PRIFTI me zë të lartë :

Se ty të ka hie ç' do lavdî, nderim dhe adhurim, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

VALLEJA :

Amen.

Pastaj këndohet Kathism' e parë e Psalterit « Lum' ay njeri ».

Pas Kathismës thohet Litani' e Vogël.

Përsërî dhe përsërî, më paqje le t' i lutemi Zotit.

VALLEJA :

Mëshirô, ô Zot.
Përkrah-na, shëptô-na... (Shëkô ne Meshë.)

BKSH

PRIFTI me zë të lartë :

Se jotja është lart-madhësia, dhe jotja është mbretëria, edhe fuqia, edhe lavdia, e Atit, e Birit, dhe e Shpirtit Shënt, tanì e përherë, e në jetë të jetëve.

VALLEJA :

Amen.

Pastaj këndohen *Thirrëtoret* me Troparet e tyre të ditës, pas Tingëllit që të goditë ; në këtë mes, Diaku merr temianicën dhe, passi kërkon bekimin e Priftit, temianis Shëntëroren dhe Kishën.

VALLET këndojnë : Psalm 141.

O Zot, thirra te ty, dëgjô-më, dëgjô-më, ô Zot. O Zot, thirra te ty, dëgjô-më, vër re zën' e lutjes s' ime ; më të thirrurit t' im te ty, ô Zot, dëgjô-më.

Le të vijë falja ime përpara teje si temian, dhe ngritja e duarve të mia si therore e mbrëmëshmë. Dëgjô-më, ô Zot.

Vër ruajtje në gojë t' ime, ô Zot : ruaj derën e buzëve të mia.

Mos përvar zëmërën t' ime më fialë të këqia që të vepëroj punë të këqia.

Bashkë me njerës që punojnë paudhësî ; dhe do t' mos ha nga gjellët e zgjedhura të tyre.

Le t' më mundojë i drejti me përdëllim dhe do t' më qërtojë ; po vaj mëkatari mos leftë kryet t' im.

Se, edhe kur të jenë ndë të keq, do të falem për

tâ. Gjykatësit e atyre, kur të hidhen në gurishta. Do t' dëgjojnë fialët e mia, se janë t' ëmbla. Eshtërat tona janë përndarë ndë gojë të Ferrit, sikur ndonjë lëron e çan dhenë.

Përandaj syt' e mî janë më ty, ô Zot Perëndî ; më ty shpëreva, mos ler shpirtin t' im të shkretë.

Ruaj-më prej kurthit, që ngritnë për mua dhe nga shkandullat e atyre që punojnë paudhësî.

Fajtorët rënçin nër rietat e tyre, kur të shkoj unë m' at' anë.

PSALM 142.

Me zënë t' im thërres më Zotin ; me zënë t' im i lutem Zotit.

Do të derth lutjen t' ime përpara tij ; do t' dëftoj hidhërimin t' im përpara tij.

Kur m' u-zû fryma, atëhere ti njohe udhët e mia.

Më udhën që barisnja, fshehnë kurth për mua.

Vështronja më të diathtë dhe shëkonja, dhe s' kish nonjë që të më njohë.

Mpshtetja humbi prej meje, s' ka ndonjë që të kërkojë shpirtin t' im.

Thirra më ty, ô Zot ; thashë : Ti je shpresa ime, piesa ime te dheu i të gjallëve

Mbaj-i vesh lutjes s' ime, se u-përunja fort tepër.

Shpëtô-më prej ndjekësve t' im, se janë më të fortë se unë.

VALLET këndojnë dhietë Tropare, duke u vënë përpara këtâ Vargje :

Nxir shpirtin t' im prej burgut që të lavdëroj emërin t' ënt.

Të drejtët do t' më kërkojnë kur të më bësh të mirë.

PSALM 130.

Prej së thellash klitha më ty, ô Zot ; ô Zot, dëgjô zënë t' im.

Veshët e tû le t'i kenë kujdes zërit të lutjes s' ime.

Po të vësh re paudhësitë, ô Zot, ô Zot, kush munt të qëndrojë ? po pranë teje është ndjesa.

Për emërin tënt të prita, ô Zot ; shpirti im priti fialën tënde ; shpirti im shpëreu më Zotin.

Prej ruajtjes së mëngjezit gjer më natë ; prej ruajtjes së mëngjezit le të shpërejë Israeli më Zotin.

Se ka përdëllim te Zoti dhe shumicë çpërblimi ; dhe ay do t' çpërblejë Israelin prej tërë paudhësive të tij.

PSALM 117.

Lavdëroni Zotin tërë kombet, nderojeni tërë popujt.

Se përdëllim' i tij u-fuqisua përmi ne, dhe e vërtet' e Zotit mbetet në jetë. — Lavdî, e tanî...

Kur këndohet Tropar' i fundit, Diaku merr Temianicën, del jashtë bashkë me Priftin nga der' e Veriut, me manalë përpara ;

dhe venë e qëndrojnë përpara Derës së Bukur. DIAKU, passi unjet, i thotë Priftit me zë të unjët :

Le t' i lutemi Zotit.

PRIFTI thotë këtë
Urim të Hyrjes :

Mbrëmane, dhe në mëngjest, dhe më drekë, të lëvdojmë, të bekojmë, të përhirojmë e të lutemi, ô Zot i gjithësisë. Drejtësoj-e faljen tonë si temian përpara teje, dhe mos i përvar zëmërat tona më fialë, a më mejtime ligësie, po shpëtô-na prej gjith' atyre që gjuajnë shpirtet tona ; se më ty janë kthyer sytë tanë, ô Zot, ô Zot, dhe më ty shpresuam ; mos na turpërô, ô Perëndia jonë. Se ty të ka hie ç' do lavdî, nderim dhe adhurim, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tani e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Pas Urimit, DIAKU thotë :

Bekô, ô Zot, Hyrjen e Shëntë.

Dhe PRIFTI bekon nga Lindja, duke thënë :

E bekuar është Hyrja e Shëntorëve tënt, për gjithmonë, tani e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

DIAKU, passi mbarohet së-kënduari Tropar' i fundit, bën shënjën e kryqit me Temianicën dhe thotë :

Urtësî, ô të drejtë !

Hyjnë që të dy në Shëntëroren, Prifti dhe Diaku. Diaku temianis Alltarin e Shëntë.

VALLEJA këndon :

O Dritë gazmore e lavdisë së shëntë të Atit të pavdekshim, qiellor, të shëntë, e të lumur, Jesu Krisht. Me qëndë që arrimë më perëndimin e diellit dhe shëkojmë dritën e mbrëmëshme, hymnojmë Atin, Birin, edhe Shpirtin Shënt, Perëndinë. Se të ka hie të hymnohesh më ç' do kohë me zëra të mbara, ô i bir' i Perëndisë, që fal jetë ; përandaj dhe bota të lavdëron.

DIAKU :

Parëvargu i Mbrëmës.

Në qoftë e Shtunë mbrëma, thohet kiô :

Zoti mbretëroj u-vesh me mirhiesî.

(Tri herë.) Prifti kthehet nga Perëndimi, me duartë të lidhura dhe qëndron duke pritur të mbarohet Parëvargu ; pastaj falet dhe vete më vëntt të tij. Pas Parëvargut, thotë DIAKU Litanin' e Gjerë :

Le të thomi të gjithë me gjithë shpirtin dhe me gjithë mëndjen tonë le të thomi.

VALLEJA :

Mëshirô, ô Zot. (Tri herë).

O Zot i tërëfuqishim, Perëndî e Atërve tanë...

(Shëkô në Meshë.)

PRIFTI me zë të lartë :

Se ti je Perëndi mëshirëplote dhe njerzidashëse dhe ty të dërgojmë lavdî, Atit ..

VALLEJA :

Amen.

VALLEJA, ose PRELATI :

Vlerësô-na, ô Zot, këtë mbrëmë të ruhemi pa nonjë mëkatë.

I bekuar je, ô Zot, Perëndi' e Atërve tanë ; dhe emëri yt ësht i kënduar dhe i lavdëruar më jetët. Amen.

Le të jetë, ô Zot, përdëllimi yt mi ne, sikundër kemi shpresuar mi ty.

I bekuar je, ô Zot, mësô-më të drejtat tënde.

I bekuar je, ô Zot, bë-më të mënçim me të drejtat tëndë.

I bekuar je, ô Shënt, ndriçô-më me të drejtat tënde.

Ty të ka hie lëvdatë, ty të ka hie hymnë, ty të ka hie lavdî, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

DIAKU :

Le t' i a mbarojmë faljen tonë të mbrëmëshme Zotit.

VALLEJA :

Mëshirô, ô Zot.

Përkrah-na, shpëtô-na, mëshirô-na dhe ruaj-na, ô Perëndî, me hirë tënt.

Mbrëmën të tërë, të mbarë, të shëntë, të paqëshme dhe të pamëkatëshme, le t' i lypim Zotit.

VALLEJA :

Fal-na, ô Zot.
Engjëll paqjeje,... (Shëkô në Meshë.)

PRIFTI me zë të lartë :

Se ti je Perëndî e mirë dhe njerzidashëse dhe ty të dërgojmë lavdî, Atit,...

VALLEJA :

Amen.

PRIFTI :

Paqje mi ju te gjithë.

VALLEJA :

Dhe me frymën tënde.

DIAKU :

Krerët tanë le t' i a unjim Zotit.

VALLEJA :

Ty, ô Zot.

Urim' i Krye-unjtjes.
PRIFTI e këndon fshehtazi.

O Zot, Perëndia jonë, që epe qiejtë dhe zbrite për shpëtimin e gjindjes së njerësve, hîth synë mi shërbëtorët e tû dhe mi trashëgimin tënt. Se ty

BKSH

Gjykatësit të trëmpshim e njerzidashës, t' i përunjnë krerët shërbetorët e tû, dhe të subjektuan xverqet e tyre ; duke mos pritur ndihmën që vien prej njerëzish, po përdëllimin dhe shpëtimin tënt, të cilët ruaj-i më ç' do kohë, dhe më këtë mbrëmë dhe më natën që vien, prej ç' do armiku, prej ç' do vepërimi kundrështar të diallit, prej mejtimesh të kotta, dhe prej kujtimesh të liga.

PRIFTI me zë të lartë :

Qoftë pushteti i mbretërisë s' ate i bekuar dhe i lavdëruar, i Atit,...

VALLEJA :

Amen.

Pastaj thohen Pasvargjet, pas të cilave thotë PRIFTI Këngën e Simeonit Hyjpritës :

Tani përlëshoj-e shërbëtorin tënt më paqje, pas fialës s' ate ; se syt' e mî panë shpëtimin tënt që pregatite përpara faqes së gjithë popujve ; dritë për të ndriçuar paganët dhe lavdî të popullit tënt Israel.

Pastaj :

Shënt Perëndî, Shënt i Fuqishmë,...
Trinî e Tërëshëntë...
Ati ynë...

PRIFTI :

Se jotja është mbretëria, edhe fuqia, edhe lavdia, e Atit, e Birit,...

VALLEJA :

Amen.

Pastaj thonë Troparet e ditës, dhe pas atyre PRIFTI bën Përlëshimin :

Bekim' i Zotit le të vijë mi ju, pas hirit dhe njerzidashjes së tij, për gjithmonë, tanî e përherë e në jetë të jetëve. Amen.

Lavdî ty, ô Krisht Perëndî, shpresa jonë, lavdî më ty.

POPULLI :

Lavdî Atit,... Tanî e përherë...
Mëshirô, ô Zot. (Tri herë).

DIAKU :

Bekô, ô Atë.

PRIFTI :

Krishti, Perëndia jonë e vërtetë, me nërmjetimet e Emes së tij së papërlyme e të Shëntë ; dhe të gjithë Shëntorëve, na mëshiroftë e na shpëtoftë si i mirë dhe njerzidashës. Amen.

SHËRBES' E MENGJEZIT

PRIFTI thotë :

E bekuar është Perëndia jonë përgjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

VALLEJA :

Amen.

Shënt Perëndî, Shënt i Fuqishmë, Shënt i Pavdekur, mëshirô-na. (Tri herë.)

Lavdî Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Trinî e Tërëshëntë, mëshirô-na. O Zot, hirësoj-i mëkatat tona. O Zot i Math, ndjej-i paudhësitë tona. O i Shëntë, vështroj-i dhe shëroj-i sëmundjet tona, për emërin tënt.

Mëshirô, ô Zot. (Tri herë.)

Ati ynë që je ndë qiell, u-shëntëroftë emëri yt. Arthtë mbretëria jote, u-bëftë dëshira jote si ndë qiell edhe mbi dhê. Bukën tonë të përditëshme epna-e neve sot; edhe fal-na-i fajet sikundër edhe ne u a falim fajtorëve tanë ; edhe mos na shtjer ndë ngasje, po shpëtô-na nga i ligu.

PRIFTI :

Se jotja është mbretëria, edhe fuqia, edhe lavdia, e Atit, e Birit,...

VALLEJA :

Amen.

Pastaj këtô Tropare.

O Zot, shpëtô popullin tënt dhe bekoj-e trashëgimin tënt. Dhuroj-u besëmirëve mundje kundër barbarëve dhe ruaj-e shtetin tënt me anën e Kryqit tënt.

Lavdî Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt.

Ti, që u-lartove më Kryqin duke dashur, shtetit të ri që ka emërin tënt dhuroj-i mëshirimet tënde, ô Krisht Perëndî. Ngazelloj-i me fuqinë tënde mbretërit tanë besnikë, duke u falur mundje kundër armiqve. Paçin bashkëluftimin tënt si armë paqjeje, tropê te pamundur.

Tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Mprojtesh' e trëmpshime dhe e paturpëruar, mos i çpërhith kërkimet tona, ô e mirë, e tërë-lavdëruar Hyjlindëse : Mpshtet-e shtetin e Orthodoxëve, shpëtoj-i atâ që i urdhërove të mbretërojnë dhe dhuroj-u mundjen nga qiejtë. Se ti linde Perëndinë, ô e vetëm e bekuar.

PRIFTI :

Mëshirô-na, ô Perëndî, pas mëshirës s' ate së madhe, të lutemi, dëgjô, e mëshirô.

VALLEJA :

Mëshirô, ô Zot. (Tri herë.)

Të lutemi dhe për Shën-Sinodin (ose Patriknë) ;

dhe për Peshkopin tonë (ose Kryepeshkopin a Metropolitin)... (Aksh.)

VALLEJA :

Mëshirô, ô Zot. (Tri herë.)

Të lutemi dhe për tërë vëllezërit tanë dhe për tërë të Krishterët.

VALLEJA :

Mëshirô, ô Zot. (Tri herë.)

Me zë të lartë.

Se ti je Perëndî mëshirëplote dhe njerzidashëse dhe ty të dërgojmë lavdî, Atit,...

VALLEJA :

Bekô, ô Atë, më emërin e Zotit.

PRIFTI me zë të lartë :

Lavdî Trinisë së shëntë, së bashkeqënurshme, jetëdhënëse, dhe së pandarë, për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

VALLEJA

Amen.

Pastaj thohen Gjashtë Psalmet me vërejtje dhe frikë Perëndie. PRIFTI thotë Urimet e Mëngjezit, duke qëndruar përpara Derës së Bukur karos, pas tri Psalmeve të parë.

KËNDONJËSI :

Lavdî Perëndisë më të lartat dhe mbi dhenë paqje dhe mi njerëzit mirëdashje. (Tri herë.)

BKSH

O Zot, çel-m' i buzët dhe goja ime do t' lajmërojë lavdinë tënde. (Dy herë.)

PSALM 3.

Zot, sa u-shumuan atâ që më shtrëngojnë ! Shumë veta ngrenë krye kundër meje. Shumë veta thonë për shpirtin t' im : s' ka shëptim për atë te Perëndia. Po ti, ô Zot, je mburonja ime, lavdia ime, dhe ay që lartëson kryet t' im. I thirra Zotit me zënë t' im, edhe më dëgjoj prej malit të tij të shëntë. Unë rashë e fieta ; u-zgjova ; se Zoti më ndih. Nuk do t' frikësohem prej dhietë mijërash populli që qëndrojnë kundër meje përqark. Ngre-u ô Zot ; shpëtô-më, ô Perëndia ime ; se ti godite gjith' armiqt' e mî ndë nofullët ; theve dhëmbët e fajtorëve. Shpëtimi ësht i Zotit, dhe bekimi yt është mi popullin t' ënt. (Dhe përsërî.) Unë rashë e fieta ; u-zgjova ; se Zoti më ndih.

PSALM 38.

Zot, mos më qërtô në zëmërimt tënt, as mos më mundô në mërit tënde. Se shigjetat e tua m' ungulnë, edhe dora jote po më shtrëngon. S' ka shëndet në misht t' im nga shkaku i zëmërimit tënt ; s' ka paqtim nër eshtërat e mia nga shkaku i mëkateve t' ime. Se paudhësit' e mia kapërxyen kryet t' im ; posi barre e rëndë u-rënduan mbi mua. Plagët e mia u-qelpnë e u-kalpnë nga marrëzia ime. U-bëra i ngratë dhe u-krrusa fare ; gjithë ditën ecëj

i vrerët. Se zorrët e mia u-mbushnë me të nzehtë edhe s' ka shëndet në misht t' im. U-sëmura e u-këputa fort; ulërinj nga shtrëngim' i zëmërës s'ime. Zot, gjithë dëshërimi im është përpara teje, edhe psherëtima ime s' fshihet prej teje. Zëmëra ime përzihet, fuqia ime po më lë; edhe drit' e syve t' im, as ajô s' është bashkë me mua. Miqt' e mî dhe t' afërmit e mî rrinë lark plagës s' ime, edhe më t' afërmit e mî qëndrojnë për-së-largu. Edhe atâ që kërkojnë shpirtin t' im më ngrehin kurth; dhe atâ që kërkojnë të keqen t' ime flasin kotësî edhe shkojnë nër mënt gënjeshtra gjithë ditën. Po unë, posi i shurdhër, nuk dëgjoj dhe posi nemec që nukë hap gojën e tij. Edhe isha posi një njeri që nuk dëgjon edhe që s' ka dredhje në goje të tij. Se shpëreva më ty, ô Zot; ti do t' më dëgjosh, ô Zot Perëndia ime. Se thashë: Mos u-gëzofshin për mua; kur shket këmba ime, atâ mbahen më të math kundër meje. Se unë jam gatî për të rënë, edhe të dhëmburit t' im është përpara meje kurdoherë. Se unë do t' rrëfej paudhësinë t' ime, do t' më vijë rëndë për mëkatën t' ime. Po armiqt' e mî rrojnë, edhe janë të fortë; e u-shumuan atâ që më kanë mërî të paudhë. Edhe atâ, që bëjnë keq në vënt të së mirës, janë armiqt' e mî, sepse ndiek të mirën. *Mos hiq dorë prej meje, ô Zot, Perëndia ime, mos u-mërgô prej meje. Nxitô të më ndihësh, ô Zot' i shpëtimit t' im.* (Dy herë.)

PSALM 63.

O Perëndî, ti je Perëndia ime ; që në mëngjes po të kërkoj ; shpirti im ka etje për ty, mishi im ka mall për ty në dhê të shkretë, e të thatë e të pa-ujë ; që të shoh fuqinë tënde dhe lavdimin tënt, sikundër të pashë në shëntërore. Se përdëllimi yt është më i mirë se jeta ; buzët e mia do t' të lavdërojnë. Kështû do t' të bekoj në jetët t' ime ; m' emërin tënt kam për të ngritur duart' e mia. Shpirti im do të nginjet, posi prej të majmi e prej dhiame, dhe me buzë gëzimi do t' të lavdërojë goja ime. Kur të kujtoj në shtratt t' im, ty shkoj nër mënt në ruajtjet e natës ; Se m' u-bëre ndihmësi im, përandaj nënë hien e fletëve tënde do t' gëzohem. Shpirti im u-ngjit pas teje ; e diathta jote më mban. Po atâ që kërkojnë shpirtin t' im për t' a humbur do të hyjnë në më të poshtmet anët e dheut, do të bien nënë fuqî të shpatës ; do të bëhen pies' e çakajve. Po mbreti do t' gëzohet për Perëndinë ; do t' lavdërohet kushdô që betohet m' atë, se do t' u thuret goja atyre që flasin gënjeshtrë. (Dhe përsëri.) Ty shkoj nër mënt në ruajtjet e natës, se m' u-bëre ndihmësi im, përandaj nënë hien e fletëve tënde do t' gëzohem. Shpirti im u-ngjit pas teje ; e diathta jote më mban.

Lavdî Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt ; tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen. Alleluia (Tri herë). Mëshirô, ô Zot. (Tri herë.) Lavdî... Tanî...

PSALM 88.

O Zot, Perëndi' e shpëtimit t' im, dit' e natë thirra përpara teje; le të vijë përpara teje të falurit t' im; ul veshnë tënt më klithmën t' ime. Se shpirti im u-mbush me trubullime, e jeta ime po afërohet në varrt. U-nëmëruash bashkë me atâ që zbresin në gropë, u-bëshë posi njeri pa ndihmë; Hedhur në të vdekurit, posi të vrarët që kanë rënë në varr, të cilët ti nuk i kujton më, edhe u-këputnë prej dorës s' ate. Më vure në gropë fort të poshtme, n' errësirë e në thellësira. Zëmërimi yt qëndroj mbi mua, edhe mbi mua solle gjithë valët e tua. Mërgove prej meje të njohurit e mî; më bëre ndyrësî nër atâ; u-mbylla e s' munt të dal. Syrit t' im i u-pre fuqia prej shtrëngimit; thirra më ty, ô Zot, gjithë ditën; më ty ndejta duart' e mia. Mos do të bësh punë të mahnitshime në të vdekurit? A po të vdekurit do të ngrihen e do t' të lavdërojnë? Mos e kanë për të treguar në varrt përdëllimin tënt, edhe të vërtetën tënde në prëhje? Mos do të njihen n' errësirë punët e tua të çuditshime, edhe drejtësia jote në vënt të harruar? Po unë thirra më ty, ô Zot; dhe në mëngjes të falurit t' im të ka për t' arrirë. Përsê heth shpirtin t' im, ô Zot, kthen më nj' anë faqen tënde prej meje? Jam dorë-hollë e në mundim vdekjeje që prej dialërisë s' ime; po heq nga frikët e tua e po vras mëndjen. Mbi mua shkuan zëmërimet e tua e nga frikët e tua drithtërova. Më qerthulluan posi ujë, gjithë ditën më qarkuan bashkë. Mërgove prej

meje mikn' e t' afërmin e të njohurit e mî në errësirë. (Dhe përsëri.) O Zot, Perëndî e shpëtimit t' im, dit' e natë thirra përpara teje ; le të vijë përpara teje të falurit t' im ; ul veshnë tënt më klithmën t' ime

PSALM 103.

Bekô Zotin, ô shpirti im, edhe gjithë të përbrëndëshmet e mia emërin e tij të shëntëruar. Bekô Zotin, ô shpirti im, e mos harrô gjithë të mirat që të ka dhënë ; atë që fal gjithë paudësit' e tua ; atë që shëron gjithë sëmundjet e tua ; Atë që çpërblen jetën tënde prej prishjes ; Atë që të kurorëzon me hir e me mëshirime ; Atë që ngin viett' e tû me të mira ; dialëria jote përsëritet, posi e shqiponjës. Zoti bën drejtësî e gjyq gjith' atyre që u bëhet e paudhë. I dëftoj udhët e tia Moisiut, punët e tija të bijve t' Israelit. Zoti është i dhëmpshur e mëshirëplot, zëmërgjerë e përdëllim-math. Nuk do t' zëmërohet përherë, as që do të mbajë mërî për gjithë jetën. Nuk na e bëri pas paudhësive tona, as na e çpagoj pas mëkateve tona. Se sa i lartë është qielli prej dheut, kaqë i math është përdëllim' i tij më atâ që i kanë frikë. Sa ndan lindja nga Perëndimi, kaqë i largoj prej nesh paudhësitë tona. Sikundër i dhëmp atit për diemtë, kështû i dhëmp edhe Zotit për atâ që i kanë frikë. Se ay njeh kriesën tonë, e mban mënt se jemi baltë. Ditt' e njeriut janë posi bari ; posi lulja e fushës, kështu lulëzon.

Se shkon era mi të, edhe s' është më, edhe vëndin e tij nuk do t' a njohë më. Po përdëllimi i Zotit është jetë pas jete m' atâ që i kanë frikë dhe drejtësia e tij më të bijt' e të bijve, më atâ që ruajnë dhiatën e tij dhe mbajnë mënt urdhërimet e tij që t' i bëjnë. Zoti qëndroj fron' e tij në qiell dhe mbretëria e tij zotëron mi gjithë. Bekoni Zotin, ju ëngjëjt e tij, të fortë me fuqî, që bëni fialën e tij, që dëgjoni zërin e fialëve të tij. Bekoni Zotin, ju gjith' ushtërit' e tij; ju meshëtarët e tij, që bëni dashurimin e tij. Bekoni Zotin, ju gjithë veprat e tij, më ç' do vënt të zotërimit të tij; bekô Zotin, ô shpirti im. (Dhe përsëri) Më ç' do vënt të zotërimit të tij; bekô Zotin, ô shpirti im.

PSALM 143.

O Zot, dëgjô të falurit t' im, mbaj-i vesh të luturat e mia; përgjeq-m' u pas së vërtetës s' ate dhe pas drejtësisë s' ate. Edhe mos hyr në gjyq me shërbëtorin tënt, se asnjë i gjallë nuk do të dalë i drejtë përpara teje. Se armiku ndoqi shpirtin t' im; shtypi jetën t' ime për-dhê, më vuri të rri në vise të errët si të vdekurit qëmoti. Përandaj m' u-zû fryma mbi mua, zëmëra ime m' u-përzie përbrënda meje. Kujtoj ditt' e lâshta, mejtoj gjithë veprat e tua, shkoj nër mënt punët e duarve tënde. Ndej duart' e mia drec teje, shpirti im ka etje per ty posi dheu i thatë. Shpejt përgjeq-m' u, ô Zot; më zihet fryma, mos kthe më nj' anë faqen tënde prej meje që të mos u

shëmbëllej atyre që zbresin në gropë. Bëj-më të dëgjoj përdëllimin tënt në mëngjes, se më ty shpërenj, bëj-më të njoh udhën që është për të ecur, se më ty varra shpirtin t' im. Çlirô-më prej armiqve t' im, ô Zot, se më ty vij të fshihem. Mësô-më të bëj dashurimin tënt, se ti je Perëndia ime. Fryma jote e mirë le t' më heqë udhën mi dhê drejtësie. Për emërin tënt, ô Zot, ngjall-më, për drejtësinë tënde nzir shpirtin t' im prej ngushtimit. Dhe për mëshirimin tënt shuaj-i armiqt' e mî edhe prish gjith' atà që shtrëngojne shpirtin t' im, se unë jam shërbëtori yt. (Dhe përsëri) *Dëgjô-më, ô Zot, pas drejtërisë s' ate dhe mos hyr në giyq më shërbëtorin tënt.* (Dy herë.) Fryma jote e mirë le t' më heqë udhën mi dhê drejtësie.

Lavdî..... Tanî. ...

Alleluia, Alleluia, Allaluia ; Lavdî ty, ô Perëndî (Tri herë.) O Zot, shpresa jonë, lavdî më ty.

DIAKU thotë Litanin' e Madhe :

Më paqje le t' i lutemi Zotit.

VALLEJA :

Mëshirô, ô Zot.

Për paqjen që-lartazi... (Shëkô në Meshë.)

PRIFTI me zë të lartë :

Se ty të ka hie ç' do lavdî, nderim, dhe adhurim Atit,...

VALLEJA :

Amen.

Dhe me një herë këndon :

Perëndia është Zoti dhe u-çfaq nër ne ; i bekuar ësht ay që vien më emërin e Zotit. (Katër herë.)

Pastaj, Tropar' i së Dielës, në qoftë, për-së-dyti, pastaj e Shëntit të ditës, në qoftë e krëmte, në mos, e para Hyjlindësore e Tingëllit. Pasandaj Vargëzimi i zakonëshm, ose Ndënjësoret. Pasandaj Bekimtaret :

I bekuar je, ô Zot, mësô-më të drejtat tënde.

Shoqëria e Engjëjve u-çudit kur të pâ të nëmërohesh me të vdekurit, të rrëmosh, Shpëtimtar fuqin' e vdekjes, dhe bashkë me veten Adamin të ngresh dhe t' i çlirosh të gjithë prej Skëterrës.

I bekuar je, ô Zot,...

Përse i trazoni, ô Nxënëse, myrrat me lott' e mëshirës? Engjëlli që shkëlqente në varr u thosh Myrrësjellëseve. Shëkoni vetë varrin dhe kupëtoni ; se Shpëtimtari u-ngrit prej varrit.

I bekuar je, ô Zot,...

Shumë me-natë Myrrësjellëse rentnë më varrin tënt, duke vajtuar, po u qëndroj përpara Engjëlli dhe u tha : Koha e vajtimit shkoj, mos qani ; po Ngjalljen Apostujve thojuni.

I bekuar je, ô Zot,...

Gra myrrësjellëse, duke ardhur me myrra, varrit tënt i u-afëruan, Shpëtimtar. Po Engjëlli u foli duke

thënë : Si e nëmëroni të gjallin me të vdekurit ? Se ay u-ngrit prej varrit si Perëndî.

Lavdî Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt.

I falemi Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, Shën Trinisë më një të qënurë, duke thirrur bashkë me Serafimet : I Shëntë, i Shëntë, i Shëntë je, ô Zot.

Tanî e përherë e në jetë të jetëve. Amen.

Duke lindur jetë-dhënësin, shpëtove, Virgjëreshë, Adamin prej mëkatës ; i dhe Evës gëzim në vënt të helmit ; atë që ra prej jetës e drejtësoj te ajô, ay që u-mishërua prej teje Perëndî edhe njeri.

Alleluia, alleluia, alleluia, lavdî ty, ô Perëndî. (Tri herë).

Pastaj Litania e Vogël, dhe PRIFTI me zë të lartë :

Se i bekuar është Emëri yt, dhe e lavdëruar mbretëria jote, e Atit,...

Pastaj Dëgjimi. Shkallesat e Tingëllit. Parëvargu Ngjalljesor. Në qoftë nonjë e Krëmte thohen këtô të Tingëllit të IV^t.

Që prej dialërisë s' ime shumë pasione më lëftojnë. Po ti përkrah-më dhe shpëtô-më, ô Shpëtimtari im.

Ju që i kini mërî Sionës do t' turpërohi prej Zotit ; se do të fishkeni si bari në ziarr.

Lavdî Atit,..

Me anën e Shpirtit Shënt merr jetë ç' do shpirt, dhe lartësohet më paqësî, dhe ndriçohet prej njësisë Trinisore shënt-fshehtazi.

Tanî e përherë....

Me anën e Shpirtit Shënt riedhin burimet e hirit, dhe vaditin tërë kriesën për jetëlindje. — Parëvargu i së Krëmtes.

Pastaj në qoftë e Krëmte, thohet Ungjill' i Mëngjezit dhe pastaj Kanunet. Në qoftë e Diele thohen Kanunet më parë Ngjalljesor, Kryq-Ngjalljesor, Hyjlindësor, dhe i Muajësores.

Më Këngën e III^te PRIFTI bën një Litanî të Vogël: Përsëri dhe përsëri. Përkrah-na, shpëtô-na. Tëreshënten.

Me zë të lartë :

Se ti je Perëndia jonë, dhe ty të dërgojmë lavdî Atit,...

Pastaj Ndënjësorja e Muajsores. Më këngën e VI^t, Litania e Vogël dhe Thirrje :

Se ti je Mbret' i paqjes dhe ty të dërgojmë lavdî Atit,...

Shkurtorja dhe Shtëpia. Synaxari. Pastaj këngët VII, VIII, dhe IX dhe nisen Zbritësoret. Pas Këngës VIII të Zbritësoreve, DIAKU thotë :

Le t' i lutemi Zotit.

VALLEJA :

Mëshirô, ô Zot.

PRIFTI :

Se i shëntë je, ô Perëndia jonë, dhe i prëhur nër Shëntorët, dhe ty të dërgojmë lavdî, Atit.....

VALLEJA :

Amen.

PASTAJ :

Ç' do frymë le të lavdëroje Zotin. (Tri herë.)

DIAKU :

Dhe që të vlerësohemi të dëgjojmë Ungjillin e Shëntë, Zotit Perëndisë s' onë le t' i lutemi.

VALLEJA :

Mëshirô, ô Zot. (Tri herë.)

DIAKU :

Urtësî, ô të drejtë. Le të dëgjojmë Ungjillin e Shëntë.

PRIFTI :

Paqë mi ju të gjithë.

VALLEJA :

Dhe me frymën tënde.

PRIFTI :

Këndimi prej Ungjillit të shëntë pas...

VALLEJA :

Lavdî më ty, ô Zot, lavdî më ty.

DIAKU :

Le të vëmë re.

BKSH

Pastaj PRIFTI këndon Ungjill' e Mëngjezit.
Më të mbaruar VALLEJA thotë :

Lavdî më ty, ô Zot, lavdî më ty.

PASTAJ :

Me-qënë-që pamë Ngjalljen e Krishtit le t' i falemi Shënt Zotit Jesu, të vetëmit të pamëkatëshm. Kryqit tënt po i falemi, ô Krisht, dhe Ngjalljen tënde të shëntë po hymnojmë dhe lavdërojmë ; se ti je Perëndia jonë, veç teje nukë njohim tiatër, emërin tent po emërojmë. Ejani, tërë besnikët, t' i falemi Ngjalljes së shëntë të Krishtit. Se ja ku erdhi me anën e kryqit gëzim mi tërë botën ; duke bekuar kurdoherë Zotin, hymnojmë Ngjalljen e tij ; se, duke duruar kryq, me vdekje vdekjen humbi.

PASTAJ KËNDOHET PSALMI 51.

Përdëllyes përdëlle-më, ô Perendî, pas përdëllimit tënt të math, dhe pas shumicës së mëshiravet e tua. shuaj-i paudhësit' e mia.

Laj-më fare prej paudhësisë s' i me, edhe më qërô prej fajit t' im.

Se unë njoh paudhësit' e mia, edhe faji im është përpara meje kurdoherë.

Te ty vetëm fëjeva, edhe përpara teje bëra të keqen ; që të dalësh i drejtë nër fialët e tua e të jesh i kthiellët nër gjyqet e tû.

Se ja tek u-zura në paudhësî edhe në mëkatë më polli ëma ime.

Se ja tek deshe të vërtetën në veshnjet, edhe në të fshehurat e mia do t' më dëftosh diturî.

Spërkat-më me hysop, dhe do t' qëronem ; laj-më dhe do të bëhem më i bardhë se dëbora.

Bëj-më të dëgjoj gëzim e ngazëllim, që të më gëzohen eshtërat ê thyera.

Kthe më-nj'-anë faqen tënde nga mëkatat e mia, edhe shuaj-i gjithë paudhësit' e mia.

Krijô zëmër të kthiellët tek unë, ô Perëndî ; edhe përsërit përbrënda meje frymë të drejtë.

Mos më hith tej prej faqes s' ate ; edhe mos merr prej meje Shpirtin tënt të Shëntë.

Ep-m' a prapë gëzimin e shpëtimit t' ënt, edhe forcô-më me frymë zotërishte.

Do t' mësoj fajtorët udhët e tua ; edhe të pabesët do të kthehen te ty.

Shpëtô-më prej gjakrash, ô Perëndî, Perëndia e shpëtimit t' im; gjuha ime do t' lavdërojë me gëzim drejtërinë t' ënde.

Zot, çil buzët e mia, edhe goja ime do t' rrëfejë lavdimin t' ënt.

Se të dashkëshe therore, do t' të kisha prurë ; po holokostet nuk të pëlqejnë.

Therore e Perëndisë është frym' e thyer ; zëmërën e thyer dhe të përunjur nuk do t' a hedhësh tej, ô Perëndî.

Bëj mirë Sionës me pëlqimin tënt ; ndërtô muret e Jerusalemit.

Atëhere do t' pëlqesh therore drejtësie dhurata dhe holokoste.

Atëhere do të bien viçër mi theroren tënde dhe mëshirô-më, ô Perëndî.

Lavdî Atit...

Me nërmjetimet e Apostujve, ô Mëshirëplot, shuaj-i shumicat e paudhësive t' ime.

Tanî e përherë...

Me nërmjetimet e Hyjlindëses, ô Mëshirëplot, shuaj-i shumicat e paudhësive t' ime.

Përdëllyes përdëlle-më, ô Perëndî.....

Kur u-ngrit Jesui prej varrit, siç parëtha, na dha jetën e ameshuar dhe përdëllimin e math.

Në qoftë më kohë të Triodit thohen këtô :

Lavdî Atit,... (Tingell Tërthor IV.)

Hap-m'i dyert' e pendimit, ô Jetëdhënës; se mëndja ime vien që me-natë te tempulli yt i shëntë, duke sjellë tempullin e trupit tërë të pikluar; po ti, si mëshirëplot, spastroj-e me përdëllimin tënt të mëshirëshm.

Tanî e përherë....

Drejtësô-m'a udhën e shpëtimit, ô Hyjlindëse ; se e ndyta shpirtin me mëkata të turpëshme, duke shkuar tërë jetën t' ime më ngathësî ; me lutjet tënde spastrô-më prej ç' do ligësie.

Përdëllyes, përdëlle-më, ô Perëndî ...

Shumicën e tmerreve që kam bërë duke kupëtuar un' i mieri, dridhem nga dit' e trëmpshime e gjykatës; po duke marrë kurajë nga mëshira e dhëmp-

shërisë s' ate, si Davidi po të thërres : Përdëlle-më, ô Perëndî, pas përdëllimit tënt të math.

Passi përshëndosh populli Ungjillin, thotë DIAKU :

O Zot, shptëô popullin tënt, dhe bekoj-e trashëgimin tënt. Vështroj-e botën tënde me përdëllim e me mëshirë. Lartesoj-e ballën e të krishterëve Orthodoxë dhe dërgô mi ne mëshirat e tua të pasura ; me nërmjetimet e Zonjës së pacinuar Hyjlindëses dhe gjithmon-virgjërës Marî ; me fuqin' e kryqit të çëmuar dhe jetëdhënës ; me mprojtjet e Fuqive qiellore të ndershime pa trup; të ndershimit,të lavdëruarit Profet, Parërendës dhe Pagëzor Joan ; të Apostujve të shëntë, të lavdëruar dhe emërshkëlqyer ; të shënt-atërve tanë kryepriftërve të Mbëdhej dhe Mësonjësve Ekumenikë, Vasilit të Math, Gregorit Theolog dhe Joan Gojartit, t' Atit Shën-Koll Kryepeshkopit të Myrave të Lyqisë, çudî-bërësit ; të Dëshmorëve të shëntë,të lavdëruar dhe bukur-mundës ; t' Atërve tanë oshënarë dhe hyjprurës ; të hyjprindërve të shëntë dhe të drejtë Joaqim dhe Annes ; të Dëshmorit të Math Shënt-Gjergj Tropeprurësit ; dhe të gjithë Shëntorëve ; të lutemi, ô Zot mëshirëplot, dëgjo-na ne mëkatarët që po të lutemi dhe mëshirô-na.

VALLEJA :

Mëshirô, ô Zot ! (Tri herë.)

PRIFTI:

Me mëshirën, dhëmpshëritë, dhe njerzidashjen e të vetëmit t' yt-Bir, me të cilin je i bekuar, bashkë me tërëshëntin, të mirin, dhe jetëdhënësin Shpirtin tënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

VALLEJA:

Amen.

DIAKU:

Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës me hymne nderimi le t'a madhështojmë.

VALLET:

Vark: Shpirti im madhështon Zotin dhe mëndja ime u-ngazëllua mi Perëndinë Shpëtimtarin t' im.

Më të ndershimen se Qerubimet dhe më të lavdëruarën pa përqasje nga Serafimet, që pa u-cinuar linde Fialë Perëndinë, me të vërtetë Hyjlindësen, ty të madhështojmë.

Se hodhi synë mi përunjesin' e shërbëtores së tij; se ja që tani e tutje tërë brezat do t' më lumërojnë.

Më të ndershimen.....

Se më madhështoj i fuqishmi, dhe emër' i tij është' i shëntë; dhe përdëllim' i tij do të jetë bres pas brezi mi atâ që i kanë frikë.

Më të ndershimen.....

Rrëfeu fuqî me krahun e tij; i përndau kryelartërit nga mejtim' i zëmrave të tyre.

Më të ndershimen.....

Përmbysi të fuqishmit prej froneve dhe lartësoj të përunjëtit; të urëtit i mbushi me të mira, dhe të pasurit i dboj të zbrazët.

Më të ndershimen.....

Duke kujtuar përdëllimin, përkrahu të birin e tij Israelin, siç u ish zotuar atërve tanë, Abraamit dhe farës së tij për jetë.

Më të ndershimen.....

Pastaj këndohet kënga IX e Zbritësoreve. Pas asaj Litania e Vogël.

PRIFTI me zë te lartë :

Se ty të këndojnë tërë fuqit' e qiejve dhe ty të dërgojnë lavdî Atit.....

VALLET këndojnë :

I shëntë është Zoti Perëndia jonë (Dy herë; më të tretën herë shtojnë dhe këtë :)— Lartësoni Zotin Perëndinë tonë dhe faluni nënë këmbët e këmbëve të tij ; se është i shëntë.

Pastaj këndohen Dërgimësoret, të Ngjalljes, të Shëntit, në ka, ose të Hyjlindëses. Pastaj :

Ç' do frymë le të lavdëroje Zotin. Lavdërojeni Zotin prej qiejve, lavdërojeni më të lartat. Ty të ka hie kënga, ô Perëndî.

Lavdërojeni gjith' Engjëjt e tij ; lavdërojeni tërë Fuqit' e tij ; Ty të ka hie kënga, ô Perëndî.

Pastaj këndohen me tetë Vargje katër Vargësore Ngjallje-

sore dhe katër të Shëntit që kremtërohet, në ka; ose. në mos, më gjashtë a më tetë Vargje Ngjalljesoret.

VARGJET.

Kio lavdî do të jetë më gjithë Shëntorët e tij.

Lavdërojeni Perëndinë më shëntorët e tij; lavdërojeni pas shigurisë së fuqisë së tij.

Lavderojeni për fuqit' e tij; lavdërojeni pas shumicës së madhërise së tij.

Lavdërojeni me zë trumpete; lavdërojeni me këngëtore e me qitharë.

Lavdërojeni me tympan' e me valle; lavdërojeni me kordha e me shtrumente.

Lavdërojeni me qymbale zë-mira; lavdërojeni me qymbale brohorie. Ç' do frymë le të lavdëroje Zotin.

Ngre-u, ô Zot Perëndia ime, le të lartësohet dora jote, mos i harrô të varfërit e tû në funt.

Do t' rrëfej ty, ô Zot, me gjithë zëmërën t' ime, do t' pralloj gjithë çudit' e tua.

Pastaj thohet: « Lavdî Atit... », « Mëngjezorja », dhe « Tanî e përherë... » kio Hyjlindësore.

TINGELL II.

E përmibekuar je, ô Hyjlindëse Virgjëreshë, të hymnojmë; se me anën e atij qe u-mishërua prej teje, Ferri u-robërua, Adami u-nduall prapë, mallkimi vdiq, Eva u-çlirua, vdekja u-vra dhe neve muarmë jetë; përandaj, duke përhymnuar, thërre-

sim : I bekuar je, ô Krisht Perëndî, që e pëlqeve kështu, lavdî më ty.

Dhe me-një-herë *Dozologia.*

Lavdî ty që na rrëfeve dritën, lavdî Perëndisë më të lartat, dhe mi dhenë paqje dhe më njerëzit mirëdashje.

Të hymnojme, të bekojmë, të falemi, të lavdërojmë, ty të përhirojmë për lavdinë tënde të madhe.

Zot Mbret, Perëndî qiellore, At' i tërëfuqishim, Zot Bir i vetëm Jesu Krisht edhe Shpirti Shënt.

Zot Perëndi, qengj' i Perëndisë, i Bir' i Atit, që ngre mëkaten e botës; mëshirô-na, ti që ngre mëkatat e botës.

Prit faljen tonë, ti që rri më të diathtë të Atit, edhe mëshirô-na.

Se ti je Shënt' i vetëm, ti je Zot' i vetëm Jesu Krishti, për lavdî të Perëndisë Atit. Amen.

Për dita do t' të bekoj dhe do t' lavdëroj emërin tënt për jetë e më jetë të jetës.

Vlerësô-na, ô Zot, këtë ditë të ruhemi pa nonjë mëkatë.

I bekuar je, ô Zot, Perëndi' e Atërve tanë dhe emëri yt ësht i kënduar e i lavdëruar më jetët. Amen.

Le të jetë, ô Zot, përdëllimi yt mi ne, sikundër kemi shpresuar mi ty.

I bekuar je, ô Zot, mësô-më të drejtat tënde. (Tri herë.)

O Zot, ke qënë përikja jonë bres pas brezi. Unë thashë : O Zot, mëshirô-më ; shërô shpirtin t' im se fëjeva te ty.

O Zot, më ty përika ; mësô-më të bëj dëshirën t' ënde, se ti je Perëndia ime.

Se pranë teje është burim jete, më dritën tëndë do t' shëkojmë dritë.

Zgjat-e përdëllimin tënt mi atâ që të njohin.

Shënt Perëndî, Shënt i Fuqishmë, Shënt i Pavdekur, mëshirô-na. (Tri herë.)

Lavdî Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt.

Tanî e përherë e në jetë të jetëve. Amen.

Shënt i Pavdekur, mëshirô-na.

PASTAJ me zë të fortë.

Shënt Perëndî, Shënt i Fuqishmë.

Shënt i Pavdekur, mëshirô-na.

PASTAJ ky Tropar.

Sot erdhi shpëtimi në botë ; le t' i këndojmë atij që u-ngrit prej varrit dhe kryetarit të jetës s' onë ; se duke rrëmuar vdekjen me vdekje na dha mundjen dhe përdëllimin e math.

Dhe niset Mesha me një herë.

REGULLIMI
I 'BLATËS SË HYJËSHME

Kur ka Prifti për të bërë Meshën e Perëndishme, duhet më parë të jetë i pajtuar me të gjithë e të mos ketë gjë kundër nonjëj, dhe, sa të mundë, t' a ruaj zëmërën prej mejtimesh të liga ; dhe të mbahet që mbrëmane, dhe të vigjëllojë gjer më kohën e Shërbesës së Shëntë. Dhe kur të vijë koha, passi t' i bëjë faljet e zakonëshme të Parit, hyn në kishë ; dhe, si bashkohet me Diakun, bëjnë bashkë tri falje nga an' e Lindjes përpara Dyerve të Shënta, duke thënë :

O Perëndî, fal-më mua mëkatarin.

PASTAJ thotë DIAKU :

Bekô, ô Zot.

PRIFTI :

E bekuar është Perëndia jonë për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.
Lavdî ty, ô Perëndia jonë, lavdî më ty.

DIAKU :

Mbret qiellor, Ngushëllimtar, Shpirti i së vërtetës, që ndodhesh kudo dhe i mbush të gjitha, thesar' i të mirave, dhe falësi i jetës ; eja dhe tendësô nër ne, dhe spastrô-na prej ç' do pikle, dhe shpëtô, ô i Mirë, shpirtet tona.
Shënt Perëndî, Shënt i Fuqishmë...
Trinî e Tërëshëntë...

Ati ynë që je ndë qiell...

PRIFTI :

Se jotja është Mbretëria, edhe fuqia, edhe lavdia, e Atit....

PASTAJ thotë :

Mëshirô-na, ô Zot, mëshirô-na, se duke mos patur tiatër mprojtje, ne mëkatarët të siellim ty, si Zoti, këtë lutje : mëshirô-na.

DIAKU :

Lavdî Atit....

Mëshirô-na, ô Zot, se te ty kemi shpresuar ; mos u-zëmërô tepër me ne, as mos kujtô paudhësitë tona ; po hith synë dhe tanî si zëmër-dhëmpshur, dhe shpëtô-na prej armiqve tanë ; se ti je Perëndia jonë, dhe neve populli yt ; të gjithë jemi vepra të duarve tënde dhe emërin tënt kemi thirrur.

PRIFTI :

Tanî e përherë...

Hap-na derën e zëmër-dhëmpshërisë, ô Hyjlindëse e bekuar ; duke patur shpresë te ty, le të mos humbasim, le të shpëtojmë me anën tënde prej rasjesh të liga ; se ti je shpëtimi i gjindjes së krishterëve.

DIAKU :

Mëshirô, ô Zot. (12 herë.)

Bëjnë kryq që te dy. Pastaj shkojnë karozë, Prifti përpara, dhe përshëndoshin korat e shënta.

Te Kor' e Jesu Krishtit thonë :

Korës s' ate së pacinuar i falemi, ô i Mirë, duke lypur ndiesë të fajeve tona, ô Krisht Perëndî ; se, duke dashur, dignove të ngjitesh trupërisht më kryqin, që të shpëtosh prej robërisë s' armikut atâ që gatove ; përandaj me mirënjohje po të thërresim : Me gas i mbushe të gjitha, ô Shpëtimtari ynë, kur erdhe për të shpëtuar botën.

Te e Hyjlindëses, thonë :

Duke qënë burim zëmër-dhëmpshërie, vlerësô-na me sympathî, ô Hyjlindëse ; hith synë mi popullin që mëkatoj, rrëfê si përherë fuqinë tënde ; se, duke shpresuar më ty « Gëzoh-u », te thërresim, si një herë Gabrieli, kryegeneral' i Engjëjve.

Pastaj përshëndoshin korët e tiera, duke thënë tropar' e Shëntit, e të tsilit është kora. Pasandaj kthehen te vëndi i tyre i parë ; DIAKU rri më te diathë të Priftit e i thotë :

Le t' i lutemi Zotit. Mëshirô, ô Zot.

Dhe si unjim krerët, PRIFTI thotë këtë urim :

O Zot, ndeh doren tënde prej lartësirës së ndënjësores s' ate, dhe forcô-më te shërbimi yt i përparavënë, që të qëndroj pa dënim përpara Tribunës s' ate së trëmpshime e të mbaroj shërbesën e shëntë të pagjakëshme. Se jotja është fuqia, edhe lavdia, më jetët të jetëve. Amen.

DIAKU :

Lavdî. Tanî. Mëshirô, ô Zot. (Tri herë.) Bekô.

PRIFTI bën një Përlëshim të vogël kështu, në qoftë e Dielë :

Krishti Perëndia jonë e vërtetë, që u-ngjall së vdekurësh.....

Në mos :

Krishti Perëndia jonë e vërtetë....

Në qoftë Mesh' e Shën Vasilit, thotë më në funt :

T' Atit tonë nërmiet shëntorët Vasilit Kryepeshkopit të Kaisarisë së Kappadoqisë, Qiell-folësit të Math.

Në qoftë e Shën Gojartit :

T' Atit tonë nërmiet shëntorët Joan Kryepeshkopit të Konstantinopojës Gojartit.

Dhe, passi falen tri herë dhe përshëndoshin popullin, hyjnë në Shëntërore, PRIFTI nga der' e veriut, dhe DIAKU nga der' e jugës, duke thënë që të dy dhe duke u- falur karozë :

Do të hyj te shtëpia Jote e shëntë, do t' i falem një Hynie që adhurohet më tri substanca, më Atin, e më Birin, e më Shpirtin Shënt, më jetët. Amen.

Dhë kështu përshëndoshin Ungjillin e Shëntë dhe Alltar' e shëntë. DIAKU i afërohet Priftit duke mbajtur të veshurat e shënta e thotë :

Bekô ô Zot, Stiharë bashkë me Orarë.

Dhe puth dorën e diathtë të PRIFTIT, i cili thotë :

E bekuar është Perëndia jonë për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Diaku shkon e vishet. PRIFTI merr dhe ay Stiharë dhe thotë :

O Perëndî fal- më mua mëkatarin.

Dhe falet tri herë. Pastaj-e bekon, e puth dhe thotë :

E bekuar është Perëndia.....
Le t' i lutemi Zotit. Mëshirô, ô Zot.

Dhe duke u-veshur thotë :

Do t' ngazëllohet shpirti im te Zoti; se më veshi me robë shpëtimi dhe me këmishë gëzimi më pështolli; më vuri kurorë si një dhëndëri, dhe si nuse më stolisi me stolî. Për gjithmonë, tanî e përherë e në jetë të jetëve. Amen.

Gjith' ashtû dhe DIAKU vishet dhe uron pa bekuar. Merr Orarë dhe, si e puth, e vë mi supin e mëngjër. Merr Mimëngët dhe më të diathtën, si e puth, thotë :

Le t' i lutemi Zotit. Mëshirô, ô Zot.
Dora jote e diathtë, ô Zot, u-lavdërua me fuqî ; dora jote, ô Zot, theu armiqtë, dhe më shumicën e lavdisë s' ate dërmove kundrështarët.

Më të mëngjërën, duke bërë gjith' ashtû, thotë :

Duart' e tua më bëne e më gatuan, -bëj-më të mënçim dhe do t' mësoj urdhërimet e tua.

Pastaj shkon në Lanjëtore e thotë :

Le t' i lutemi Zo'it. Mëshirô, ô Zot.

Do të lanj duart' e mia nër të pafajshmit, dhe do të qerthulloj Alltarin tënt, ô Zot, që të dëgjoj zën' e lavdërimit tënt, e të pralloj tërë çudirat e tua. O Zot, dashurova mirhiesin' e shtëpisë s' ate, dhe vëndin e tendësimit tënt : mos e hump shpirtin t' im bashkë me të pabesët, dhe rrojtjen t' ime bashkë me burra gjakatarë, nër duart' e të cilëve ka paudhësira ; e diathta e tyre u-mbush me dhurata ; po unë kam baritur në innokencën t' ime : çpërblê-më, ô Zot, dhe mëshirô-më ; këmba ime qëndroj më drejtësî ; më kishërat do t' të bekoj, ô Zot.

Pastaj hyn në 'Blatën e shëntë dhe falet tri herë duke thënë :

O Perëndî, fal-më mua mëkatarë.

Dhe çpështjell Qelqin e shëntë duke thënë këtë Tropar :

Pregatit-u Bethlehem, u-hap për të gjithë Edemi ; stolis-u Eufratha, se druri i jetës lulëzoj në Shpellë prej Virgjëreshës ; se barku i saj u- rrëfye Parrajsë mëndore, ku ndodhet bima e hyjëshme, nga e cila do të hamë e do të rrojmë ; dhe do të mos vdesim si Adami. Krishti lindet, që do të ngrerë Korën që ra qëmoti.

Pastaj shtron mbulesën më të diathte, vë Diskun e shëntë prësipër, gjith' ashtu dhe Shtijëzën e shëntë, nxier Sfyngjer' e shëntë me vërejtje nga Qelq' i shëntë, e vë kundrejt Diskut me

Lugën e shëntë; shëkon Qelqin e shëntë mos ka brënda gjë, pastaj e vë më të diathtë të Diskut. Mbulesat me Erën dhe Yllthin i vë më të mëngjër, dhe kështu pret priftin. PRIFTI, si vesh Stiharë, merr Petrahilë, e shënon, e puth dhe thotë :

E bekuar është Perëndia, që derth hirin e tij mi priftërit e tij, si myrrë mi krye, që zbret mi miekrën, miekrën e Aaronit, që zbret mi anën e robës së tij

Pastaj merr Brezin dhe thotë :

E bekuar është Perëndia....

Dhe si e shënon thotë :

Le t' i lutemi Zotit. Mëshirô, ô Zot.

E bekuar është Perëndia që më ngjesh me fuqî, dhe m' a bëri udhën faqebardhë ; që i trajtoj këmbët e mia si prej kaprolli, dhe më qëndroj më të lartat. Për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Pastaj merr Mimëngët dhe bën siç thamë më sipër. Në qoftë Arqimandrit vesh Epigonatin dhe thotë :

Ngjesh shpatën tënde më mezë tënt, ô i fortë, me bukurinë tënde, dhe me hien tënde ; dhe çap-u përpara, më udhën e mbarë dhe mbretërô me të vërtetën, butësinë, dhe drejtësinë ; dhe dora jote e diathtë do të heqë udhën çuditërisht. Për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Pastaj merr Felonë, dhe si e bekon, e puth, duke thënë :

Priftërit e tû, ô Zot, do të vishen me drejtësí

dhe oshënarët tënt do t' ngazëllohen me ngazëllim. Për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Vete në Lanjëtoren dhe bën atô që u-thanë për Diakun Pastaj vien në Blatë, falet tri herë dhe thotë :

O Perëndî, fal-më mua mëkatarin, dhe mëshirô-më.

Merr meshën dhe Shtijëzën e shëntë, me të dyja duartë, e ngre gjer në ballë të tij dhe thotë :

Na çpërbleve prej mallkimit të ligjes, me gjakun tënt të çëmuar; duke u-mbërthyer më kryq, e duke u-çpuar me shtijëzë, u-burove njerëzive pavdekurinë : Shpëtimtari ynë, lavdî më ty.

Pastaj thotë DIAKU :

Bekô, ô Zot.

PRIFTI bekon dhe duke mbajtur meshën dhe Shtijëzën bën shënjën e kryqit mi Diskun, duke thënë :

E bekuar është Perëndia jonë për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Pastaj PRIFTI, duke mbajtur meshën me dorën e mëngjër dhe Shtijëzën me dorën e diathtë, dhe si thotë DIAKU :

Le t' i lutemi Zotit. Mëshirô, ô Zot.

Bën kryq me Shtijëzën përmi meshën, duke thënë:

Për kujtim të Zotit, dhe Perëndisë, dhe Shpëtimtarit tonë Jesu Krisht.

DIAKU thotë :

Për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Këtë e bën për-së-treti Prifti. Pastaj thotë DIAKU :

Le t' i lutemi Zotit.

Dhe PRIFTI e kall Shtijëzën më anën e diathtë të meshës dhe, duke prerë, thotë :

Si dele u-hoq më therrje.

Më të mëngjërën thotë :

Dhe si qenq i pafajshim nukë nxier zë përpara atij që e qeth, ashtu nuk e hap gojën e tij.

Më anën e sipërme të shilës thotë :

Më perunjësimin e tij gjykim' i tij humbi.

Më anën e poshtme thotë :

Po brezin e tij kush do t' a rrëfejë ?

DIAKU,duke vësthruar me reverim këtë çerimonje, thotë më ç' do prerje :

Le t' i lutemi Zotit. Mëshirô, ô Zot. — Duke mbajtur Orarë më dorën e diathtë. Pastaj thotë :

Ngrej-e, ô Zot.

PRIFTI atëhere, duke futur Shtijëzën e shëntë brinjthi nga an' e mëngjër e meshës, ngre bukën e shëntë dhe e vë te Disku i shëntë, duke thënë :

Se ngrihet prej dheut jet' e tij.

Dhe si e vë më-krahëza (do-me-thënë për-së-prapi) te disku i shëntë, si thotë DIAKU :

Sakrifikô, ô Zot.

E sakrifikon me Shtijëzën kryqthi, dyke thënë :

Sakrifikohet qengj' i Perëndisë që ngre mëkatën e botës, për jetën dhe shpëtimin e botës.

Prapë thotë DIAKU :

Kryqësô, ô Zot.

PRIFTI prapë me Shtijëzën, duke sakrifikuar, thotë :

Kur u-kryqësove ti, ô Krisht, u-vra shtyrania, u-shkel fuqi' e armikut; se as Engjëll, as njeri, po vetë Zoti na shpëtoj; lavdî më ty.

Dhe me një herë e kthen Qengjin nga faqeja (do me thënë nga shila), duke thënë DIAKU :

Çpô, ô Zot.

PRIFTI, duke çpuar me Shtijëzën nga an' e diatht' qengjit permi N- ne, thotë :

Një prej ushtarët e çpoj brinjën e tij me shtijëzë, dhe me-një-herrë rrodhi prej brinjës së tij së shëntë gjak dhe ujë, dhe ay që e ka parë ka dëshmuar, dhe i vërtetë është dëshmim' i tij.

DIAKU merr të dyja enët, të verës e të ujit, dhe, duke mbajtur më dorën e diathtë verën, dhe më të mëngjërën ujën, shtie më Qelqin e shëntë sa duhet, duke i thënë PRIFTI m' atë kohë :

Bekô, ô Zot, bashkimin e shëntë.

Dhe PRIFTI, duke bekuar permi Qelqin e shëntë, thotë :

I bekuar është bashkim' i Shëntorëve tënt.

DIAKU :

Për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Pastaj vë PRIFTI përmi Qelqin e shëntë dy mbulesat dhe Yllthin. DIAKU shkon e ujdis Alltar' e shëntë dhe rishvështron Ungjillin që do t' këndojë. PRIFTI, duke marrë meshën e dytë dhe si e shënon me Shtijëzën, nxier piesën e Hyjlindëses kështu duke thënë :

Për nder dhe kujtim të Zonjës s' onë së përmibekuar, të lavdëruar, Hyjlindëses, dhe gjithmonvirgjërës Marî, me nërmjetimet e së cilës, akseptô, ô Zot, këtë therore në Alltarë tënt të përmiqiellshim.

Dhe, duke ngritur piesën e Hyjlindëses me Shtijëzën, e vë më anën e diathtë të Bukës së shentë, anës mezit të tij, duke thënë :

Qëndroj Mbretëresha më të diathtë tënt, me të veshura të punuara me ar e pështjellë, dhe e stolisur me ngjyra të ndryshme.

Pastaj gjithë prej asaj meshe nis të nxierë nëndë urdhëret më piesa më tri radhë kështu. Duke ngritur piesën e parë thotë :

Për nder dhe kujtim të kryeurdhërve të fortmëdhej Mihael dhe Gabriel, dhe të gjithë Fuqive Qiellore.

Dhe e vë më anën e mëngjër të Bukës së shëntë, anës mezit. Pastaj ngre piesën e dytë, duke thënë :

Të ndershmit dhe të lavdëruarit Profet, Parë-rendës dhe Pagëzor Joan ; të shëntëve dhe të lavdëruarve Profetër, Moisi dhe Aaron, Elia, Elis, David dhe Jesse ; të tre Diemve të shëntë, dhe Profetit Daniel, dhe të gjithë Profetërve të shëntë.

Dhe e vë nënë piesën e parë me regull. Duke ngritur piesën e tretë, thotë :

T' Apostujve të shëntë, të lavdëruar, dhe emërshkëlqyer Pietër dhe Paul, të Dymbëdhjetëve, dhe të Shtatëdhjetëve, dhe të gjithë Apostujve të shëntë.

Dhe e vë piesën e tretë nënë të dytën dhe mbaron radhën e parë. Pastaj ngre piesën e katërt, duke thënë :

T' Atërve tanë nërmiet shëntorët dhe Mësonjësve të Mëdhej Ekumenikë dhe kryepriftërve, Basilit të Math, Gregorit Theolog, dhe Joan Gojartit, Athanasit dhe Kyrillit, Nikollit të Myrave dhe tërë kryepriftërve të shëntë.

Dhe e vë pranë piesës së parë, duke bërë nisje të radhës së dytë. Pastaj ngre piesën e pestë, duke thënë :

Shën-Stefanit, dëshmorit të parë dhe kryediakut, Dëshmorëve të shëntë, të lavdëruar dhe të mëdhej, Gjergj Tropeprurësit, Demetrit Myrobletit, Theodorëve te Tyronit dhe krye-ushtarit, dhe të gjithë Dëshmorëve e Dëshmorkave të shënta.

Dhe e vë nënë piesën e parë të radhës së dytë. Pastaj ngre piesën e gjashttë, dhe thotë :

T' Atërve tanë oshënarë dhe Hyjprurës Andonit të Math, Efthimit, Paisit, Sabbës, Onufrit, Pietrit dhe Athanasit të Athonit, Dionisit te Olympit dhe tërë atyre që shkëlqyen që prej jete n' ashkëtismë.

Dhe e vë nënë piesën e dytë, dhe mbarohet radh' e dytë. Pastaj, duke ngritur piesën e shtattë, thotë :

T' Anargjëndëve të shëntë të lavdëruar dhe çudî-bërës, Kosma dhe Damian, Kyro dhe Joan, Pantelimon dhe Hërmola, Thalale, Tryfon dhe Kristofor, dhe të gjithave e të ghithëve Shën-Anargjëndër.

Dhe e vë sipër anës së dytës piesë, duke nisur radhën e tretë. Pastaj, duke ngritur piesën e tettë, thotë :

Të Hyjprindërve të shëntë e të drejtë Joakim dhe Annes, Josef Vlesorit, dhe Simeon Hyjpritësit ; dhe të shëntit të ditës *(aksh)*, te cilin po lusim sot, dhe të gjithe Shëntorëve tënt.

Dhe e vë nënë të shtattën piesë të radhës së dytë. Pastaj ngre piesën e nënttë.

T' Atit tonë nërmiet shëntorët Joan Kyrepshkopit të Konstantinopojës Gojartit *(ose të Basilit të Math, në qoftë se bëhet Mesha e tij)*, Meshën e të cilit të perëndishme po bëjmë ; ô i shënt' i Perëndisë, nërmjetô për ne.

Dhe e vë nënë piesën e tettë dhe kështu mbarohen tri radhat e nëndë Urdhërve. Pastaj merr thikën, pret dy copëra nga ajô

meshë, dhe merr nga njëra copë piesa për të gjallët dhe nga tiatëra për të ndyerit. Dhe duke mbajtur njërën copë me dorën e mëngjër me tre gjishtër, dhe me dorën e diathtë Shtijëzën e shëntë, thotë :

Kujtô, ô Zot, ç' do peshkopî Orthodoxësh dhe kryepeshkopin *(a peshkopin)* tonë *(aksh)*, të ndershmen Presbytërî, Diakonatën më Krisht dhe ç' do urdhër Priftëror.

Kujtô, ô Zot, Atin tonë Kathegumen *(aksh)* dhe tërë vëllezërit tanë të këtij Monasteri të shëntë dhe bashkë-meshëtarët tonë priftër, hierokllogjër, hierodiakër, kllogjër, e kllogjëresha, që i ftove më shokërine tënde, nga zëmër-bardhësia jote, ô Zot i Fortmirë.

Pastaj kujton emërin e atî për të cilin bëhet Mesha e Hyjëshme dhe ngre piesa të veçanta ; pastaj kujton atâ që dô dhe e lë këtë copë. Pastaj merr copën tiatër dhe thotë :

Lutemi edhe për kujtimin e lumur dhe ndiesën e mëkateve të Ndërtonjësve të lumur të këtij Monasteri të shëntë (ose të Kishës).

Pastaj kujton kryepriftin që e urdhroj dhe atâ që dô ; më në funt, duke zbritur piesa, kujton kështû :

Kujtô, ô Zot, Mbretër, Patrikër, Kryepriftër; Priftër, Hierokllogjër, Hierodiakër, Kllogjër, e Kllogjëresha; dhe gjithë Atërit dhe vëllezërit tanë Orthodoxë të ndyer në shokerinë Tënde me shpresë jete t' ameshuar, ô Zot njerzidashës

Dhe më s-ëfundi thotë kështû :

Kujtô, ô Zot, dhe pavlerësinë t' ime, dhe ndje më ç' do faj të dashur dhe të padashur.

Pastaj e lë dhe atë copë. Mbleth mirë presat e shpirteve me Shtijëzën nënë Bukën e shëntë ; lë Shtijëzën më vëndin e saj ; fshin buzët e Diskut të shëntë me mbulesen e shtruar mirë. Diskun e lë më vëntt të tij, dhe mbulesën e palos dhe e shpie n' Alltar të shëntë. Pastaj DIAKU pregatit temianicën dhe i a ep Priftit, duke thënë :

Bekô, ô Zot, temianë. Le t' i lutemi Zotit. Mëshirô, ô Zot.

Duke bekuar PRIFTI thotë Urimin e temianit.

Temian po të 'blatojmë, ô Krisht Perëndia jonë, si erë fragrance shpirtore ; prît-e te Alltari yt i përmiqiellshim, dhe na dërgô si çpërblim hirin e Shpirtit tënt të Tërëshëntë.

Pastaj PRIFTI merr Yllthin dhe i afërohet temianicës. DIAKU duke mbajtur temianiëcn e temianis duke thënë :

Le t' i lutemi Zotit.

Gjith' ashtû bën dhe për Mbulesat dhe për Erën. PRIFTI e vë Yllthin mi Bukën e shëntë dhe, si e puth, thotë :

Dhe erdhi Ylli dhe qëndroj përsipër, atie ku ish Dialthi.

Pastaj PRIFTI, duke marrë Mbulesën e parë, dhe si e temianis DIAKU duke thënë :

Le t' i lutemi Zotit.

Mbulon Diskun e shëntë, duke thënë :

Zoti mbretëroj, u-vesh me mirhiesî ; Zoti u-vesh dhe u-ngjesh me fuqî ; se shiguroj gjithësinë, e cila do të mos tundet.

Dhe, si e puth, e vë me reverim. Pastaj PRIFTI merr Mbulesën e dytë, dhe DIAKU bën siç u-tha sipër dhe i thotë Priftit :

Le t' i lutemi Zotit. Mbulô, ô Zot.

Dhe PRIFTI mbulon Qelqin e shentë, duke thënë :

Mbuloj qiejtë virtyti yt, ô Krisht, e dheu është plot prej lavdërimit tënt.

Pastaj, siç merr PRIETI Erën, DIAKU e temianis duke thënë :

Le t' i lutemi Zotit. Mbulô, ô Zot.

PRIFTI i mbulon që të dyja, Diskun dhe Qelqin, duke thënë :

Mbulô-na me hien e krahëve tënt ; dbô prej nesh ç' do armik dhe kundrështar ; paqësona-e jetën ; ô Zot, mëshirô-na ne dhe botën tënde, dhe shpëtô-i shpirtet tona, si i mirë dhe njerzidashës.

Pastaj merr PRIFTI Temianicën dhe temianis tri herë Parëvënjen, duke thënë :

E bekuar je, ô Perëndia jonë, që të pelqeu kështû ; lavdî më ty.

DIAKU ç' do herë thotë :

Për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Pastaj merr DIAKU Temianicën prej dorës së Priftit, passi e puth, i ep Librin dhe i thotë :

Për Parëvënjen e shëntë dhe hierore të Dhuratave të çëmuara, le t' i lutemi Zotit. Mëshirô, ô Zot.

PRIFTI këndon Urimin e Parëvënjes :

O Perëndî, Perëndia jonë, që dërgove Bukën qiellore, ushqimin e tërë botës, Zotin tonë, dhe Perëndinë Jesu Krisht, si Shpëtimtar, dhe Çpërblenjës, dhe Mirëbërës që na bekon e na shëntëron ; ti bekô dhe këtë Parëvënje dhe prit-e te Alltari yt i përmiqiellshim Kujtô, si i mirë dhe njerzidashës, atâ që 'blatuan, dhe atâ për të cilët 'blatuan ; dhe neve ruaj-na faqe-bardhë më shërbesën e shëntë të Mystereve tënt të hyjëshme. Se ësht i shëntëruar dhe i lavdëruar emëriyt i gjith-ndershim dhe madhështor, i Atit, e i Birit, dhe i Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Pastaj pas Urimit bën një Përlëshim të vogël, duke thënë :

Lavdî ty, ô Krisht Perëndî, shpresa jonë, lavdî më ty.

DIAKU :

Lavdî. Tanî. Mëshirô, ô Zot. O Zot i shëntë, bekô.

PRIFTI bën Përlëshimin e 'Blatës kështú :

Ay që lindi në Shpellë dhe fieti në grazhde për shpëtimin tonë (në qoftë e Dielë, thuaj dhe : *dhe u-ngjall së*

vdekurësh), Krishti Perëndia jonë e vërtetë, me nërmjetimet e Emës së tij së Pacinuar dhe të Shëntë ; të Profetìt Parërendës dhe Pagëzor Joan ; te shëntit të ditës *(aksh)* ; t' Atit tonë nërmiet shëntorët Joan Kryepeshkopit të Konstantinopojës Gojartit (ose : *të Shën Basilit të Math* në qoftë se bëhet Mesh' e tij); dhe të gjithë Shëntorëve na mëshiroftë e na shpëtoftë, si i mirë dhe njerzidashës.

Si mbarohet Përlsëhimi, falen që të dy, dhe PRIFTI puth kryqthi të shëntat, duke thënë :

Shënt Perëndî, Ati i Panisjeshim ; Shënt i Fuqishmë, Bir' i Bashkëpanisjeshim ; Shënt i Pavdekur, Shpirt' i Tërëshëntë ; Trinî e shëntë, lavdî më ty.

DIAKU, si. thotë *Amen* puth dhe ay anën e poshtme të Erës; temianis Parëvënjen e shëntë tri herë; gjith' ashtu dhe Alltar' e shëntë rreth-përqark kryqthi, duke thënë më vete këtô Tropare :

Në varrt trupërisht, në Ferr me shpirtin tënt si Perëndî, në Parrajsë me Kusarë, dhe në Fron bashkë me Atin e me Shpirtin, ishe, ô Krisht, ti i papërshkruari që mbush të gjitha.

Lavdî Atit....

Varri yt, ô Krisht, burim' i ngjalljes s' onë, urrëfye, si jetëprurës, më i bukur se Parrajsa, dhe, me të vërtetë, më i ndritshim se dhomë Mbretërore.

Tanî.... Hyjlindësore.

Gëzoh-u, ô tendësim i shëntëruar i Perëndisë së Lartë, se me anën tënde është dhënë gazi, ô Hyjlin-

dëse, nër atâ që thërresin : E bekuar je ti në mest të grave, ô Zonjë e Bardhë.

Pastaj del nga Dyert' e Tribunës dhe qëndron përpara Derës së Bukur; temianis Korët Zotërore, Fronin e Peshkopit, Vallet më të diatht' e më të mëngjër, duke thënë fshehtazi Psalmin 51. Pastaj hyn brënda andej ngaha dolli. Temianis përsërî Alltarë, Parëvënjen, dhe priftërinë ; e vë Temianicën më vëntt, dhe duke i u-afrëuar Priftit më të diathtë të Alltarit, karos, dhe me kokë unjur i thotë :

Eshtë kohë t' i shërbejmë Zotit. Bekô, ô Zot.

PRIFTI, duke shënuar kryet e Diakut, thotë :

E bekuar është Perëndia jonë, për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

DIAKU :

Lut-u për mua, ô Zot i shëntë.

PRIFTI :

Zoti i drejtësoftë përçapet e tua më ç' do punë të mirë.

DIAKU :

Kujtô-më, ô Zot i shëntë.

PRIFTI :

Zoti Perëndî e kujtoftë hierodiakërinë tënde, në Mbretërî të tij, për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

DIAKU, passi thotë *Amen*, falet, puth Ungjillin, Alltarë të diathtën e Priftit dhe del nga Dyert' e shënta. Dhe, si unj kryet, falet fshehtazi këtô :

Mbret qiellor, Ngushëllimtar.....

Lavdî Perëndisë më të lartat, dhe mi dhenë paqja, dhe mi njerëzit mirëdashja. (Tri herë.)

O Zo', çel-m' i buzët dhe goja ime do t' a lajmërojë lavdimin tënt. (Dy herë.)

Pastaj DIAKU : " Bekô, ô Zot „.
PRIFTI : " E bekuar është Mbreteria e Atit, ... „
(Shëkô në Meshë të Gojartit.)
S. P. Këtô të 'Blatës thohen të gjitha fshehtazi.

BKSH

MESH' E PERËNDISHME E ATIT TONË NËRMIET SHËNTORËT JOAN GOJARTIT.

DIAKU del nga Tribuna dhe, duke qëndruar më vendin e tij të zakonëshm, falet tri herë dhe thotë :

Bekô, ô Zot.

PRIFTI ngre Ungjillin dhe thotë me zë të lartë :

E bekuar është Mbretëria e Atit, e Birit, dhe e Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. (Bën shënjën e kryqit me Ungjillë përmi Antimensin.

VALLEJA :

Amen.

DIAKU, a në mos ka, PRIFTI vetë thotë :

LITANI E MADHE.

Më paqje le t' i lutemi Zotit.

VALLEJA :

Mëshirô, ô Zot. (Gjithë kështu thotë dhe në ç' do lutje të Paqësoreve.)

Për paqjen që-lartazi, dhe për shëllbimin e shpirteve tona, le t' i lutemi Zotit.

BKSH

Për paqjen e tërë botës. mirqëndrimin e Kishërave të shënta të Perëndisë, dhe për bashkimin e të gjithave, le t' i lutemi Zotit.

Për këtë Shtëpî të shëntë, dhe për atâ që hyjnë brënda në të me besë, devotesë, dhe frikë Perëndie, le t' i lutemi Zotit.

Për Kryepeshkopin tonë (aksh), të ndershmen Presbytërî, dhe Diakonatën më Krisht, për tërë Klerin dhe Popullin, le t' i lutemi Zotit.

Për Presidentin e Shteteve të Bashkuar (apo për Mbretin, a Perandorin e vëndit ku bëhet Mesha), Ushtërinë dhe Aniesin' e tij, le t' i lutemi Zotit.

Që të lëftojë bashkë me të dhe të përmbysë nënë këmbët e tij ç' do armik dhe kundrështar, le t' i lutemi Zotit.

Për këtë Kishë të shëntë (a Monaster), ç' do qytet, dhe vënt, dhe për atâ që rrinë nër tô me besë, le t' i lutemi Zotit.

Për tempërim të mirë të erërave, rrafshërî të pemëve të dheut, dhe për kohëra të paqëshme, le t' i lutemi Zotit.

Për atâ që lundrëzojnë, që udhëtojnë, për të sëmurët, vuajtësit, robërit, dhe për shëllbimin e tyre, le t' i lutemi Zotit

Që të shpëtohemi prej ç' do hidhëmërie, reziku, dhe nevoje, le t' i lutemi Zotit.

Përkrah-na, shpëtô-na, mëshirô-na, dhe ruaj-na, ô Perëndî, me hirin të t.

T'ëreshënten, të pacinuarën, të përmibekuarën,

të lavdëruarën Zonjën tonë Hyjlindëse, dhe gjithmon virgjërën Marî, bashkë me gjithë Shëntorët duke kujtuar veten tonë dhe njërjatërin, dhe gjithë jetën tonë, Krishtit Perëndisë le t' i a pranojmë.

VALLEJA :

Ty, ô Zot.

PRIFTI me zë të lartë :

Se ty të ka hie ç' do lavdî, nderim dhe adhurim, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

VALLEJA :

Amen. — Me nërmjetimet e Hyjlindëses, Shpëtimtar, shpëtô-na. (4 herë.) Ose në vënt të kësaj, thohet Psalmi 103. Kur këndohet prej Valleve Antifon' i Parë, Prifti këndon Urimin. Diaku, passi falet, shkon e qëndron përpara Hyjlindëses, duke shëkuar Korën e Krishtit.

Urim' i Antifonit të Parë, që e thotë PRIFTI fshehtazi.

O Zot Perëndia jonë, pushteti i të cilit është i pakorësuar, dhe lavdia e pakupëtuar ; përdëllim' i të cilit ësht' i panëmëruar, dhe njerzidashja e patreguar : Ti, ô Zot, pas zëmërdhëmpshërisë s' ate, hith synë mi ne dhe mi këtë Shtëpî të shëntë dhe bëj që të jenë me ne dhe me atâ që luten bashkë me ne përdëllimet dhe dhëmpshërirat e tua të pasura.

Passi mbarohet Antifon' i Parë, DIAKU vien dhe, duke qëndruar më vëndin e zakonëshm, thotë :

LITANI E VOGËL.

Përsëri dhe përsëri më paqje le t' i lutemi Zotit.

VALLEJA:

Mëshirô, ô Zot.

Përkrah-na, shpëtô-na, mëshirô-na, dhe ruaj-na, ô Perëndî, me hirin tënt.

Tërëshënten, të pacinuarën, të përmibekuarën, të lavdëruarën Zonjën tonë Hyjlindëse, dhe gjithmon virgjërën Marí, bashkë me gjithë Shëntorët, duke kujtuar veten tonë dhe njërjatërin dhe tërë jetën tonë, Krishtit Perëndisë le t'i a pranojmë.

VALLEJA:

Ty, ô Zot.

PRIFTI me zë të lartë:

Se jotja është lartmadhësia, edhe jotja është Mbretëria, edhe fuqia, edhe lavdia, e Atit, e Birit, dhe e Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

VALLEJA:

Amen. — Shpëtô-na, ô i Bir' i Perëndisë, që u-ngjalle së vdekurësh, ne që të këndojme. Alleluia. (Katër herë.)

Lavdî Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

O i Bir' i vetëm dhe Fial' e Perëndisë që je i pavdekur, dhe dignove, për shëllbimin tonë, të mishërohesh prej Hyjlindëses së shëntë dhe gjithmon virgjërës Marí, e u-bëre njeri pa ndryshuar; që u-kryqësove për ne, ô Krisht Perëndî, edhe shkele

vdekjen me vdekje ; që je një prej Trinisë së Shëntë dhe lavdërohesh bashkë me Atin e me Shpirtin Shënt, shpëtô-na.

Ose në vënt të këtyre thohet Psalmi 145.

PRIFTI fshehurazi thotë këtë :

URIM' I ANTIFONIT TË DYTË.

O Zot, Perëndia jonë, shpëtô popullin tënt dhe bekoj-e trashëgimin tënt; rrafshërin' e Kishës s' ate ruaj-e, shëntëroj-i atâ që dëshërojnë mirhiesin' e Shtëpisë s' ate. Ti lavdëroj-i për çpërblim me fuqinë tënde të perëndishme dhe mos na lêr ne që shpresojmë më ty.

DIAKU thotë Litanin' e Vogël :

Përsëri dhe përsëri....., (shëkô më sipër).

PRIFTI me zë të lartë :

Se ti je Perëndî' e mirë dhe njerzidashëse dhe ty të dërgojmë lavdî, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

Urim' i Antifonit të Tretë, *që e thotë Prifti fshehtazi :*

Ti që na fale këtë lutje të përbashkme dhe të bashkëzëshme, që u-zotove t' u falsh kërkimet dhe dyve dhe treve, që janë më një mëndje më emërin tënt; ti dhe tanî mbaroj-i dhe kërkimet e shërbëtorëve tënt pas së mirës s' ate, duke u falur kupëtimin e së vërtetës s' ate më shekullin e tanishmë, dhe duke u dhuruar jetën e ameshuar më kohën për-të-ardhur.

Pastaj këndohen Lumërimet, ose Përlëshorja Ngjallësore. Prifti merr Ungjillë, i a ep Diakut dhe kështu dalin nga Der' e Veriut dhe bëjnë Hyrjen e Vogel pas zakonit.

URIM' I HYRJES S' UNGJILLIT TË SHËNTË,
që e thotë PRIFTI fshéhtazi.

O Zot, Perëndia jonë, që vëndose nër qiejtë urdhëre dhe ushtërira Engjëjsh dhe Kryeëngjëjsh, për meshim të lavdise s' ate, bëj bashkë me hyrjen tonë të bëhet dhe një hyrje Engjëjsh të shëntë për të meshuar mirësisë s' ate bashkë me ne. Se ty të ka hie ç' do lavdí, nderim, dhe adhurim, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

Passi mbarohet kiô, DIAKU i thotë Priftit, duke rrëfyer nga Lindja me dorën e diathtë, dhe duke mbajtur Orarë me tre gishtër :

Bekô, ô Zot, Hyrjen e shëntë.

PRIFTI, duke bekuar, thotë :

E bekuar është Hyrja e Shëntorëve tënt, përgjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

Pastaj Diaku shkon te Kryeprifti ose Hegumeni, që t' a puthë Ungjillë, në ka; në mos ka, e puth Prifti. Siç mbarohet Tropari, DIAKU vien e qëndron në mest përpara Priftit dhe thotë me zë të math :

Urtësî, ô të drejtë.

Ejani le t' i falemi e t' i biem nër këmbë Krishtit.

Shpëtô-na, ô i Bir' i Perëndisë, që u-ngjalle së vdekurësh, ne që të këndojmë. Alleluia.

Pastaj thohet Përlëshorja Ngjallësore, Përlëshorja e Shëntit, në ka, Tropar' i Shëntit të. Kishës edhe kiô Shkurtore, në qoftë se s' thohet Shkurtorja e nonjë të Krëmteje të Madhe :

HYJLINDËSORE.

Mburonj' e të Krishterëve e paturpëruar, nërmjetim te Krijetari i paçvëndosur, mos çvështrô zëra lutjesh prej mëkatarësh, po arrî si e mirë për të na ndihmuar, ne që të thërresim besërisht : Nxitô ndë nërmjetim dhe shpejtô në lutje, ô Hyjlindëse që mpron ngaherë atâ që të nderojnë.

Pas këtyre thotë DIAKU :

Le t' i lutemi Zotit.

PRIFTI me zë te lartë :

Se i shëntë je, ô Perëndia jonë, dhe ty të dërgojmë lavdî Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë.

DIAKU :

E në jetë të jetëve.

VALLEJA :

Amen. Shënt Perëndî, Shënt i Fuqishmë, Shënt i Pavdekur, mëshirô-na. (Tri herë).

Lavdî Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt.

Tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Shënt i Pavdekur, mëshirô-na.

DIAKU :

Fuqî.

VALLEJA nga-dale :

Shënt Perëndî, Shënt i Fuqishmë, Shënt i Pavdekur, mëshirô-na.

Kur këndohet Trishënti, Prifti thotë këtë Urim fshehtazi :

URIM' I HYMNIT TRISHËNTOR.

O Perëndî e shëntë, që prëhesh nër Shëntorët, që përhymnohesh me zë të trishëntë prej Serafimeve, që lavdërohesh prej Qerubimeve, dhe që adhurohesh prej ç' do Fuqie qiellore ; që e bëre gjithësinë të jetë nga e mosqëna ; që gatove njerinë pas korës dhe pas shëmbëllsisë s' ate, dhe e përstolisë me ç'do dhuratë tënde ; ti që i ep urtësî dhe kupëtim atî që lyp, dhe nuk çvështron mëkatarin, po vure pendimin për shpëtim ; që na vlerësove ne shërbëtorët e tû të përunjët e të pavyer të qëndrojmë dhe më këtë orë përpara lavdisë s' Alltarit tënt të shëntë dhe të të siellim adhurimin dhe lavdërimin që të dëtyrojmë: Ti, ô Zot, prit dhe prej gojës s' onë së mëkatarëve Hymnin Trishëntor, dhe vështrô-na në mirësî tënde. Ndje-na ç' do faj të dashur dhe të padashur; shëntërô-na shpirtet dhe trupet dhe ep-na të t' adhurojmë m' oshënarî tërë ditët e jetës s' onë ; me nërmjetimet e Hyjlindëses së shëntë dhe të gjithë Shëntorëve që të kanë pëlqyer prej jete. Se i shëntë je, ô Perëndia jonë, dhe ty të dërgojmë lavdî Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

Kur thohet Hymni Trishëntor prej Valles, e thonë dhe Prifti me Diakun për-së-treti ; dhe në meshon Kryeprift, a me-

SHËN JOAN GOJARTI

BKSH

shojnë shumë Priftër bashkë, këndohen prej Tribunës për-sëtreti ; pastaj i thotë DIAKU Priftit :

Urdhërô, ô Zot.

Dhe shkojnë në Kathedrë, a në Parëvënje, dhe PRIFTI thotë :

I bekuar ësht ay që vien më emërin e Zotit.

DIAKU :

Bekô, ô Zot, Kathedrën lart.

PRIFTI :

I bekuar je ti që je majë fronit të lavdëruar të Mbretërise s' ate, ti që rri mi Qerubimet për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

Passi mbarohet Hynmi Trishëntor, DIAKU vien përpara Dyerve të shëntaj, e thotë :

Le të vëmë re. Urtësî, le të vëmë re.

Këndohet Apostulli dhe, si mbarohet, thotë PRIFTI :

Paqje mi ty që ligjëron dhe mi tërë popullin.

VALLEJA :

Alleluia. (Tri herë). Më të kënduarit e saj DIAKU temianis, dhe PRIFTI thotë këtë Urim fshehtazi :

URIM PARA UNGJILLIT.

Shkëlqe nër zëmrat tona, ô Zot njerzidashës, dritën e pamplakur të hyjdijes s' ate, dhe çel-i syt' e mëndjeve tona më kupëtimin e lëçitjeve tënde un-

gjillësore ; vër brënda nër ne dhe frikën e urdhëratave tënde të lumura, që, duke shkelur dëshirat mërshore, të shkojmë jetë mëndore, duke mejtuar e duke bërë të gjitha atô që të pëlqejnë; Se ti je ndritshimi i shpirteve dhe i trupeve tona, ô Krisht Perëndi, dhe ty të dërgojmë lavdî, bashkë me Atin tënt të panisjeshim, dhe me tëreshëntin, të mirin, dhe jetëdhënësin Shpirtin tënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

DIAKU, passi temianis, vien te Prifti dhe, duke i unjur kryet, e duke mbajtur Ungjillin me Orarë, thotë :

Bekô, ô Zot, Ungjillor' e Apostullit të shëntë dhe Ungjillor. (Aksh.)

PRIFTI e shënon me kryq e thotë :

Perëndia, me nërmjetimet e Apostullit të shëntë e të lavdëruar dhe Ungjillor (aksh), le të t' apë ty ungjillonjësit fialë me fuqî të shumë, për mbarimin e Ungjillit të Birit të tij të dashur dhe Zotit tonë Jesu Krisht.

Dhe, siç shkon Diaku dhe qëndron më vëndin e zakonëshm, PRIFTI thotë :

Urtësî, ô të drejtë ; le të dëgjojmë Ungjillin e shëntë ; paqje mi ju të gjithë.

VALLEJA :

Dhe me frymën tënde.

DIAKU :

Këndimi prej Ungjillit të shëntë pas... (Aksh.)

PRIFTI :

Le të vëmë re.

VALLEJA :

Lavdî më ty, ô Zot, lavdî më ty.

Si mbarohet Ungjilli PRIFTI i thotë Diakut :

Paqje mi ty që ungjillëson.

VALLEJA :

Lavdî më ty, ô Zot, lavdî më ty.

DIAKU, si i a ep Priftit Ungjillë dhe si qëndron më vëndin e tij të zakonëshm thotë :

LITANI E GJERË.

Le të thomi me gjithë shpirtin dhe me gjithë mëndjen tonë le të thomi.

VALLEJA :

Mëshirô, ô Zot. (Tri herë.)

O Zot i Tërëfuqishim, Perëndî e Atërve tanë, të lutemi, dëgjô e mëshirô.

Mëshirô-na, ô Perëndî, pas mëshirës s' ate së madhe, të lutemi, dëgjô e mëshirô.

URIM' I LITANISË SË GJERË, që e thotë PRIFTI fshehtazi.

O Zot, Perëndia jonë, akseptô këtë litanî të gjerë prej shërbëtorëve tënt, dhe mëshirô-na pas shumicës së mëshirave të tua ; dhe dërgô dhëmpshërit' e

tua mi ne dhe mi tërë popullin tënt, që pret prej teje mëshirën e pasur.

DIAKU :

Lutemi edhe për të Krishterët pietozë dhe orthodoxë.

Lutemi edhe për Kryepeshkopin tonë... (Aksh.)

Lutemi dhe për tërë vëllezërit tanë, Priftër, Hierokllogjër, dhe gjithë vëllazërinë t' onë më Krishtin.

Lutemi edhe për Ndërtonjësit e lumur dhe të përkujtuarshim të kësaj Kishe së shëntë (ose Monaster), dhe për tërë vëllezërit dhe atërit tanë të prëhur para nesh, dhe orthodoxët që ndehen këtû e kudô.

Lutemi dhe për mëshirë, jetë, paqje, shëndet, shpëtim, vështrim, ndjesë dhe falje të mëkatave të shërbëtorëve të Perëndisë, dhe për gjithë të Krishterët orthodoxë, famulltarë, epitropë dhe ndihmëtarë të këtî Tempulli të shëntë.

Lutemi edhe për atâ që siellin pemë dhe vepra të mira në këtë Tempull të shëntë, që mundohen, që këndojnë, dhe për popullin që rri rrotull, dhe pret mëshirën e madhe e të pasur prej teje.

PRIFTI me zë të lartë :

Se Perëndî mëshirëplote dhe njerzidashëse je, dhe ty të dërgojmë lavdî, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

Këtû PRIFTI merr Ungjill' e shëntë dhe bën kryq mi Antimensin e shëntë. DIAKU thotë :

LITANI E KATEKUMENËVE.

Lutuni Zotit, ju Katekumenët.
Ne besnikët le të lutemi per Katekumenët.
Që t' i mëshirojë Zoti.
Që t' i kateqisë më fialën e së vërtetës.
Që t' u zbulojë Ungjill' e drejtësisë.
Që t' i bashkojë me Kishën e shëntë të Përgjithëshme dhe Apostollore.
Shpëtô-na, mëshirô-na, përkrah-na dhe ruaj-na, ô Perëndî me hirin tënt.
Ju katekumenë, krerët tuaja unjiani Zotit

URIMI I KATEKUMENËVE, që e thotë PRIFTI fshehtazi, para se të ndehet Antimensi.

O Zot, Perëndia jonë, që rri më të lartat dhe përmiqyr të përunjurat, që i dërgove gjindjes së njerësve për shpëtim Birin tënt të Vetëm dhe Perëndî, dhe Zotin tonë Jesu Krisht, hith synë mi shërbëtorët tënt katekumenë, që të kanë unjur xverkun e tyre ; dhe vlerësoj-i më kohë të mbarë për banjën e përlindjes, për ndiesën e mëkatave, dhe për robën e paprishjes ; bashkoj-i me Kishën tënde të shëntë, të Përgjithëshme, dhe Apostollore, dhe nëmëroj-i bashkë me kopenë tënde të zgjedhur.

PRIFTI me zë të lartë :

Që të lavdërojnë dhe atâ bashkë me ne emërin tënt të ndershim dhe madhështor, të Atit, e të Birit,

edhe të Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

PRIFTI nden Antimensin. DIAKU :

Sa jini katekumenë shkoni ; katekumenët, shkoni. Asnjë prej katekumenët [të mos mbetet]. Sa janë besnikë-

Përsëri dhe përsëri më paqje le t' i lutemi Zotit.

MESH' E BESNIKËVE.

URIM' I PARË I BESNIKËVE, që e thotë PRIFTI fshehtazi, si ndehet Antimensi.

Të përhirojmë, ô Zot, Perëndî e Fuqive, që na vlerësove të qëndrojmë dhe tanî përpara Alltarit tënt të shëntë e të përbiem nër dhëmpshërit' e tua për mëkatat tona dhe për padijet e popullit. Prit, ô Perëndî, faljen tonë ; bë-na të vyer të mblatojmë, falje, lutje, dhe therore të pagjakëshme për gjithë popullin tënt ; dhe bë-na të zottë ne, që vure më shërbimin tënt, me fuqinë e Shpirtit tënt Shënt, të të përgrishojmë më ç' do kohë e më c' do vënt, faqebardhë dhe pa ndalim, me dëshmim të qëruar të vetëdijës s' onë, që të na dëgjosh e të bëhesh i mëshirëshm në shumicë të mirësisë s' ate.

DIAKU :

Përkrah-na, shpëtô-na, mëshirô-na, dhe ruaj-na, ô Perëndî, me hirin tënt. Urtësî.

PRIFTI me zë të lartë :

Se ty të ka hie ç' do lavdî, nderim, dhe adhurim,

Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

DIAKU :

Përsëri dhe përsëri, më paqje le t' i lutemi Zotit.

URIM' I DYTË I BESNIKËVE, që e thotë PRIFTI fshehtazi.

Prapë e shumë herë të biem nër këmbë e të lutemi, ô i mirë dhe njerzidashës, që të hedhësh synë-mi faljen tonë dhe të na i paqësosh shpirtet e trupet prej ç' do ndotësie, e të na falsh qëndrim përpara Alltarit tënt të shëntë pa faj e pa denim. Dhurôj-u, ô Perëndî, dhe atyre që falen bashkë me ne pëparim jete, dhe bese, dhe kupëtimi mëndor ; ep-u që të t' adhurojnë të pafajshim për gjithmonë me frikë e me dashurî, dhe të piesëtojnë pa dënim Mysteret e tua të shënta, dhe të vlerësohen për Mbretërinë tënde qiellore.

DIAKU :

Përkrah-na, shpëtô-na, mëshirô-na, dhe ruaj-na, ô Perëndî, me hirin tënt.

PRIETI me zë të lartë :

Që të mundim, të ruajtur për gjithmonë prej fuqisë s' ate, të të dërgojmë lavdî, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

VALLEJA :

Amen.

Dhe me-një-herë thotë :

HYMNI QERUBIK.

Ne që korëzojmë mystikërisht Qerubimet dhe hymnin Trishëntor Trinisë jetëdhënëse po i këndojmë, le të hedhim lark nesh ç' do kujdes rrojtjeje. Se Mbretnë... (Këtû del Prifti jashtë me kungatën) e të gjithave do të presim, duke patur pas padukurisht Urdhëret Engjëllore. Alleluia, alleluia, alleluia.

URIMI, që thohet fshehtazi prej Priftit, kur këndohet Hymni Qerubik:

Asnjë nga të përlidhurit me dëshirat dhe volyptetet mërshore s' është i vyer të të vinjë pranë, a të t' afërohet, a të të meshojë, ô Mbret i lavdisë, se të shërbyerit te ty është gjë e madhe dhe e trëmpshime dhe për vetë Fuqitë qiellore. Mirë-po, nga njerzidashja jote e patreguar dhe e panëmëruar, u-bëre njeri pa ndryshuar e pa jatëruar, dhe pate qënë Kryeprifti ynë, dhe na përdhe shërbesën e shëntë të kësaj therroreje të pagjakëshme dhe liturgike, si Zot i të gjithave Se ti vetëm, ô Zot Perëndia jonë, zotëron mi qielloret e mi të dheshmet, ti që rri mi fronë qerubik, Zot i Serafimeve, dhe Mbret i Israelit, i vetëmi Shënt dhe i prëhur nër Shëntorët. Ty pra të lutem të vetëmit të mirë dhe gatî për të dëgjuar. Hith synë mi mua shërbëtorin tënt mëkatar e të padobishim, dhe spastrô-m' a shpirtin dhe zëmërën prej ndërgjegjjeje të ligë; dhe bëj-më të zotin me fuqin' e Shpirtit Shënt, të veshur me hirin e Priftërisë, të

qëndroj përpara kësaj Tryezës s' ate së shëntë, dhe të ministëroj Trupin tënt të shëntë e të pacinuar dhe Gjakun tënt të çëmuar. Se te ty vij, duke unjur xverkun t' im, e po të lutem : Mos kthe faqen tënde prej meje, as mos më hith tej prej diemvet e tû, po dignô të të 'blatohen këtô dhurata prej meje, shërbëtorit tënt mëkatar e të pavyer. Se ti je 'blatonjësi dhe i 'blatuari, pritësi dhe i përndari, ô Krisht Perëndia jonë, dhe ty të dërgojmë lavdî, bashkë me Atin tënt të panisjeshim, dhe tëreshëntin, të mirin dhe jetëdhënësin Shpirtin tënt, taní e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Kur këndohet Hymni Qerubik, ligjërohet prej PRIFTIT fshehtazi tri herë me duartë përpjetë :

Ne që korëzojmë.. ...

DIAKU :

Se Mbretn' e të gjithave....

Pastaj PRIFTI temianis Alltar' e shëntë,duke thënë me vete këtô Tropare :

Në varrt trupërisht.... (Shëkô ne 'Blatë).
Lavdî... Varri yt, ô Krisht....
Tanî... Gëzoh-u, ô tendësim....

Pastaj qëndron në Derë të bukur,duke thënë fshehtazi "Ejani t' i falemi „ tri herë dhe Psalmin 51, temianis Korat e shënta dhe popullin dhe — kur arrin te vargu " Atëhere do t' pëlqesh therore drejtërie, dhurata dhe holokoste „ — Hyn në Tribunë të shëntë, temianis përsëri Alltarë, Parëvënjen dhe tërë priftërinë,

vë temianicën më vëntt, dhe BASHKË ME DIAKUN qëndrojnë përpara Alltarit të shëntë duke thënë këtô :

Mëkatova te ty, ô Shpëtimtar, si Biri Prodig ; prit-më, ô Atë, të penduar, dhe mëshirô-më, ô Perëndî.

Të thërres, ô Krisht Shpëtimtar, me zën' e Kumerqarit ; fal-më si dhe atë, dhe mëshirô-më, ô Perëndî.

Mprojtjen dhe ndihmën tënde të shpejtë dhe përdëllimin rrëfê-i mi shërbëtorin tënt, dhe zbut-i valët e mejtimeve të kotta, ô e Kulluar, dhe shpirtin t' im ngrej-e, ô Hyjlindëse ; se e di, e di, ô Virgjëreshë, që munt t' i bësh sa që të duash.

Dhe si falen që të dy për-së-treti atî Alltari, puthin Antimensin e shëntë, kthehen nga populli dhe, duke unjur kryet, shkojnë te Parëvënja e shëntë, dhe PRIFTI thotë këtô Tropare :

Si i rënë nër kusarë, dhe i plagosur, ashtû dhe unë rashë nga mëkatat e mia dhe shpirti im është plagosur ; te cili të përikëj unë fajtori, veç te ty zëmër-dhëmpshuri dhe mieku i shpirteve ? Derth mi mua, ô Perëndî, përdëllimin tënt të math.

Si Biri Prodig erdha dhe unë te ty, ô Mëshirëplot ; prit-më që të bie nër këmbë, dhe mëshirô-më.

Ty që vishesh me dritën si robë, si të zbriti Josefi prej drurit bashkë me Nikodemin, e të pâ të vdekur, të çveshur, e të pavarrosur, të nisi një vaj të mallëngjyer e, duke vajtuar, po thoshte : Mier' unë, ô

fort i ëmbël Jesu ! të cilin, para pak kohe, kur të pâ dielli të varrur më Kryq, pështilléj me errësirë, dhe dheu valonte nga frika, dhe çahej kurtin' e tempullit ; po ja tanî po shëkoj që durove vdekje për mua vullnetarisht.

Si të të varros, ô Perëndia ime ? a po si të të pështiéll me pëlhura ? dhe me ç' duar t' i mpshtetem Trupit tënt të pamplakur ? a po ç' këngë t' i këndoj exodit tënt, ô Zëmër-dhëmpshur ? Madhështoj Pësimet e tua, përhymnoj dhe varrimin tënt, bashkë me Ngjalljen, duke thirrur : lavdî më ty.

Passi mbarohen këtô, thonë :

O Zot, fal-më mua mëkatarin dhe mëshirô-më. (Tri herë.)

Pastaj puthîn të shëntat, duke thënë :

Shënt Perëndî, At i Panisjeshim..... (Shëkô në Blatë.)

DIAKU i thotë Priftit :

Ngrej-i, ô Zot.

PRIFTI merr Erën dhe i a vë Diakut mi supet, duke thënë :

Më paqje ngreni duartë tuaja në të shëntat, dhe bekoni Zotin.

Pastaj merr Diskun e shëntë dhe i a vë Diakut mi krye, duke thënë :

Hipi Perëndia me brohorî, Zoti me zë trumpete.

Merr dhe Prifti Qelqin e shëntë dhe dalin nga der' e Veriut; DIAKU thërret:

Të gjithë ne na kujtoftë Zoti Perëndí në Mbretërí të tij për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

VALLEJA:

Amen.

Pastaj PRIFTI:

Presidentin e Shteteve të Bashkuar, Ushtërinë dhe Aniesin' e tij. (A në qoftë se Mesha bëhet në tiatër Shtet, kujtohet emëri i Mbretit të vëndit.)

Të gjithë të Krishterët pietozë dhe Orthodoxe, që rrinë e ndodhen në këtë qytet, famulltarët, epitropët, ndihmëtarët, dhe përsëritësit e ketî Tempulli të shëntë, ndërtonjësit e lumur të tij, dhe priftërinë tonë e kujtoftë Zoti Perëndí në Mbretërî të tij përgjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

VALLEJA:

Amen.

(Në Meshon bashkë nonjë Kryeprift « Kryepriftërinë tënde e kujtoftë » ... etc.) Passi bëhet hyrja e dhuratave të çëmuara, Diaku qëndron më të diathtë të Alltarit, duke mbajtur Diskun mi kokë, dhe i thotë Priftit a Kryepriftit: « Kryepriftërinë tënde, a Priftërinë tënde e kujtoftë Zoti... etc. » Dhe Prifti a Kryeprifti Diakut: « E kujtoftë Zoti Perëndî hierodiakërinë tënde në Mbretërî... etc. »

PRIFTI e vë Qelqin e shëntë mi Antimensin më anën e diathtë dhe Diskun, si e merr nga kryet e Diakut, e vë m' anë të mëngjër, duke thënë këtô Tropare:

Bujari Josef, si e zbriti prej drurit trupin tënt të

pacinuar, e pështolli me pëlhurë të paqme dhe me aroma, dhe me vaje e vuri në një varr të ri.

Grave myrrëprurëse, duke qëndruar pranë varrit, Engjëlli u thërriste : Myrrat u kanë hie të vdekshimve, po Krishti u-rrëfye i huaj për prishjen.

Kur zbrite te vdekja ti, ó jeta e pavdekur, atëhere Skëterrën e vdiqe me shkëlqimin e Hynisë ; dhe kur ngrite të vdekurit nga fundet e dheut, atëhere Fuqitë qiellore të thërrisnin : Jetëdhënës Krisht, Perëndia jonë, lavdi më ty.

Pastaj merr Erën prej supeve të Diakut dhe, si e temianis, mbulon të Shëntat dhe i puthin ; pastaj DIAKU i thotë Priftit :

Mirësôj-i, ó Zot

PRIFTI merr Temianicën dhe i temianis, duke thënë fundin e Psalmit 51 :

Atëhere do të shpien viçër mi alltarin tënt.

I' a ep Temianicën Diakut, i cili e vë më vëntt. Pastaj i thotë PRIFTI Diakut :

Kujtô-më, ó vëlla dhe bashkëmeshor.

DIAKU :

E kujtoftë priftërine tënde Zoti Perëndi në Mbreterî të tij...

Pastaj DIAKU i unj kryet Priftit, duke mbajtur Orarë me dorën e diathtë dhe i thotë :

Lut-u për mua, ó Zot i shëntë.

PRIFTI :

Shpirti Shënt do të vijë mi ty dhe fuqia e të Lartit do t' të hiesojë.

DIAKU :

Vetë Shpirti do t' meshojë bashkë me ne, tërë ditt' e jetës s' onë

Përsërî DIAKU :

Kujtô-më, ô Zot i shëntë.

PRIFTI :

Të kujtoftë Zoti Perëndí në Mbretërî të tij përgjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

DIAKU, si puth të diathtën e Priftit, del te Tribun' e shëntë dhe, duke qëndruar më vëndin e tij të zakonëshm, thotë me zë ë lartë :

Le t' i a mbarojmë lutjen tonë Zotit.

VALLEJA :

Mëshirô, ô Zot. (Gjith' ashtû dhe më tutje.)

Për Dhuratat e çëmuara të parëvëna, le t' i lutemi Zotit.

Për këtë Shtëpí të shëntë, dhe për atâ që hyjnë brënda në të me besë, devotesë, dhe frikë Perëndie, le t' i lutemi Zotit.

Që të shpëtohemi prej ç' do hidhërimi, mërie, reziku dhe nevoje, le t' i lutemi Zotit.

BKSH

URIM I 'BLATËS,

që e thotë PRIFTI fshehtazi, passi vihen Dhuratat e Hyjëshme në Alltar të shëntë.

O Zot, Perëndî e tërëfuqishme, i vetëmi i shëntë, që pret therore lavdëremi prej atyre që të përthërresin me gjithë zëmër, prit dhe faljen tonë të mëkatarëve, dhe shpier-e n' Alltarë tënt te shëntë ; dhe bëj-na të zottë të të 'blatojmë Dhurata dhe therore të shpirtëshme për mëkatat tona dhe për padijet e popullit. Vlerësô-na që të gjejmë hir përpara teje, dhe të pritet mirë prej teje theroreja jonë, dhe të tendësojë Shpirti i mirë i hirit tënt mi ne, dhe mi këtô Dhurata të parëvëna, dhe mi tërë popullin tënt.

DIAKU me zë të lartë :

Përkrah-na, shpëtô-na, mëshirô-na dhe ruaj-na, ô Perëndî, me hirin tënt.

Ditën të tërë, të mbarë, të shëntë, të paqëshme dhe të pamëkatëshme le t' i lypim Zotit.

VALLEJA :

Fal-na, ô Zot. (Gjith' ashtu më tutje.)

Engjëll paqjeje, udhëheqës besnik, ruajtës të shpirteve dhe të trupeve tona, le t' i lypim Zotit.

Ndiesë dhe falje të mëkateve dhe të fajeve tona le t' i lypim Zotit.

Të mirat e të dobishmet për shpirtet tona, dhe paqje për botën, le t' i lypim Zotit.

Që të shkojmë kohën e rrojtjes s' onë që na mbetet më paqje e më pendim le t' i lypim Zotit.

Mbarim të krishterë të jetës s'onë pa dhëmbje, faqebardhë dhe të paqëshmë, dhe mprojtje të mirë përpara Gjykatores së trëmpshime të Krishtit le të lypim.

Tërëshënten, të pacinuarën, të përmibekuarën, të lavdëruarën, Zonjën tonë Hyjlindëse dhe gjithmon-virgjërën Marî, bashkë me gjithë Shëntorët duke kujtuar veten tonë dhe njërjatërin, dhe gjithë jetën tonë Krishtit Perëndisë le t' i a pranojmë.

VALLEJA :

Ty, ô Zot.

PRIFTI me zë të lartë :

Me përdëllimet e të vetëmit t' yt Bir, me të cilin je i bekuar, bashkë me tërëshëntin, të mirin, dhe jetëdhënësin Shpirtin tënt, taní e përherë, e në jetë të jetëve.

VALLEJA :

Amen.

PRIFTI :

Paqje mi ju të gjithë.

VALLEJA :

Dhe me frymën tënde.

DIAKU :

Le të duam njërjatërin që të rrëfejmë me një mëndje —

VALLEJA :

Atin, e Birin, edhe Shpirtin Shënt, Trininë e Bashkëqënurshme dhe të pandarë.

DIAKU :

Dyertë ! Dyertë ! me urtësí le të vëmë re.

Prifti, si falet tri herë, puth Dhuratat e shënta siç janë të mbuluara dhe anën e Alltarit duke thënë : « Do t' të dua, ô Zot, fuqia ime ; Zoti është mpshetja ime, përikja ime dhe shpëtimtari im » (tri herë). Pastaj e ngre Erën përmi Dhuratat e shënta dhe e tunt përsipër. Kur arrin në Nyjën VI « dhe u-ngjit nër qiejtë... » të Symbolit të Besës, e palos dhe e vë më nj' anë.

POPULLI :

Besoj më një Perëndî, Atin e tërëfuqishim, krijetarin e qiellit e të dheut, dhe të gjithë të dukurave e të padukurave.

E në një Zot Jesu Krisht, të vetëmin Bir të Perëndisë që lindi prej Atit para gjithë jetëve. Dritë prej Drite, Perëndî e vërtetë prej Perëndie të vërtetë, që lindi e nuk u-bë, të bashkëqënurshme me Atin, me anën e të cilit u-bënë të gjitha. Që për ne njerëzit dhe për shpëtimin tonë u-mishërua prej Shpirtit Shënt dhe virgjërës Marí e u-bë njerí. Që u-kryqësua për ne më kohë të Pontit Pilat dhe vojti dhe u-varrua. Dhe u-ngjall më të tretën ditë pas Shkronjave. Dhe u-ngjit më qiell e ndënji më të diathtë të Atit, dhe do të vinjë prapë më lavdí të gjykojë të gjallët e të vdekurit, Mbretëri' e të cilit do t' mos ketë mbarim.

Dhe më Shpirtin Shënt, Zotin, e Jetëdhënësin, që dërgohet prej Atit, që adhurohet e lavdërohet bashkë me Atin e me Birin, që foli me anën e Profetëve.

Më një Kishë të Shëntë, te Përgjithëshme, dhe Apostollore.

Rrëfej një Pagëzim për ndjesë të mëkateve.

Pres ngjalljen e të vdekurve dhe jetën e botës që vien. Amen.

DIAKU :

Le të qëndrojmë mirë; le të qëndrojmë me frikë; le të vëmë re për të 'blatuar 'Naforën e shëntë.

VALLEJA :

Mëshirë paqjeje, therore lavdërimi.

PRIFTI :

Hir' i Zotit tonë Jesu Krisht, dhe dashuri' e Perëndisë dhe Atit, edhe kungim' i Shpirtit Shënt qoftë me gjith' ju. Dhe e bekon popullin; Diaku erëson të shëntat me reverim.

VALLEJA :

Dhe me frymën tënde.

PRIFTI :

Le t' i ngremë lart zëmrat tona. (Ngre duart' e tij lart).

VALLEJA :

I ngremë te Zoti.

BKSH

PRIFTI :

Le t' a përhirojmë Zotin.

VALLEJA :

I ka hie dhe ësht' e drejtë t' i falemi Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, Trinisë së bashkëqënurshme dhe së pandarë.

PRIFTI fshehtazi :

Të ka hie dhe ësht e drejtë të të hymnojmë, të të bekojmë, të të lavdërojmë, të të përhirojme, të t' adhurojmë në ç' do vënt të zotërimit tënt; se ti je Perëndî e patreguar, e pakuptuar, e padukur, e pamarrë-vesh, që je gjithmonë, që je pandryshuar, ti dhe Biri yt i vetëm, dhe Shpirti yt Shënt. Tî na bëre të jemi nga e mos-qëna, dhe, kur ramë jashtë, na ngrite prapë dhe nuk pushove së bëri të gjitha, gjer sa na ngjite në qiell dhe na fale Mbretërinë tënde që vien. Për këtô të gjitha të përhirojmë ty, dhe Birin tënt të vetëm, edhe Shpirtin tënt Shënt; për gjithë sa dimë, dhe sa s' dimë, për mirëbërjet e dukura dhe të padukura që na janë bërë. Të përhirojmë dhe për këtë meshë, të cilën dignove t' a preç prej duarve tona, megjithë-që të qëndrojnë përpara mijëra Kryeëngjejsh, dhe myriade Engjëjsh, Qerubimet, dhe Serafimet, të gjashtë-krahëshme dhe të shumë-syshme, me krahë në erë lart, --

Me zë të larte :

Hymnin triumfal duke kënduar, duke thirrur, duke grishuar, e duke thënë.

VALLEJA :

I shëntë, i shëntë, i shëntë, Zoti Sabaoth ; qielli e dheu është plot prej lavdisë s'ate ; Hosanna më të lartat ; i bekuar është ay që vien më emërin e Zotit; Hosanna ti më të lartat.

PRIFTI, a Diaku, këtû merr Yllthin prej Diskut dhe si bën shënjën e kryqit mi të, e vë mi Mbulesat.

PRIFTI fshehtazi :

Bashkë me këtô Fuqira të lumura dhe ne, ô Zot njerzidashës, thërresim e thomi : I shëntë dhe i tërëshëntë je Ti, dhe Biri yt i vetëm dhe Shpirti yt Shënt. I shëntë dhe i tërëshentë je, dhe lavdia jote është madhështore, që e deshe botën tënde aqë, sa të apësh Birin tënt të vetëm, që cilido që beson më të të mos humbasë, po të ketë jetë t' ameshuar ; i cili, si erdhi, dhe mbaroj tërë urdhërimin për ne, natën që përipej, ose më mire përipte veten e tij për jetën e botës, si mori bukë nër duart e tij të shënta, të pacinuara dhe të kulluara, i ërhiroj e bekoj, shëntëroj dhe e theu, u dha Nxënësve dhe Apostujve të tij të shëntë, duke thënë :

Me zë të lartë :

Merrni, hani ; ky është Trupi im, që thyhet për juve, për ndiesë të mëkateve.

VALLEJA :

Amen.

PRIFTI fshehtazi :

Gjith' ashtu dhe Qelqin pas darkës, duke thënë ;

Me zë t la rte :

Pini prej këtî të gjithë ; ky është Gjaku im i Testamentit të ri, që derdhet për juve dhe për shumë, per ndiesë të mëkateve.

VALLEJA :

Amen.

PRIFTI fshehtazi :

Duke kujtuar pra këtë porosî shpëtimtare dhe tër' atô që u-bënë për ne, Kryqin, Varrin, Ngjalljen e triditëshme, Ngjitjen nër qiejtë, Ndënjjen më të diathtë, ardhjen përsëri të dytë dhe të lavdëruar, —

Këtû PRIFTI a Diaku kryqëson duart e tij, duke vënë të diathtën mi të mëngjërën, dhe merr me të diathtën Diskun e shëntë, dhe me të mëngjëren Qelqin e shëntë, i tunt kryqthi me vërejtje të madhe, duke thënë me zë të lartë :

Të tuat nga të tuat ty të 'blatojmë për të mirën e të gjithave dhe për të gjitha.

VALLEJA :

Të hymnojmë, të bekojme, ty të përhirojmë, ô Zot, dhe të lutemi, Perëndia jonë.

Pastaj PRIFTI dhe DIAKU falen tri herë përpara Alltarit të shëntë, duke u-lutur më vete e duke thënë :

O Perëndî, fal-më mua mëkatarë dhe mëshirô-më.

Pastaj DIAKU, duke unjur kryet dhe duke dëftyer me Orarë Bukën e shëntë thotë fshehtazi :

Bekô, ô Zot, Bukën e shëntë.

PRIFTI ngrihet, shënon Bukën e shëntë dhe thotë fshehtazi :

Dhe bëj-e këtë Bukë, Trupin e çëmuar të Krishtit tënt

DIAKU :

Amen. Dhe përsërî, duke rrëfyer me Orarë Qelqin e shëntë, thotë :

Bekô, ô Zot, Qelqin e shëntë.

Dhe PRIFTI, si e bekon, thotë :

Dhe atë që është në këtë Qelq, Gjakun e çëmuar të Krishtit tënt, —

DIAKU :

Amen.

Dhe përsërî DIAKU, duke rrëfyer me Orarë që të dyja të shëntat, thotë :

Bekô, ô Zot, që të dyja bashkë.

PRIFTI, duke bekuar që të dyja, thotë :

Duke i ndryshuar me Shpirtit tënt Shënt, —

BKSH

DIAKU :

Amen. Amen. Amen.

Dhe duke i unjur kryet Priftit, i thotë : Kujtô-më, ô Zot i shëntë, mua mëkatarë. Qëndron në vëntt ku ishte më parë, dhe, si merr ventaljen, erëson të shëntat si më parë.

PRIFTI fshehtazi :

Që të bëhet për atâ që piesëtojnë si esëllî shpirti, si ndiesë mëkatash, si kungim i Shpirtit Shënt, si mbarim i Mbretërisë së qiejve, si guxim përpara teje, jo për gjykim, a për dënim. Êdhe të 'blatojmë këtë adhurim t' arësyshmë për atâ që u-prëhnë përpara me besë, Stërgjyshër, Atër, Patrikë, Profetër, Apostuj, Lëçitës, Ungjillorë, Dëshmorë, Konfesorë, Ashkëtij dhe për ç' do shpirt që u-mbarua më besë.

PRIFTI me zë të lartë :

Veçan Tërëshënten, të pacinuarën, të përmibekuarën, të lavdëruarën, Zonjën tonë Hyjlindëse, dhe gjithmon-virgjërën Marî.

VALLEJA :

Të ka hie me të vërtetë të të lumërojmë ty Hyjlindësen ; gjithmon-të-lumurën dhe të përmikullуarën dhe Mëmën e Perëndisë s' onë ; më të nderçimen nga Qerubimet dhe më të lavdëruarën pa përqasje nga Serafimet ; që pa u-cinuar linde Fialë-Perëndinë, me të vërtetë Hyjlindësen ty të madhështojmë.

Ose në vënt të kësaj këndohet kënga e IX-të e Zbritësoreve, në qoftë nonjë e krëmte e madhe. Dhe në qoftë se bëhet Mesh' e Shën-Basilit, thohet kiô :

Më ty gëzohet, ô Hirëplote, tërë kriesa, system' i Engjëjve, gjindja e njerësve, ô Tempull i shëntëruar, Parrajs' e arësyshme, mburrje virgjërore, prej së cilës u-mishërua Perëndia dhe u-bë dialë Perëndia jonë që qe para jetëve ; se mëmën tënde e bëri fron dhe gjinë tënt e bëri më të gjerë se qiejtë. Më ty gëzohet, ô Hirëplote, tërë kriesa ; lavdî më ty.

Diaku temianis Alltar' e shëntë përqark, dhe përkujton Diptyket e të gjallëve dhe të vdekurve që të dojë.

PRIFTI fshehtazi :

Shën Joan, Profet, Parërendës, dhe Pagëzor ; Apostujët e shëntë, të lavdëruar dhe emër-shkëlqyer, shënt (aksh të ditës), të cilin po përkujtojmë sot, dhe gjithë Shëntorët e tû, me lutjet e të cilëve vështrô-na, ô Perëndî. Dhe kujtô gjithë të fieturit me shpresë ngjalljeje për jetë t' ameshuar. Dhe kujton atâ që dô). Dhe prëh-i, ô Perëndia jonë, atje ku përmiqyr drit' e faqes s' ate. — Edhe të lutemi : Kujtô, ô Zot, ç' do Peshkopî Orthodoxësh, që presin drejtërisht fialën e së vërtetës s' ate, gjithë Presbyterinë, Diakonatën më Krisht dhe ç' do Urdhër Priftëror dhe Kllogjëror. — Edhe të 'blatojmë këtë adhurim t' arësyshmë për Kishën e Shëntë, të Përgjithëshme, dhe Apostollore, për atâ që shkojnë jetën e tyre më

kullim e nder, për Mbretërit tanë besnikë dhe Krisht-dashës, për tërë Pëllasnë dhe Ushtërin' e tyre. Ep-u, ô Zot, mbretërî të paqëshme, që të mundim dhe ne në qetësî të tyre të shkojmë jetë të paqëshme dhe të qetë me besë të mirë e me nder.

PRIFTI me zë të lartë :

Më parë kujtô, ô Zot, Kryepeshkopin tonë (aksh), të cilin falj-a'u Kishëravë tënde të shënta, më paqje, shigurî, nder, shëndet, dhe ditë të gjata që të presë drejtërisht fialën e së vërtetës s' ate.

VALLEJA :

Dhe të gjithë e të gjitha.

DIAKU :

Dhe atô që ka cilido nër mënt, e të gjithëve e të gjithave.

VALLEJA :

Amen.

PRIFTI fshehtazi :

Kujtô, ô Zot, qytetin, më të cilin rrojmë, dhe ç'do qytet e vënt, dhe atâ që rrinë nër tô me besë. Kujtô, ô Zot, atâ që lundrëzojnë, që udhëtojnë, të sëmurët, të munduarit, robërit dhe shëllbimin e tyre. Kujtô, ô Zot, atâ që siellin pemë e vepra të mira nër Kishërat e tua të shënta, dhe kujtohen për të varfërit dhe dërgô mi gjithë ne mëshirat e tua.

PRIFTI me zë të lartë :

Dhe ep-na që me një gojë dhe me një zëmër të lavdërojmë e të përhymnojmë emërin tënt të nderçim e madhështor, të Atit, e të Birit, e të Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

VALLEJA :

Amen.

PRIFTI kthehet te populli dhe, si e bekon, thotë :

Dhe do të jenë mëshirat e Perëndisë së Madhe, dhe të Shpëtimtarit tonë Jesu Krisht, bashkë me gjith' ju.

DIAKU del nga Tribuna dhe, si qëndron më vëndin e zakonëshm, thotë :

.Të gjithë Shëntorët duke kujtuar, përsërî dhe përsërî më paqje le t' i lutemi Zotit.

VALLEJA :

Mëshirô, ô Zot.

Për Dhuratat e çëmuara, të 'blatuara e të shëntëruara le t' i lutemi Zotit.

Që Perëndia jonë njerzidashëse, që i akseptoj n' Alltar të tij të shëntë, të përmiqiellshim, e mëndor, si erë fragrance shpirtore, të na dërgojë si çpërblim hirin e perëndishmë, dhe dhuratën e Shpirtit Shënt le t' i lutemi Zotit.

Që të shpëtohemi prej ç' dô hidhërimi, mërie, reziku, dhe nevoje, le t' i lutemi Zotit.

PRIFTI fshehtazi :

Te ty konsignojmë tërë jetën tonë dhe shpresën, ô Zot njerzidashës, e të lutemi e të falemi. Vlerësô-na të piesëtojme nga Mysteret tënde qiellore dhe të trëmpshime të kesaj Tryese të shëntë dhe shpirtore, me ndërgjegjje të paqme, për ndiesë mëkatash, për falje fajesh, për kungim Shpirti Shënt, për trashë-gim Mbretërie qiejsh, për guxim përpara teje, jo për gjykim a për dënim.

DIAKU :

Përkrah-na, shpëtô-na, mëshirô-na, dhe ruaj-na, ô Perëndî, me hirin tënt.

Ditën të tërë, të mbarë, të shëntë, të paqëshme dhe të pamëkatëshme, le t' i lypim Zotit.

VALLEJA :

Fal-na, ô Zot.
Engjëll paqjeje... (Shëkô më sipër.)
Ndiesë dhe falje ..
Të mirat e të dobishmet...
Që të shkojmë kohën...
Mbarim të Krishterë...

Bashkimin e fesë dhe kungimin e Shpirtit Shënt duke lypur, veten tonë dhe njerjatërin, dhe gjithë jetën tonë Krishtit Perëndisë le t' i a pranojmë.

VALLEJA :

Ty, ô Zot.

PRIFTI me zë të lartë :

Dhe vlerësô-na, ô Zot i Math, që të guxojmë të përthërresim ty Perëndinë qiellore si Atë faqeza e pa dënim, e të thomi :

POPULLI :

Ati ynë që je ndë qiell, u-shëntëroftë emëri yt ; arthtë Mbretëria jotë ; u-bëftë dëshira jote si ndë qiell edhe mbi dhê ; bukën tonë të përditëshme epna-e neve sot ; edhe fal-na-i fajet, si kundër edhe ne u a falim fajtorëve tanë ; dhe mos na shtjer ndë ngasje po shpëtô-na nga i ligu.

PRIFTI :

Se jotja është Mbretëria, edhe fuqia, edhe lavdia, e Atit, e Birit, dhe e Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

VALLEJA :

Amen.

PRIFTI :

Paqje mi ju të gjithë.

VALLEJA :

Dhe me frymën tënde.

DIAKU :

Krerët tona le t' i-a unjim Zotit.

VALLEJA :

Ty, ô Zot.

PRIFTI fshehtazi :

Të përhirojmë, ô Mbret i padukur, që kriove të gjitha me fuqinë tënde te panëmëruar dhe i bëre të gjitha të jenë nga e mos- qëna nga shumic' e mëshirës s' ate. Ti, ô Zot, hith synë prej qiejve mi atâ që të kanë unjur krerët e tyre ; se nuk i u-unjne as mishi as gjaku, po ty Perëndisë së trëmpshime. Ti pra, ô Zot, të parëvënat ndreq-i më të mirë për të gjithë ne, pas nevojës së veçantë të cilitdo ; lundrëzô bashkë me lundrëzonjësit ; udhëtô bashkë me udhëtonjësit ; shërô-i të sëmurët, ô mieku i shpirteve dhe i trupeve tona.

PRIFTI me zë të lartë :

Me hirin, dhe përdëllimet, dhe njerzidashjen e të vetëmit t' yt-Bir, me të cilin je i bekuar, bashkë me tëreshëntin, të mirin, dhe jetëdhënësin Shpirtin tënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

VALLEJA :

Amen.

PRIFTI fshehtazi :

Vër-re, ô Zot Jesu Krisht Perëndia jonë, prej ndënjjes s' ate së shëntë, dhe prej fronit të lavdë-

ruar të Mbretërisë s' atë, dhe eja të na shëntërosh, ti që rri lart bashkë me Atin, dhe ndodhesh këtu bashkë me ne padukurisht; dhe vlerësô të na kungosh me dorën tënde të pushtetëshme, me Trupin tënt të kulluar, dhe me Gjakun e çëmuar, dhe me anën tonë tërë Popullin.

DIAKU thërret: Le të vëmë re.

PRIFTI, duke ngritur Bukën e shëntë, thërret:

Të Shëntat të shëntëve.

VALLEJA:

Një ësht i Shëntë, një është Zot, Jesu Krishti për lavdî të Perëndisë Atit. Amen.

Pastaj këndon Kungatoren:

Lavdërojeni Zotin prej qiejve, lavdërojeni më të lartat. Alleluia. Alleluia. Alleluia.

Ose në qoftë nonjë e krëmte, këndohet kungatorja e saj e veçantë në vënt të kësaj.

Pastaj DIAKU hyn në Shëntëroren, dhe, duke qëndruar më të diathtë të Priftit, thotë:

Copëtô, ô Zot, Bukën e shëntë.

PRIFTI e copëton më katër piesa me vërejtje dhe reverim e thotë:

Copëtohet e piesëtohet Qëngj' i Perëndisë, i cili copëtohet, po nukë ndahet, i cili hahet gjithënjë, po kurrë nukë soset, po shëntëron atâ që e hanë.

Dhe i regullon të katër piesat kryqthi mi Diskun e shëntë kështû :

JS
MU NT
KS

dhe merr piesën që ka J S, bën kryq mi Qelqin e shëntë, duke thënë DIAKU :

Mbush, ô Zot, Qelqin e shëntë.

Dhe heth piesën brënda te Qelqi, duke thënë :

Mbushja e Qelqit, e besës së Shpirtit Shënt.

DIAKU :

Bekô, ô Zot, ujën e nxehtë.

PRIFTI, duke bekuar, thotë :

E bekuar është nxehtësi' e Shëntorëve tënt, përgjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

DIAKU, duke derdhur mi Qelqin e shëntë kryqthi, thotë :

Nxehtësî bese, plot me Shpirt Shënt. Amen.

Pastaj PRIFTI a DIAKU këndon këtô Urime përpara kungatës :

Përpara dyerve të Tempullit tënt qëndroj, dhe nga mejtimet e frikëshme nuk largohem ; po ti, ô Krisht Perëndî, që drejtësove kumerqarë, dhe mëshirove Kananejkën, dhe i çele kusarit dyert' e Parajsës, çel-m' a zëmërën e njerzidashjes s' ate, dhe prit-më që të vinj pranë e të pshtetem, si kurvën

dhe Gjakriedhurën ; se kiô duke prekur anën e robës s' ate, udobisht mori shërimin, dhe ajô, duke mbajtur këmbët e tua të kulluara, mori zgjidhjen e mëkatave. Po unë i ngrati, që guxoj të pres tërë Trupin tënt, të mos digjem, po prit-më, si atô, dhe ndriçô-m' i ndjenjësoret e shpirtit, duke diegur krimërat e mia të mëkatës ; me nërmjetimet e asaj që të lindi pa farë dhe të fuqive qiellore ; se je i bekuar më jetët e jetëve. Amen.

Besoj, ô Zot, dhe rrëfej, se ti je me të vërtetë Krishti, i Bir' i Perëndisë së gjallë, që erdhe në botë për të shpëtuar mëkatarët, nga të cilët i pari jam unë. Edhe besoj se ky është vetë Trupi yt i kulluar, dhe ky është vetë Gjaku yt i çëmuar. Të lutem pra : Mëshirô-më, dhe ndje-m' i fajet, të dashura dhe të padashura, me fialë, me punë, me dijë dhe padijë, dhe vlerësô-më të piesëtoj pa dënim Mysteret e tua të kulluara, për ndjesë mëkatash, dhe për jetë t' ameshuar. Amen.

Pastaj këtë Tropar :

Në darkën tënde mystike, ô i Bir' i Perëndisë, merr-më sot piesëtar ; se nuk do t' u thom armiqve mysterin, as që do t' të ap puthje, si Juda ; po si kusari të rrëfej : Kujtô-më, ô Zot, kur të vish në Mbretërî tënde.

Pastaj këtô Tropare :

Më ngazëllove me mall, ô Krisht, dhe më ndry-

shove me dashurinë tënde të perëndishme; po digj-i mëkatat e mia me ziarr të palëndëshm dhe vlerësô-më të rrafshohem me gezimin te ty, që të madhështoj, duke kërcyer, ardhjet e tua të dyja, ô i Mirë.

Nër shkëlqimet e Shëntorëve tënt si do të hyj unë i pavyeri? se, në guxofsha të hyj bashkë në nusëroren, këmisha më tregon, se s' ësht e dasmës, dhe i lidhur do të nxirem jashtë prej Engjëjve. Spastrô, ô Zot, ndyrësin' e shpirtit t' im dhe shpëtô-më si njerzidashës.

Pastaj këtë Urim:

O Zot, njerzidashës, Zoti Jesu Krisht, Perëndia ime, të mos më bëhen për gjykim këtô të Shënta, nga që jam i pavyer, po për paqësim dhe shëntërim shpirti dhe trupi, dhe për vlesim të jetës dhe Mbretërisë për-të-ardhur. Esht e mirë për mua t' i ngjitem Zotit, dhe të vë te Zoti shpresën e shpëtimit t' im.

Dhe përsërî:

Në darkën tënde mystike....

Pastaj Prifti dhe Diaku ngrihen, ngrenë duartë përpara Tryesës së shëntë, duke u-lutur fshehtazi. Pastaj PRIFTI, duke vajtur të kungojë i thotë Diakut, a bashkëmeshetarit:

O vëllâ dhe bashkëmeshëtar ndje-më mua prifrin e pavyer.

Dhe si merr ndjesë thotë tri herë:

O Perëndî, fal-më mua mëkatarë dhe mëshirô-më.

Dhe si u afërohet të Shëntave me frikë, merr një piese prej Bukës dhe thotë :

Ja ku vij pranë Krishtit, Mbretit të pavdekur dhe Perëndisë s' onë.

Me Trupin e çëmuar dhe tëreshëntë të Zotit, dhe Perëndisë, dhe Shpëtimtarit tonë Jesu Krisht, kungohem unë (aksh), prifti i pavyer, për ndjesë të mëkateve të mia dhe për jetë t' ameshuar.

Dhe si kungohet thotë : Amen. Pastaj i thotë Diakut :

Diak, eja pranë.

DIAKU afërohet e thotë :

Kungô-më, ô Zot, me Trupin e çëmuar dhe tërëshëntë të Zotit, dhe Perëndisë, dhe Shpëtimtarit tonë Jesu Krisht, mua diakun e pavyer (aksh), për ndiesë të mëkatëve të mia dhe për jetë t' ameshuar.

PRIFTI i ep një piesë prej Bukës, duke thënë :

Kungohesh ti (aksh) Diak me Trupin e çëmuar...

Gjith' ashtû bëjnë dhe me kungimin e Gjakut të çëmuar.

PRIFTI, si përtryp Bukën, merr mbulesën, dhe e vë nënë miekër, zë me dorën e diathtë Qelqin e shëntë bashkë me mbulesën dhe thotë :

Edhe vij pranë Krishtit, Mbretit të pavdekur dhe Perëndisë s'onë.

Me Gjakun e çëmuar, të shëntë, të kulluar, dhe jetëdhënës të Zotit, dhe Perëndisë, dhe Shpëtimtarit

tonë Jesu Krisht, kungohem unë (aksh), prifti i pavyer, për ndiesë të mëkatëve të mia dhe për jetë t' ameshuar.

Pastaj thotë :

Më emërin e Atit, amen, (pi një), dhe të Birit, amen, (dy), dhe të Shpirtit Shënt, amen, (tri) ; tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Pastaj fshin Qelqin e shëntë dhe buzët e tij, e puth, duke thënë :

Kiô preku buzët e mia, dhe do t' më heqë tërë paudhësitë, e do t' m'i qërojë tërë mëkatat.

Pastaj merr Diskun e shëntë me Sfyngjerë me dorën e mëngjër, dhe me dy gjishtërijt'e dorës së diathtë vë brënda në Qelq më parë piesat e Trupit të shëntë dhe thotë këtô :

Me-qënë-që pamë Ngjalljen e Krishtit... (Shëkô në Mëngjest).

Ndriçoh-u, ndriçoh-u, ô Jerusalem i ri ; se lavdia e Zotit lindi përmi ty. Loj valle tanî, dhe ngazëllohu, ô Sion ; dhe Ti, ô Hyjlindëse e Kulluar, dëfrê më ngjalljen e t' yt-Biri.

O zëri yt i hyjëshm ! i dashur ! edhe fort i ëmbël ! se me të vërtetë u-zotove të jesh bashkë me ne gjer në mbarim të jetës, ô Krisht ; dhe këtë aukure shpëtimi duke patur ne besnikët, ngazëllohemi.

O Pashka e madhe dhe fort hierore, ô Krisht ; ô urtësî dhe Fialë dhe fuqî e Perëndisë ; ep-na të piesëtojmë prej teje më sheshit, te dita e paperënduar e Mbretërisë s' ate.

Nër piesat e shpirteve thotë :

Shpërlaj-i, ô Zot, mëkatat e shërbëtorëve tënt që u-përkujtuan këtû me Gjakun tënt të shëntë ; me nërmjetimet e Hyjlindëses dhe të gjithë Shëntorëve tënt.

Dhe si e fshin mirë Diskun e shëntë, shkunt dhe mbulesën mirë në Qelq të shëntë, e mbulon me të dhe këndon këtë Urim të fshehtë.

PRIFTI :

Të përhirojmë, ô Zot njerzidashës, mirëbërës i shpirteve tona, se dhe më ditën e sotme na vlerësove per Mysteret e tua qiellore dhe të pavdekura. Pre-na-e drejt udhën, pshet-na ne të gjithë me frikën tënde, rua-na-e jetën, shigurô-na-i përçapët, me uratat dhe lutjet e Hyjlindëses së lavdëruar dhe gjithmon-virgjërës Marî dhe të gjithë Shëntorëve tënt.

Pastaj i bie Diskut kryqthi me Yllthin që të mbarojë Psalti Kungatoren; DIAKU hap Derën e Bukur, merr prej Priftit Qelqin e shëntë dhe del jashtë duke shëkuar popullin e duke thënë :

Me frikë Perëndie, besë dhe dashurî afërohuni.

Pastaj PRIFTI bekon, duke thënë :

O Perëndî, shpëtô popullin tënt, dhe bekô trashëgimin tënt.

VALLEJA :

Pamë Dritën e vërtetë, muarmë frymë qiellore ;

gjetmë Besën e vërtetë, duke i u-falur Trinisë së pandarë ; se ajô na shpëtoj.

Pastaj e vë Qelqin e shëntë m' Alltar, dhe si e temianis tri herë thotë fshehtazi :

Ngjit-u mi qiejte, ô Perëndî, dhe lavdia jote mi tërë dhenë. (Tri herë).

Diaku merr prej Priftit Diskun e shëntë me të tierat dhe shkon në Parëvënje dhe i vëndos atje. PRIFTI merr Qelqin e shëntë, duke thënë fshehtazi :

E bekuar është Perëndia jonë, —

Dhe duke shëkuar popullin thërret :

Për gjithmonë, tanî e përherë e në jetë të jetëve.

VALLEJA :

Amen.

Dhe shkon në Parëvënje te shëntë, lë Qelqin e shëntë, kthehet n' Alltar, palos Antimensin, dhe DIAKU thotë me zë të lartë përpara korës së Jesu Krishtit :

O të drejte ! passi kunguam Mysteret e hyjëshme, të shënta, të kulluara, të pavdekura, qiellore, jetëbërëse dhe të trëmpshime të Krishtit, siç i ka hie, le t'a përhirojmë Zotin.

VALLEJA :

Mëshirô, ô Zot.

Përkrah-na, shpëtô-na, mëshirô-na, dhe ruaj-na, ô Perëndî, me hirin tënt.

Ditën të tërë të mbarë, të shëntë, të paqëshme dhe të mëkatëshme duke lypur, veten tonë dhe njërjatërin dhe tërë jetën tonë Krishtit Perëndisë le t' i a pranojmë.

VALLEJA :

Ty, ô Zot.

PRIFTI me zë të lartë :

Se tij e shëntërimi ynë, dhe ty të dërgojmë lavdî, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

VALLEJA :

Amen.

Pastaj merr Ungjillin e shëntë dhe bën kryq përmi Antimensin dhe e lë. Pastaj, duke shëkuar popullin, thotë :

Më paqje le të shkojmë.

DIAKU :

Le t' i lutemi Zotit.

VALLEJA :

Mëshirô, ô Zot. (Tri herë). Bekô, ô Zot i shëntë.

PRIFTI ligjëron me zë të math këtë Urim prapa Ambonit jashtë Tribunës përpara Korës së Jesu Krishtit:

O Zot, që bekon atâ që të bekojnë, dhe shëntëron atâ që kanë besim më ty, shpëtô popullin tënt dhe bekô trashëgimin tënt ; rrafshërin' e Kishës s' ate ruaj-e, shëntërô atâ që dëshërojnë mirhiesin' e

Shtëpisë s' ate. Ti lavdëroj-i për çpërblim me fuqinë tënde të perëndishme dhe mos na lër ne që shpresojmë mi ty. Fal-i paqjen botës s' ate, kishërave të tua, Priftërve, Mbretërve tanë (ose Presidentit, a Perandorit, a Princit), Ushtërisë, dhe gjithë Popullit tënt. Se ç' do dhënje e mirë, dhe ç' do dhuratë e mbarë zbret prej teje, Atit të dritërave ; dhe ty të dërgojmë lavdî, përhirim, dhe adhurim, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

VALLEJA :

Emër' i Zotit qoft' i bekuar që tanî e gjer më jetë. (Tri herë).

Pastaj PRIFTI hyn në Parëvënje të shëntë dhe këndon fshehtazi këtë Urim :

O Krisht, Perëndia jonë, që je vetë mbushja e Ligjës dhe e Profetëve, që mbushe gjithë urdhërimin Atëror, mbush-i dhe zëmërat tona me gas e ngazëllim, për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

DIAKU :

Le t' i lutemi Zotit.

VALLEJA :

Mëshirô, ô Zot.

PRIFTI del dhe bekon popullin, duke thënë :

Bekimi dhe mëshir' e Zotit arthtë mi ju me hirin

e tij të perëndishmë dhe njerzidashjen, për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

Lavdí ty, ô Krisht Perëndí, shpresa jonë, lavdí më ty.

POPULLI :

Lavdî. Tanî. Mëshirô, ô Zot. (Tri herë). Bekô, ô Zot i Shëntë.

PRIFTI bën Përlëshim; në qoftë e Dielë thotë :

Ay që u-ngjall prej së vdekurësh, — Në mos : Krishti, Perëndia jonë e vërtetë, me nërmjetimet e Zonjës s' onë së Kulluar, Hyjlindëses dhe gjithmon-virgjërës Marî ; me fuqin' e të çëmuarit dhe Jetëdhënësit kryq ; me mprojtjen e Fuqive qiellore të nderçime pa-trup ; të nderçimit e të lavdëruarit Profet, Parërendës, dhe Pagëzor Joan ; t' Apostujve të lavdëruar dhe emër-shkëlqyer ; t' Atërve tanë nërmjet Shëntorët, Mësonjësve Ekumenikë dhe Kryepriftërve, Basilit të Math, Gregorit Theolog, dhe Joan Gojartit, Athanas e Qyrill, Joan Eleimonit, Patrikëve të Alexandrisë, Shën Kollit te Myrave dhe Spyridonit, peshkop të Trimythuntës, çudibërësit ; të Dëshmorëve te Mëdhej të shëntë e të shkëlqyer Gjergj Trope-prurësit, Mitër Myrobletit, Theodorëve të Tyronit dhe Stratelatit ; të hierodëshmorëve te shëntë e të lavdëruar Haralamp dhe Lefter ; të Dëshmorëve të shëntë, të lavdëruar dhe bukurmundës ; t'Atit tonë nërmiet Shëntorët Joan Gojartit, kryepeshkop të Konstantinopojës ; të shënt

(të kishës) ; t' Atërve tanë Oshënarë dhe Hyjprurës ; të Hyjprindërve të shënte e të drejtë Joaqim dhe Annë ; të shënt (te ditës), të cilin po lusim sot ; dhe të gjithë Shëntorëve tënt ; na mëshiroftë e na shpëtoftë si Perëndî e Mirë, Njerzidashëse dhe Mëshirëplote.

Me uratat e Shënt Atërve tanë, Zoti Jesu Krisht Perëndî, mëshirô-na e shpëtô-na. Amen.

VALLEJA :

Amen.

Pas Përlëshimit të math dhe kur ndan 'Naforën thotë PRIFTI më cilindo :

Bekimi dhe mëshir' e Zotit arthtë mi ju.

Passi mbarohet ndajtja e Naforës, thotë :

Me hirin e tij të hyjëshm dhe njerzidashjen, për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Pastaj kthehet në Parëvënjen e shëntë Prifti (a Diaku, në ka) për të mbaruar të shëntat, dhe, si mbaron, thotë Përhirimin e Kungatës.

BKSH

PAGËZIMI.

URIME MI GRUAN LEHONË.

Më ditën e parë që lint foshnjën.

Le t' i lutemi Zotit.

O Zot i Tërëfuqishmë, që shëron ç'do sëmundje dhe ç'do dobësî, Ti shërô dhe këtë shërbëtoren tënde (aksh) që lindi sot, dhe ngrer-e prej shtratit ku është shtrirë ; se, pas fialës së Profetit David, u-zumë në paudhësî, dhe me ndyrësî jemi të gjithë përpara teje. Ruaj-e këtë, dhe këtë foshnjë që lindi ; mbuloj-e nënë hien e krahëve të tû, që-sot e gjer më ditën e funtme të mbarimit të saj ; me nërmje-timet e Hyjlindëses së kulluar dhe të gjithë Shëntorëve ; se je i bekuar më jetët të jetëve.

URIM

Më të emëruar foshnjën tetë ditë passi lint. Duhet ditur që tetë ditë pas lindjes foshnja sillet në kishë prej mamisë dhe qëndron përpara dyerve të kishes. PRIFTI bekon : Shënt Perëndi.... Trinî e tërëshëntë.... Ati ynë... Se jotja është... Pastaj Përlëshorja e ditës, ose e Shëntit të Kishës; dhe shënon ballën, gojën, dhe krahërorin e foshnjës, duke thënë këtë Urim :

Le t'i lutemi Zotit.

O Zot, Perëndia jonë, ty të falemi, e ty të lutemi. Le të shënohet drit' e faqes s'ate mi shërbëtorin

tënt (aksh), dhe le të shënohet Kryqi i të vetëmit t'yt-Bir në zëmër e në mejtimet e tij, që të ikëj nga kotësi' e botës, dhe nga ç'do keq-dashje dinake t' armikut, e të vejë pas urdhërimeve të tua; dhe ep, ô Zot, që të mbetet mi të Emëri yt i shëntë i paçkolitur kur të bashkohet me Kishën tënde të shëntë më kohën e përtëshme dhe të mbarohet me Mysteret e trëmpshime të Krishtit tënt; që, duke u-siellë pas porosîve të tua dhe duke ruajtur shilën të pathyer, të trashëgojë lumërin'e të zgjedhurve në mbretërî tënde. Me hirin dhe njerzidashjen e të vetëmit t'yt-Bir, me të cilin je i bekuar, bashkë me tërëshëntin, të mirin dhe jetëdhënësin Shpirtin tënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Pastaj merr foshnjën më krahë, qëndron përpara dyerve të Kishës a përpara korës së Shën Marisë dhe bën shënjën e Kryqit, duke thënë :

Gëzoh-u, ô hirëplote Virgjërë Hyjlindëse ; se prej teje lindi Diell' i Drejtërisë, Krishti Perëndia jonë, që ndriçon atâ që ndodhen n'er rësirë. Gëzoh-u dhe ti, ô plak njerî i drejtë, që prite nër krahët e tû Çpërblenjësin e shpirteve tona, që na ep ngjalljen.

Përlëshim.

URIME MË KATEKUMENË.

Prifti zgjesh brezin e atî që është për t'u-ndriçuar, e çvesh dhe e zbath; dhe e qëndron nga Lindja me këmishën vetëm, pa bres, karos, e të zbathur, me duartë të lëshuara; dhe i fryn më

faqe tri herë dhe i kryqëzon ballën dhe krahërorin tri herë, dhe i vë dorën mi kokë, duke thënë :

URIM.

Më emërin tënt, ô Zot, Perëndî e së vërtetës, dhe të Birit tënt të vetëm, dhe të Shpirtit tënt Shënt, vë dorën t'ime mi shërbëtorin tënt (aksh), i cili u-vlerësua të përikë te Emëri yt i shëntë dhe të ruhet nënë hien e krahëve të tû. Largô prej tij atë rrejtjen e motshime, dhe rrafshoj-e me besën, dhe shpresën, dhe dashurinë te ty ; që të mësojë se ti je vetëm Perëndî e vërtetë, dhe Biri yt i vetëm, Zoti ynë Jesu Krisht, dhe Shpirti yt Shënt. Ep-i të baresë më gjithë urdhërimet e tua dhe të ruaj atô që të pëlqejnë ; se, po t' i bëjë atô njeriu, do të rrojë nër tô. Shkruaj-e te libr' e jetës s'ate, dhe bashkoj-e me grigjën e trashëgimit tënt; le të lavdërohet Emëri yt i shëntë mi të dhe i Birit tënt të dashur, Zotit tonë Jesu Krisht, dhe i Shpirtit tënt jetëdhënës. Le t'a vështrojnë syt' e tû gjithmonë me mëshirë, e vër-i'a veshin zërit të lutjes së tij. Ngazëlloj-e me veprat e duarve të tij, dhe me gjithë gjindjen e tij, që të të rrëfejë e të të këndojë për gjithmonë tërë ditt' e jetës së tij, duke adhuruar e duke lavdëruar Emërin tënt të math e të lartë. Se ty të hymnojnë gjithë Fuqit' e qiejve, dhe jotja është lavdia, e Atit, dhe e Birit, dhe e Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen:

Pastaj këndon të tre Exorqismet. Pas atyre :

Le t' i lutemi Zotit.

O Zot i Math, që je me të vërtetë, që bëre njerinë pas korës dhe shëmbellsisë s'ate, dhe i dhê fuqî për jetë t'ameshuar, që nuk e çvështrove, kur ra jashtë nga mëkata, po pregatite shpëtimin e botës duke bërë njerî Krishtin tënt; Ti, prit në Mbretërî tënde qiellore dhe këtë kriatyrë, duke e shpëtuar prej robërisë s' armikut. Çel-i'a syt' e mëndjes, që të shkëlqejë nër tâ ndriçim' i Ungjillit tënt. Mbre në jetë të tij një Engjëll të ndritshim, që t'a shpëtojë prej ç'do keq-dashjeje të kundrështarit, prej hasjes së ligë, prej demoni të mesdistëshm, prej sprihërash të këqia.

PRIFTI i fryn në gojë, në ballë, e në krahëror duke thënë:

Dbô prej tij ç'do shpirt të lik e të përlyrur, të fshehur e të mfolesuar në zëmër të tij. (Tri herë).

Shpirt rrejtjeje, shpirt ligësie, shpirt idolatrie dhe ç' do lakmimi; shpirt gënjeshtre dhe ç' do ndyrësie, që vepërohet pas mësimit të Diallit. Dhe bëj-e dele t' arësyshme të grigjës s' ate së shëntë të Krishtit tënt, anëtar të nderçim të kishës s' ate, bir dhe trashëgimtar të Mbretërisë s' ate, që, duke shkuar pas urdhërimeve të tua dhe, duke ruajtur shilën të pathyer dhe këmishën të pacinuar, të vlerësohet për lumërin' e Shëntorëve në Mbretërî tënde.

PRIFTI me zë të lartë:

Me hirin, përdëllimet dhe njerzidashjen e të vetë-

mit t' yt-Bir, me të cilin je i bekuar, bashkë me • tërëshëntin, të mirin dhe jetëdhënësin Shpirtin tënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

PRIFTI e kthen atë që është për të pagëzuar nga Perëndimi me duartë përpietë dhe i thothë tri herë :

E mohon Satanë, dhe gjithë veprat e tij, dhe gjith' Engjëjt' e tij, dhe gjith' adhurimin e tij, dhe gjithë pompën e tij ?

KATEKUMENI, ose NUNI i tij, në qoftë foshnjë, përgjigjet ç' do herë e thotë :

E mohoj.

Dhe si t' a thotë tri herë, PRIFTI e pyet përsërî :

E mohove Satanë ?

KATEKUMENI, a NUNI përgjigjet :

E mohova. Si t' a thotë tri herë, thotë PRIFTI :

Fry dhe pështyj-e. Dhe, passi bën kështû, PRIFTI e kthen nga Lindja me duartë tatëpjetë, dhe i thotë tri herë :

Bashkohesh me Krishtin ?

KATEKUMENI a NUNI përgjigjet, duke thënë :

Bashkohem (për-së-treti). Pastaj i thotë PRIFTI

U-bashkove me Krishtin ? Përgjigjet :

U-bashkova. Dhe përsërî i thotë :

Dhe e beson ? Përgjigjet :

E besoj si Mbret dhe Perëndî. Pastaj thotë :

Besoj më një Perëndí... Dhe si të mbarojë Symbolin e shëntë, i thotë prapë për-së-treti :

U-bashkove me Krishtin ? Përgjigjet :

U-bashkova.

PRIFTI thotë :

Dhe fal-i' u.

Dhe i falet, duke thënë :

I falem Atit, Birit, edhe Shpirtit Shënt, Trinisë së bashkëqënurshme dhe së pandarë.

PRIFTI me zë të lartë :

E bekuar është Perëndia, që dô të shpëtohen gjithë njerëzia, dhe të vijnë më njohjen e së vërtetës, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Le t' i lutemi Zotit.

O Zot i Math, Perëndia jonë, thirr-e shërbëtorin tënt (aksh) në ndriçim tënt të shëntë dhe vlerësôj-e për hirin e math të Pagëzimit tënt të shëntë ; çvesh-i'a vjetërsinë, dhe përsërit-e më jetën e ameshuar, dhe rrafshoj-e me fuqin' e Shpirtit tënt Shënt, në bashkim të Krishtit tënt, që të mos jetë më fëmijë trupi, po fëmij' e Mbretërisë s' ate. Me mirdashjen dhe hirin e të vetëmit t' yt-Bir, me të cilin je i bekuar, bashkë me tëreshëntin, të mirin

dhe jetëdhënësin Shpirtin tënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

SHËRBESA E PAGËZIMIT TË SHËNTË.

Prifti hyn e vishet me stolî priftërore të bardhë dhe mimëngë ; si ndizen qirijtë, merr Temianicën, vete në Font dhe temianis rreth përqark ; dhe, si e ep Temianicën, falet.

Pastaj thotë DIAKU :

Bekô, ô Zot.

PRIFTI me zë të lartë :

E bekuar është mbretëri' e Atit, e Birit, dhe e Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

VALLEJA :

Amen.

DIAKU :

Më paqje le t' i lutemi Zotit.

VALLEJA :

Mëshirô, ô Zot. (Gjith' ashtû dhe më tutje.)
Për paqjen që lartazi...
Për paqjen e tërë botës...
Për këtë Shtëpî të shëntë...
Për Kryepeshkopin tonë...
Që të shëntërohet kiô ujë me fuqinë, vepërimin,

BKSH

dhe përmindodhjen e Shpirtit Shënt, le t' i lutemi Zotit.

Që të dërgohet mi të hir' i çpërblimit, bekim' i Jordanit, le t' i lutemi Zotit.

Që të zbresë mi këtë ujë vepërimi paqësor i Trinisë së përmiqënurshme, le t' i lutemi Zotit.

Që të ndriçohemi me ndriçim kupëtimi dhe mirbesimi, me përmindodhjen e Shpirtit Shënt, le t' i lutemi Zotit.

Që të rrëfehet kio ujë mprojtare ç' do keq-dashjeje armiqsh të dukur e të padukur, le t' i lutemi Zotit.

Që të bëhet i vyer për mbretërin' e paprishur ay që do t' pagëzohet në të, le t' i lutemi Zotit.

Që të rrëfehet bir drite dhe trashëgimtar i të mirave t' ameshuara, le t' i lutemi Zotit.

Që të bëhet anëtar dhe piesëtar i vdekjes dhe i ngjalljes së Krishtit Perëndisë s' onë, le t' i lutemi Zotit.

Që t' i ruhet stoli' e Pagëzimit, dhe vlesim' i Shpirtit, i kulluar dhe i pacinuar gjer më ditën e trëmpshime të Krishtit Perëndisë s' onë, le t' i lutemi Zotit.

Që t' i bëhet kiô ujë, banjë përlindjeje, ndjesë mëkatash, dhe robë paprishjeje, le t' i lutemi Zotit.

Që të dëgjojë Zoti Perëndi zërin e lutjes s' onë, le t' i lutemi Zotit.

Që të shpëtojë këtë dhe ne prej ç' do hidhërimi, mërie, reziku, dhe nevoje, le t' i lutemi Zotit.

Përkrah-na, shpëtô-na...
Tëreshëntën, të pacinuarën. .

Dhe kur i thotë këtô Diaku, PRIFTI thotë fshehtazi këtë

URIM.

O Perëndî e zëmër-dhëmpshur dhe mëshirëplote, që nxonit zëmrat dhe veshnjet, dhe je i vetëmi që di të fshehtat e njerëzive; se s' ka gjë të fshehur përpara teje, po të gjitha janë lakuriq e qafë-thyera nër syt' e tû; ti që di të miat, të mos të të vijë ndot prej meje, as që të kthesh faqen tënde nga mua, po çvështroj-i fajet e mia më këtë orë, ti që çvështron mëkatat e njerëzive për pendim, dhe çpërlaj-m'a ndyrësin' e trupit dhe piklën e shpirtit, dhe shëntërô-më të tërë, me fuqinë tëndë të padukur, dhe me të diathtën tënde të shpirtëshme; që të mos dukem i pavyer si shërbëtor i mëkatës, atiê tek u zotohem të tierëve lirî, dhe u' a fal me anën e besës së varrur prej njerzidashjes s' ate së patreguar. Mos, ô Zot, i vetëm i mirë dhe njerzidashës, mos u-kthefsha prapë i përunjur dhe i turpëruar; po dërgô-më fuqî që-lartazi, dhe forcô-më në shërbesën e Mysterit tënt të parëvënë, të math e qiellor; dhe pikturô korën e Krishtit tënt në këtë që do t' përlindet me anën e pavlerësisë s' ime; dhe ndërtoj-e në themelî t' Apostujve dhe të Profetëve tënt, dhe mos e çpërhith, po mbill-e si bimë së vërtete në Kishën tënde të Shëntë, të Përgjithëshme dhe Apostollore dhe mos e çrënjos, që, duke përparuar ay më mirbesim,

të lavdërohet dhe prej anës së tij Emëri yt i tërëshëntë, i Atit, dhe i Birit, dhe i Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Pastaj thotë këtë Urim me zë të math :

URIM

I math je, ô Zot, dhe të habitshîme janë veprat e tua dhe asnjë fialë s' është miaft për të hymnuar çudirat e tua (Tri herë). Ti, duke dashur, si i bëre të gjitha të jenë nga e mosqëna, e përmbarë kriesën me pushtetin tënt, dhe sundon botën me providencën tënde. Ti kur e trajtove ndërtesën prej katër elementesh, e kurorëzove qarkun e motit me katër kohëra. Përpara teje dridhen gjithë Fuqit' e mëndëshme ; ty të këndon Dielli, ty të lavdëron hëna, përpara teje dalin yjtë, ty të bindet drita, ty t' a kanë frikën avushat, ty të-shërbejnë burimet. Ti e ndeve qiellin porsi kurtinë, ti e themelove dhenë mi ujërat, ti vure pluhërin si mur rreth detit, ti derdhe erën për të marrë frymë. Ty të meshojnë Fuqitë Engjëllore, vallet e kryeëngjëjve ty të falen ; Qerubimet e shumë-syshme dhe Serafimet e gjashtë-krahëshme, që të rrinë rreth-përqark e flytyrojnë rrotull mbulojnë faqen nga frika e lavdisë s' ate së paafëruar. Se ti, duke qënë Perëndî e papërshkruar, pa-nisje dhe i patreguar, erdhe mi dhê, duke marrë fytyrë robi, dhe linde me shëmbëllsî njeriu ; se nuk duroje, ô Zot, nga zëmerdhëmpshëria, të shëkoje gjindjen e njerësve të tyraniset prej Diallit, po

erdhe e na shpëtove. E rrëfejmë hirin, e lëçitim mëshirën, nuk e fshehim mirënjohjen. I çlirove brezat e natyrës s' onë, shëntërove bark të virgjër me lindjen tënde; tërë kriesa të hymnoj kur u-fanese. Se ti, Perëndia jonë, u-duke mi dhê e u-shokërove me njerëzit; ti shëntërove dhe riedhjet e Jordanit, duke u dërguar prej qiellit Shpirtin tënt Shënt, dhe dërmove krerët e dragojve që mfolesonin atiê. Ti pra, ô Mbret njerzidashës, eja dhe tanî, me përmindodhjen e Shpirtit tënt Shënt dhe shëntërô këtë ujë. (Tri herë.) Dhe ep-i hirin e çpërblimit, bekimin e Jordanit; bëj-e burim paprishjeje, dhuratë shëntërimi, zgjidhje mëkatash, largimtare sëmundjesh, rrëmujë për demonët, të paaferuar për fuqitë kundrështare, të rrafshuar me fuqî ëngjëllore. Le të ikijnë prej saj atâ që lakmojnë kriatyrën tënde, se emërin tënt, ô Zot, përthirra, të çuditshim, të lavderuar, dhe të tmerruar për armiqtë.

Dhe e kryqëson ujën, duke fryrë, tri herë, dhe uron duke thënë:

URIM.

Le të dërmohen nënë shënjën e Kryqit tënt të çëmuar gjithë fuqitë kundrështare (Tri herë.) Le të hiqen përpara nesh gjithë idhullat e erëshme dhe të padukura, dhe të mos fshihet nënë këtë ujë nonjë demon i errët, as të zbresë, të lutemi, bashkë me të pagëzuarin nonjë shpirt i lik që siell errësim mejtimesh dhe trubullim mëndjeje. Po ti, ô Zot i të gji-

thave, rrëfej-e këtë ujë, ujë çpërblimi, ujë shëntërimi, paqësim mishi e shpirti, zgjidhje vargojsh, ndjesë fajesh, ndriçim shpirtesh, banjë përlindjeje, përsëritje mëndjeje, hir adoptimi. robë paprishjeje, burim jete. Se ti the, ô Zot : — Lahuni dhe bëhuni të paqmë ; largoni ligësitë prej shpirteve tuaj. Ti na fale përlindjen që-lartazi, me ujë e me Shpirt. Çfaqu, ô Zot, në këtë ujë ; dhe ep që të ndryshohet ay që do t' pagëzohet në të, të çveshë njerin' e motshim, që humbet pas dëshirat e rrejtjes, e të vishet njerin' e ri që përsëritet pas korës s' atî që e ndërtoj ; që, duke u-bëre anëtar i shëmbëllës së vdekjes s' ate me anën e Pagëzimit, të bëhet dhe piesëtar i ngjalljes s' ate ; dhe, duke ruajtur dhuratën e Shpirtit tënt Shënt, e duke shtuar konsignimin e hirit, të marrë bravurën e thirrjes-lart, e të nëmërohet bashkë me të parëlindurit, që janë shkruar në qiell, te ty Perëndia dhe Zoti ynë Jesu Krisht. Se ty të ka hie ç' do lavdî, fuqî, nder dhe adhurim, bashkë me Atin tënt pa-nisje, dhe me tëreshëntin, të mirin, dhe jetëdhënësin Shpirtin tënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

PRIFTI :

Paqje mi ju të gjithë.

VALLEJA :

Dhe me frymën tënde.

PRIFTI :

Krerët tuaja unjiani Zotit.

VALLEJA :

Ty, ô Zot.

I fryn enës së vajit tri herë dhe e shënon tri herë vajnë që e mban DIAKU e thotë :

Le t' i lutemi Zotit.

PRIFTI thotë këtë

URIM.

O Zot i Math, Perëndî e Atërve tanë, që u dërgove atyre që ishin në arkë të Noes pëllumbin, që mbante mi gojë degë ulliri, symbol pajtimi, dhe shpëtimi prej përmbytjes, që parështype me tô mysterin e hirit dhe dhurove pemën e ullirit për mbarim të Mystereve tënde të shënta, që me anën e tij mbushe me Shpirt Shënt nënëligjësit, dhe përfekton të hiruarit. Ti bekô dhe këtë vaj me fuqinë, vepërimin, dhe përmindodhjen e Shpirtit tënt Shënt, që të bëhet lyejtje paprishjeje, armë drejtërie, përsëritje shpirti dhe trupi, largim ç' do vepërimi diallësor, shpëtim prej të këqiash për gjith' atâ që lyhen me besë, a piesëtojnë prej tij ; për lavdinë tënde, dhe të Birit tënt të vetëm, dhe të Shpirtit tënt tërëshënt, të mirë, dhe jetëdhënës, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

DIAKU :

Le të vëmë re.

PRIFTI këndon :

Alleluia, Tri herë bashkë me POPULLIN dhe bën tre Kryqe me vajnë n' ujë. — Pastaj me zë të lartë :

E bekuar është Perëndia që ndriçon dhe shëntë-

ron ç' do njerî që vien në botë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

VALLEJA :

Amen.

Dhe sillet ay që do t' pagëzohet. PRIFTI merr prej vajit, dhe bën shënjën e Kryqit mi ballën, krahërorin dhe në mes të supeve duke thënë :

Lyhet shërbëtor' i Perëndisë (aksh) me vaj ngazëllimi, më emërin e Atit, dhe të Birit, dhe të Shpirtit Shënt. Amen.

Dhe lyen krahërorin dhe supet dhe në krahëror thotë :

Për shërim shpirti dhe trupi.

Nër veshët : Për dëgjim bese.

Nër këmbët : Që të baresë pas përçapët e tua.

Nër duartë : Duart' e tua më bënë e më gatuan.

Dhe si të lyhet tërë trupi, e pagëzon PRIFTI, duke e mbajtur më-këmbë nga an' e Lindjes dhe duke thënë :

Pagëzohet shërbëtor' i Perëndisë (aksh) më emërin e Atit, Amen ; dhe të Birit, Amen ; dhe të Shpirtit Shënt ; Amen ; (më ç' do përthirrje e zhyt dhe e nxier).

Pas Pagëzimit PRIFTI lahet, duke kënduar bashkë me POPULLIN :

PSALM 32.

Lum kujt i' u-fale paudhësitë edhe i' u-mbuluan fajet. Lum' ay njerî që nuk do t' i nëmërojë faj Zoti, edhe s' ka gënjeshtrë në gojë të tij, kur pushova, u-vjetëruan eshtërat e mia prej klithmës

s' ime gjithë ditën. Sepse dit' e natë u-rëndua dora jote mbi mua ; notia ime u-kthye më thatësirë vere. Mëkatën t' ime t' a dëftova, edhe paudhësinë t' ime nuk e fsheha. Thashë : Do t' i rrëfej Zotit paudhësinë t' ime, edhe ti fale pabesërin' e zëmërës s' ime. Për këtë do t' të falet ç' do i drejtë më kohën e përtëshme ; po në përmbytje shumë ujërash, nuk do t' i afërohen. Ti je përikja ime ; ti do t' më ruash prej shtrëngimit; do t' më qarkosh me këngë çlirimi. Do t' t' ap mënt, edhe do t' mësoj n' atë udhë që do t' ecësh, do t' të këshilloj, mi ty do të jenë syt' e mî. Mos u-bëni si kalë e si mushkë që s' kanë kuptim, të cilave goja duhet t' u mbahet me gojëzë e me frê që të mos t' afrohen. Vrushkullat e fajtorit janë shumë, po atë që shpëren mbë Zotin, do t' a qarkojë përdëllimi. Gëzohuni për Zotin edhe ngazëllohuni, ô të drejtë, edhe mburruni gjithë zëmër-drejtët.

Dhe e vesh me robën e tij të Pagëzimit, duke thënë :

Vishet shërbëtor' i Perëndisë (aksh) me këmishë drejtësie, më emërin e Atit, dhe të Birit, dhe të Shpirtit Shënt ; Amen.

Dhe këndohet ky Tropar më Tingëll Tërthor IV :

Fal-më këmishë të ndriçime, ti që vishesh me dritën si robë, Krisht mëshirëplot, Perëndia jonë.

Dhe, passi e vesh, PRIFTI thotë këtë

URIM :

Le t' i lutemi Zotit.

I bekuar je, ô Zot, Perëndî e Tërëfuqishme, bu-

rim i të mirave. Diell' i drejtësisë, që shkëlqeve nër atâ q' ishin n' errësirë dritë shpëtimi me manifestimin e të vetëmit t' yt-Bir dhe Perëndisë s' onë, dhe na fale neve të pa-vyerve paqësimin e lumur me Pagëzimin e shëntë, dhe shëntërimin e hyjëshm me Krismën jetëdhënëse ; që dhe tanî dignove të përlindësh shërbëtorin tënt të rish-ndriçuar me ujë e me Shpirt, dhe i dhurove ndjesën e mëkatave të dashura e të padashura: Ti, ô Zot i Math, Mbret mi mbretër i zëmër-dhëmpshur, fal-i dhe shilën e dhuratës së Shpirtit tënt të shëntë, të tërëfuqishim dhe të adhuruarshim, dhe kungatën e Trupit të shëntë dhe të Gjakut të çëmuar të Krishtit tënt. Ruaj-e më shëntërimin tënt, dhe shiguroj-e më besën Orthodoxe ; shpëtoj-e prej të ligut dhe prej intrigave të tij dhe ruaj-e shpirtin e tij me frikën tënde shpëtimtare më kullim e më drejtësî, që të të pëlqejë më ç' do punë e më ç' do fialë, dhe të bëhet bir dhe trashëgimtar i Mbretërisë s' ate qiellore.

PRIFTI duke thirrur :

Se ti je Perëndia jonë, Perëndî mëshire dhe shpëtimi, dhe ty të dërgojmë lavdî, Atit, dhe Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Pas Urimit, lyen të Pagëzuarin me Myrrë të shëntë, duke bërë shënjë kryqi mi ballën, mi sytë, mi vërat e hundës, mi gojën, mi të dy veshët, mi krahërorin.mi duartë, e mi këmbët, duke thënë :

Shilë dhurate prej Shpirtit Shënt. Amen.

Pastaj PRIFTI me Nunë dhe me foshnjën rrotullojnë Fontin dhe këndojnë :

Sa u-pagëzuat më Krishtin, me Krishtin u-veshtë. Alleluia. (Tri herë.)

Fuqî. Me zë më të fortë : Sa u-pagëzuat më Krishtin....

Pastaj

APOSTULLI.

Zoti është ndriçimi im dhe shpëtimtari im. Zoti është mprojtësi i jetës s' ime.

Këndimi prej Letrës së Palit nër Romanët.

Vëllezër, sa u-pagëzuam më Krishtin, më vdekjen e tij u-pagëzuam. U-varruam pra me të me anën e pagëzimit më vdekjen, që, siç u-njgall Krishti së-vdekurësh me lavdin' e Atit, ashtu dhe ne do t' baresim më përsëritje jete. Se në u-bëmë piesëtarë në shëmbëllim të vdekjes së tij, do të bëhemi pra dhe në ngjalljen e tij, duke ditur këtë, që njeriu ynë i motshim u-kryqësua bashkë, që t' abolitet trup' i mëkatës që të mos i shërbejmë më mëkatës. Se ay që vdiq është i çliruar prej mëkatës. Në vdiqmë pra bashkë me Krishtin, besojmë se dhe do të rrojmë bashkë me të ; duke ditur që Krishti, si u-ngrit së vdekurësh, nukë vdes më ; vdekja nuk e pushton më. Se që vdiq, vdiq një herë për mëkatën, po që rron, rron më Perëndinë. Ashtu dhe ju e nëmëroni veten tuaj të vdekur nga mëkata, dhe të gjallë nga Perëndia, më Jesu Krishtin Zotin tonë.

VALLEJA :

Alleluia, Alleluia, Alleluia.

DIAKU :

Që të vlerësohemi....

PRIFTI thotë :

UNGJILLI

Pas Mattheut.

M' atë kohë, njëmbëdhjetë Nxënësit vajtin në Galilê, në malt ku i kish porositur Jesuj. Dhe kur e panë i u-falne ; po ca dyshuan. Dhe u-afërua Jesuj e u foli, duke thënë : M' u-dha ç' do pushtet në qiell e mbi dhê. Ecëni pra dhe nxënësoni gjithë kombet, duke i pagëzuar më emërin e Atit, dhe të Birit, dhe të Shpirtit Shënt; duke i mësuar të ruajnë sa ju porosita ; dhe ja unë do të jem bashkë me ju tërë ditët, gjer në mbarim të jetës. Amen.

Pastaj Litanî e Gjerë dhe Përlëshim.

Pas shtatë ditsh e siellin përsërî foshnjën më kishë që t' a lajnë. PRIFTI i zgjesh shpargërin dhe brezë, duke thënë këtô Urime :

Le t' i lutemi Zotit.

Ti që i dhurove shërbëtorit tënt (aksh) çpërblim mëkatash me anën e Pagëzimit të shëntë dhe i fale përlindje jete, Ti, ô Zot i Math, dignô të shkëlqejë për gjithmonë në zëmër të tij drit' e faqes s' ate dhe ruaj-e mburonjën e besës së tij të palakmuar prej armiqsh ; robën e paprishjes, që u-vesh, ruaj-e te ky të kulluar e të pacinuar; duke mbajtur me hirin tënt

shilën Shpirtore të pathyer, dhe duke u-rrëfyer i hirëshim për këtë dhe për ne, pas shumicës së mëshirave tënde.

Se ësht i bekuar dhe i lavdëruar emëri yt i nderçim dhe madhështor, i Atit, dhe i Birit, dhe i Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Le t' i lutemi Zotit.

O Zot i Math, Perëndia jonë, që me anën e Fontit u fal ndriçimin qiellor të pagëzuarve, që përlinde shërbëtorin tënt të rish-ndriçuar me ujë e me shpirt, dhe i dhurove ndjesë mëkatash të dashura e të padashura; vër mi të dorën tënde të pushtetshime, dhe ruaj-e me fuqin' e mirësisë s' ate; ruaj-e vlesimin të papikluar; dhe vlerësoj-e për jetën e ameshuar dhe për mirëpëlqimin tënt.

Se ti je shëntërimi ynë, dhe ty të dërgojmë lavdinë, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e.....

PRIFTI :

Paqje mi ju të gjithë.
Krerët tuaja unjani Zotit.

URIM.

Ay që u-vësh me ty Krishtin dhe Perëndinë tonë, ty t' a unji kryet bashkë me ne; ruaj-e luftëtar të pamundur kundër atyre që ngrenë armiqësî më kot kundër tij dhe kundër nesh; dhe rrëfê-na të gjithëve mundës gjer në funt me kurorën tënde të pafishkur.

Se jotja është mëshira dhe shpëtimi dhe ty të dërgojmë lavdî, bashkë me Atin tënt pa-nisje, dhe Shpirtin tënt tëreshënt, të mirë dhe jetëdhënës, tanî e përherë, e në jetë jetëve. Amen.

Dhe e zgjith brezin e foshnjës dhe shpargërin, i bashkon anët, i lak me ujë të paqmë dhe e spërkat foshnjën, duke thënë:

U-drejtësove, u-ndriçove, —

Dhe merr një sfyngjer të ri me ujë, fshin faqen e tij, kryet, krahërorin, etj., duke thënë:

U-pagëzove, u-ndriçove, u-myrrose, u-shëntërove, u-çpërlave, më emërin e Atit, dhe të Birit, dhe të Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë jetëve. Amen.

URIM MË QETHJEN.

O Zot i Math, Perëndia jonë që nderove ujerinë me korën tënde, dhe e gatove prej shpirti t' arësyshmë dhe prej trupi të hiëshm, që t' i shërbejë trupi shpirtit t' arësyshmë; dhe vure kryet lart, dhe vëndose atjê më të shumat e ndjenjave, të cilat s' ndalojnë njëra-tjatërën; dhe mbulove kryet me qime që të mos pësojë dëm nga ndryshimet e erërave, dhe mbolle të gjitha copët e trupit për dobî, që të të përhirojë me të gjitha ty artistin; Ti, ô Zot, që na porosite me anën e enës s' ate së zgjedhur, Apostull Palit, të gjitha t' i bëjmë për lavdinë tënde, shërbëtorin tënt (aksh) që vien të të bëjë një dhuratë të

parë prej leshit të kresë së tij bekoj e bashkë me nunë, dhe ep'u që të shtudiojnë të gjitha pas ligjës s' ate dhe të bëjnë atô që të pëlqejnë.

Se ti je Perëndî mëshirëplote dhe njerzidashëse, dhe ty të dërgojmë lavdî, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Paqje mi ju te gjithë. Krerët tuaja unjjani Zotit.

Dhe thotë këtë Urim :

O Zot, Perëndia jonë, i cili me rrafshërimin e Fontit tënt shëntërove atâ që të besojnë pas mirësisë s' ate, bekô dhe këtë foshnjë, e le të zbresë mi kryet e tij bekimi yt. Dhe si bekove me anën e Profetit Samuel, mbretin David, bekô dhe kryet e shërbëtorit tënt (aksh) me dorën t' ime të mëkatarit, duke e frymëzuar me Shpirtin tënt Shënt ; që të të dërgojë lavdî gjer sa të mplaket e të zbardhet, e të shëkojë të mirat e Jerusalemit gjithë ditët e jëtës së tij.

Se ty të ka hie ç' do lavdî, nder, e adhurim, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, ë ne jetë të jetëve. Amen.

Dhe e qeth kryqthi, duke thënë :

Qethet shërbëtor' i Perëndise (aksh) më emërin e Atit, e të Birit, e të Shpirtit Shënt ; Amen.

Pastaj përkujton Nunë.

Mëshirô-na, ô Perëndî...
Të lutemi dhe për mëshirë, jetë...

Se ti je Perëndî mëshirëplote dhe njerzidashëse dhe ty të dërgojmë lavdî, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Dhe bëhet Përlëshim' i zakonëshm.

BKSH

MARTESA

SHËRBES' E VLESIMIT.

Pas Meshës së hyjëshme, Prifti qëndron më shëntëroren' dhe atâ që do t' martohen përpara Dyerve të shënta, burri më të diathtë, dhe gruaja më të mëngjër. Vihen dy unaza m' anën e diathtë t' Alltarit, një e artë dhe një e ergjënttë. Prifti shënon krerët e për-të-martuarve dhe u ep nga një qirî të ndezur, temianis, dhe pastaj thotë DIAKU :

Bekô, ô Zot.

PRIFTI me zë të lartë :

E bekuar është Përëndia jonë për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

VALLEJA :

Amen.

DIAKU :

Më paqje le t' i lutemi Zotit.

VALLEJA :

Mëshirô, ô Zot.
Për paqjen që-lartazi...
Për paqjen e tërë botës...
Për këtë Shtëpí të shëntë...
Për Kryepeshkopin t' onë...
Për shërbëtorin e Perëndisë (aksh), dhe shërbëtoren e Perëndisë (aksh), që po vlesohen me njër-

jatërin, dhe për shpëtimin e tyre, le t' i lutemi Zotit.

Që t' u falë fëmijë për vazhdimin e gjindjes, dhe gjithë lypjet për shpëtim, le t' i lutemi Zotit.

Që t' u dërgojë dashurí të plottë, të paqëshme, dhe ndihmë, le t' i lutemi Zotit.

Që t' i bekojë më një-mëndje dhe besë të shigurtë, le t' i lutemi Zotit.

Që t' i ruaj më rrojtje dhe baritje faqe-bardhë, le t' i lutemi Zotit.

Që t' u falë Zoti Perëndia jonë martesë të nderçime dhe shtrat të pacinuar, le t' i lutemi Zotit.

Që të shpëtohemi prej ç' do hidhërimi, mërie, reziku, dhe nevoje, le t' i lutemi Zotit.

Përkrah-na, shpëtô-na...

Tëreshëntë, të pacinuarën...

PRIFTI me zë të lartë :

Se ty të ka hie ç' do lavdî, nder, dhe adhurim, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Pastaj thotë këtë Urim me zë të math :

URIM.

O Perëndî e ameshuar, që mblodhe të ndarat me bashkim dhe u vure lidhje dashurie të pazgjidhur ; që bekove Isaakne dhe Rebekkën, dhe i rrëfeve trashëgimtarë të zotimit tënt ; Ti beko dhe këtâ shërbë-

torët e tû, duke i udhë-hequr më ç' dô veprë të mirë.

Se ti je Perëndî mëshirëplote dhe njerzidashëse dhe ty të dërgojmë lavdî, Atit, e Birit...

Paqje mi ju të gjithë.

DIAKU :

Krerët tuaja unjjani Zotit.

PRIFTI me zë të lartë :

O Zot, Perëndia jonë, që e parëvlesove Kishën si një virgjërë të kulluar prej paganëve, bekô këtë vlesim, dhe bashkoj-i e ruaj-i këtâ shërbëtorët e tû më paqje e më njëmëndje.

Se ty të ka hie ç' do lavdî, nder, e adhurim, Atit...

Pastaj PRIFTI merr unazat, i ep më parë burrit të artën, e i thotë :

Vlesohet shërbëtor' i Perëndisë (aksh), me shërbëtoren e Perëndisë (aksh), më emërin e Atit, e të Birit, e të Shpirtit Shënt. Amen. (Tri herë.)

Dhe i bën kryq me unazën mi krye.
Pastaj i ep gruas unazën e artë e i thotë :

Vlesohet shërbëtor' e Perëndisë (aksh), me shërbëtorin e Perëndisë (aksh), më emërin e Atit, e të Birit e të Shpirtit Shënt. Amen. (Tri herë.)

Pastaj bën kryq me unazën mi krerët e tyre dhe u'a vë nër

gishtërijt' e diathtë. Pastaj Kumtëri u'a këmben unazat. Dhe PRIFTI thotë këtë

URIM.

Le t' i lutemi Zotit.

O Zot, Perëndia jonë, që udhëtove bashkë me shërbëtorin e Patrikut Abraam, i cili u-dërgua t' i gjejë nuse të-zott Isaak, dhe i zbulove për vlesim Rebekkën që kish vatur për ujë ; Ti bekô vlesimin e shërbëtorëve tënt (aksh e aksk), dhe shiguroj-e fialën që kanë dhënë ; vendos-i më bashkimin e shëntë që është pranë teje ; se ti që në krye të herës krijove mashkull e fëmër, dhe prej anës s' ate gruaja gjyntohet me burrin për ndihmë, dhe për ameshim të gjindjes së njerësve.

Ti pra, ô Zot Perëndia jonë, që dërgove të vërtetën mi trashëgimin tënt, dhe zotimin tënt mi shërbëtorët e tû atërit t' anë, dhe nër të zgjedhurit e tû bres pas brezi, hith synë mi shërbëtorin tënt (aksh), dhe shërbëtoren tënde (aksh), dhe pshtet-e vlesimin e tyre më besë, njëmëndje, të vërtetë, dhe dashurî ; se ti, ô Zot, dëftove të ipet vlesim për të gjitha si shigurî. Me unazë i' u-dha pushteti Josefit në Egjyptë ; me unazë u-lavdërua Danieli në Babylonë ; me unazë u-çfaq drejtësi' e Thamarës ; me unazë Ati ynë qiellor u-rrëfye i mëshirëshim për të-Birin ; se tha : « Epini unazë mi dorën e diathtë, dhe therni viçin e ushqyer që të hamë e të dëfrejmë. » Dora jote e diathtë, ô Zot, qëndroj Moisinë më Dett të kuq ; se me fialën tënde të vërtetë u-shiguruan

qiejtë, e u-themelua dheu ; dhe e diathta e shërbëtorëve tënt do t' bekohet me fialën tënde të pushtetshime, dhe me krahun tënt të lartë. Ti pra, ô Zot, bekô dhe tanî këtë unazim me bekim të qiellshmë : dhe Engjëll prej Zoti vaftë përpara tyre tërë ditët e jetës së tyre.

Se ti je që bekon dhe shëntëron të gjitha dhe ty të dërgojmë lavdî, Atit e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Pastaj Litani' e Gjerë dhe Përlëshim.

SHËRBES' E KURORËZIMIT.

PRIFTI temianis e thotë këtë Psalm :

Lum gjith' atâ që i kanë frikë Perëndisë.

VALLEJA më ç' do vark thotë ·

Lavdî ty, ô Perëndia jonë, lavdî më ty.
Atâ që baresin më udhët e tij.
Do të hash pemët e mundimeve tënde.
Lum ti, dhe fat-bardhë do të jesh.
Jote-shoqe do të jetë si vreshtë e ndehur më pllajet e shtëpisë s' ate.
Bijt' e tû si degë ullinjsh të rishmbiellur, rreth tryesës s' ate.
Ja kështû do t' bekohet njeriu që i ka frikë Zotit.
Kështû do t' të bekoje Zoti prej Sionës, dhe do të shohësh të mirat e Jerusalemit gjithë ditët e jetës s' ate.

Dhe do t' shëkosh bijt' e bijve tënt, dhe paqje mi Israelë.

DIAKU thotë :

Bekô, ô Zot.

PRÎFTI :

E bekuar është Mbretëri' e Atit...

DIAKU :

Më paqje le t' i lutemi Zotit.
Për paqjen që lartazi...
Për paqjen e tërë botës...
Për këtë Shtëpî të shëntë...
Për Kryepeshkopin tonë...
Për shërbëtorët e Perëndisë (aksh e aksh), që po lidhen me njërjatërin më shokërî martese, dhe për shpëtimin e tyre, le t' i lutemi Zotit.
Që të bekohet kiô martesë, si e Kanasë në Galilê, le t' i lutemi Zotit.
Që t' u falë urtësî dhe fëmîjë për të mirën e tyre, le t' i lutemi Zotit.
Që të ngazëllohen, duke parë bij e bija, le t' i lutemi Zotit.
Që t' u dhurojë dëfrim mirfëmijësimi, dhe siellje të pabiashmuar, le t' i lutemi Zotit.
Që t' u dhuroje këtyre dhe neve gjithë lypjet për shpëtim, le t' i lutemi Zotit.
Që t' i shpëtojë këtâ dhe ne prej ç' dô hidhërimi, mërie...

Përkrah-na, shpëtô-na...
Tëreshëntën, të pacinuarën...

PRIFFI me zë të lartë :

Se ty të ka hie ç' do lavdî, nder, e adhurim, Atit, e...

DIAKU

Le t' i lutemi Zotit.

PRIFTI thotë me zë të math këtë

URIM.

O Perëndî e kulluar, dhe krijetar i tërë ndërtesës, që shpërfytyrove ien e stërgjyshit Adam më grua nga njerzidashja jote, dhe i bekove duke thënë : «Shtohuni dhe shumohuni, dhe zotëroni mi dhenë», dhe i rrëfeve që të dy një trup me martesën ; se përandaj njeriu do të lërë më-nj'-anë t' anë e t' ëmën dhe do të ngjitet pas gruas së tij, dhe do të jenë që të dy një mish ; dhe atâ që i gjyntoj Perëndia, njerî të mos i ndajë ; që bekove shërbëtorin tënt Abraam, dhe çele gjin' e Sarrës, dhe e bëre atë shumicë kombesh ; që i fale Rebekkën Isaakut, dhe bekove fëmijën e saj ; që bashkove Jakobin me Raqelën, dhe prej syresh çfaqe dymbëdhjetë Patrikët ; që shoqërove Josefin me Asynethen, dhe u fale pemë fëmijësimi Efraimnë dhe Manasinë ; që akseptove Faharinë dhe Elisabetën dhe u dhurove Parërendësin ; që prej rënjës së Jeseut mishërisht burbuqose

Gjithmon-virgjërën, dhe prej sâj more trup dhe linde për shpëtim të gjindjes së njerësve ; që nga dhurata jote e patreguar dhe nga mirësia e shumë erdhe në Kanâ të Galilesë, dhe bekove dasmën e atieshme, që të rrëfesh se martesa e ligjëshmë është dëshira jote si dhe fëmijë-lindja prej saj ; Ti, ô Zot i tërëshëntë, prit dhe faljen tonë të lutësve tënt, duke ardhur dhe këtû si atjê me përmindodhjen tënde të padukur ; bekô këtë martesë, dhe dhuroj' u shërbëtorëve tënt (aksh e aksh) jetë të paqëshme, ditë të gjata, urtësî, dashurî për njërjatërin më lidhjen e paqjes, farë jetë-gjatë, mirënjohjen e fëmijës që është kurorë lavdie e pafishkur ; vlerësoj-i të shëkojnë bij bijsh ; ruaj'u shtratin të palakmuar ; dhe ep'u vesën e qiellit që lartazi dhe të majmët e dheut ; rrafshoj-i shtëpit' e tyre me grurë, verë, yaj, dhe ç' do mirësî që t' u apin dhe atyre që kanë nevojë, duke u dhuruar dhe atyre që janë bashkë me ne gjithë lypjet për shpëtim.

Se ti je Perëndî mëshire, përdëllimesh, dhe njerzidashjeje, dhe ty të dërgojmë lavdî bashkë me Atin tënt pa-nisje, dhe Shpirtin tënt tërëshënt, të mirë dhe jetëdhënës, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

DIAKU :

Le t' i lutemi Zotit.

PRIFTI thotë me zë të lartë këtë

URIM.

I bekuar je, ô Zot Perëndia jònë, meshëtar i

martesës mystike dhe të pacinuar, ligjëvënës i trupësisë, ruajtës i paprishjes, dhe kujdestar i mirë i nevojave të jetës. Ti dhe tanî, ô Zot i Math, që gatove njerinë mëkryezaj, dhe e vure si mbret të kriesës, dhe the : « S' është mirë të jetë vetëm njeriu mbi dhê ; le të bëjmë një ndihmës për të » ; dhe si more një nga iet e tij, gatove gruan, të cilën, kur e pa Adami, tha : « Kiô është ashtë prej eshtërave të mia, dhe mish prej mishit t' im ; kiô do të quhet grua, se u-muar prej burrit të saj ; përandaj do të lërë njeriu më-nj'-anë t' anë e t' ëmën, dhe do të ngjitet pas gruas së tij, dhe do të jenë të dy një mish ; dhe atâ që i gjyntoj Perëndia, njerî të mos i ndajë » ; Ti pra dhe tanî, ô Zot i Math Perëndia jonë, dërgô hirin tënt qiellor mi këtâ shërbëtorët e tû (aksh e aksh) dhe bëj-e këtë vashë t' i bindet më të gjitha burrit, dhe këtë shërbëtorin tënt të jetë më krye të së-shoqes, që të jetojnë pas dëshirës s' ate ; bekoj-i, ô Zot Perëndia jonë, si bekove Abraamin dhe Sarrën ; bekoj-i, ô Zot, si bekove Isaaknë dhe Rebekkën ; bekoj-i, ô Zot Perëndia jonë, si bekove Jakobin dhe gjithë Patrikët ; bekoj-i, ô Zot Perëndia jonë, si bekove Josefin dhe Asynethen ; bekoj-i, ô Zot Perëndia jonë, si bekove Moisinë dhe Sepforën ; bekoj-i, ô Zot, si bekove Zaharinë dhe Elisabetën. Ruaj-i, ô Zot Perëndia jonë, si ruajte Noen në arkë ; ruaj-i, ô Zot Perëndia jonë, si ruajte Jonanë në bark të balenës ; ruaj-i, ô Zot Perëndia jonë, si ruajte tre Diemt' e shëntë prej ziarrit, duke

u dërguar vesë prej qiejve, dhe arthtë mi tâ ay gas, që pati Shënt Elen' e lumur, kur gjeti Kryqin e çëmuar. Kujtoj-i, ô Zot Perëndia jonë, si kujtove Enohun, Semin, dhe Elinë: kujtoj-i, ô Zot Perëndia jonë, si kujtove Dyzet Dëshmorët e shëntë, kur u dërgove kurorët prej qiejve; kujtô, ô Perëndî, dhe prindërit që i rritnë; se urata prindërsh shigurojnë themelî shtëpish. Kujtô, ô Zot Perëndia jonë, shërbëtorët e tû kumtërit, që u-mblodhë bashkë në këtë gëzim. Kujtô, ô Zot Perëndia jonë, shërbëtorin tënt (aksh) dhe shërbëtoren tënde (aksh), dhe bekoj-i; ep'u pemë fëmijësh, diem të bukur, ujdî shpirtesh e trupesh; lartësoj-i si dëllinjat e Libanit, si vreshtë me herdhî të mira; dhuroj'u farë kalliu, që, duke patur ç' dô miaftësî, të tepërojnë më ç' dô punë të mirë dhe të pëlqyer te ty, e të shëkojnë bijt' e bijve të tyre, si degë ullinjsh të rish-mbiellur, rreth tryesës së tyre; dhe, si të dalin faqe-bardhë përpara teje, të shkëlqejnë si yj në qiell, më ty Zotin tonë; se me ty është lavdia, fuqia, nderi, e adhurimi, bashkë me Atin tënt panisje, dhe Shpirtin tënt jetëdhënës, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

DIAKU:

Le t'i lutemi Zotit.

PRIFTI me zë të lartë:

O Perëndî e shëntë, që gatove njerinë prej pluhëri, dhe prej ies së tij ndërtove gruan, dhe i' a shoqërove për ndihmës, se ashtû i pëlqeu madhësh-

tisë s' ate, që të mos jetë njeriu vetëm mi dhê; Ti dhe tanî, ô Zot i Math, ndeh dorën tënde prej shtëpisë s' ate së shëntë, dhe shoqëroj-i shërbëtorin tënt (aksh) dhe shërbëtoren tënde (aksh), se prej teje shoqërohet gruaja me burrin. Bashkoj-i më njëmëndje; kurorëzoj-i më një trup; fal'u fëmijë dhe gëzim mirlindjeje : Se jotja është fuqia, dhe jotja është mbretëria, dhe forca, e lavdia, e Atit, e Birit, dhe e Shpirtit Shënt; tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Pasandaj merr Kurorët dhe më parë kurorëzon Dhëndërin, duke thënë :

Kurorëzohet shërbëtor' i Perëndise (aksh), me shërbëtoren e Perëndisë (aksh), më emërin e Atit, e të Birit, e të Shpirtit Shënt. Passi e thotë tri herë, duke bërë shënjën e Kryqit, kurorëzon Nusen, duke thënë :

Kurorëzohet shërbëtor'e Perëndise (aksh) me shërbëtorin e Perëndisë (aksh) më emërin e Atit, e të Birit, e të Shpirtit Shënt. (Tri herë.)

Pastaj i bekon, duke thënë për-së-treti :

O Zot, Perëndia jonë, kurorëzoj-i më nder e me lavdî.

APOSTULLI.

U vure mi krye kurorë prej gurësh të çëmuar. Jetë të lypnë e u dhe.

Këndimi prej Letrës së Palit nër Efesianët.

Vëllezër, përhironi nga herë për të gjitha Perën-

dinë dhe Atin, më emërin e Zotit tonë Jesu Krisht, duke u-bindur njërjatërit me frikë Perëndie. Ju gra, binduni nër burrat tuaj, si dhe Zotit, se burri është krej' i gruas, sikundër dhe Krishti është krej' i Kishës; dhe ay është shpëtimtar' i trupit. Po, siç i bindet Kisha Krishtit, ashtû dhe gratë t' u binden burrave më ç' do send. Ju burra, duajini gratë tuaja, si Krishti dashuroj Kishën, dhe e përdha veten për të mirën e saj, që t' a shëntëroje, duke e paqësuar me banjën e ujit në fialë; që t' i' a dhuroje vetes së tij Kishën të lavdëruar, pa piklë, e pa sufrë, ose t' atillë gjë, po që të jetë e shëntë dhe e kulluar. Ashtû detyrojnë burrat të duan grat' e tyre, si trupet e tyre. Ay që dô të shoqen, dô veten e tij; se asnjë nuk mërziti mishin e tij; po e ushqen dhe e përkujdes, si dhe Krishti Kishën; se ne jemi copra të trupit të tij, prej mishit të tij dhe prej eshtërave të tij. Përandaj do të lerë njeriu t' anë e t' ëmën, e do të ngjitet pas gruas së tij, dhe do të jenë që të dy një mish. Ky Myster është i math; po flas pas Krishtit e pas Kishës. Po dhe ju cilido veçan ashtû le t' a dojë të shoqen si veten e tij, dhe gruaja të i' a ketë frikën burrit.

Alleluia. Tri herë).

UNGJILLI PAS JOANIT

M' atë kohë, u-bë një dasmë në Kanâ të Galilesë dhe ish dhe e Em' e Jesujt atjê. U-ftua dhe Jesuj dhe Nxënësit e tij më dasmën. Dhe kur u-mbarua

vera, i tha Jesujt e Ema : Nukë kanë verë. I thote Jesuj : Ç' ka në mes teje e meje, ô grua ? nukë ka ardhur êdhe ora ime. U thot' e Em' e tij shërbëtorëve : Ç' të ju thotë, bëni. Dhe ishin atjê gjashtë shtëmba prej guri, që ndodheshin pas paqësimit të Judejve, dhe që nxinin dy a tri masa. U thotë atyre Jesuj : Mbushni shtëmbat me ujë ; dhe i mbushnë gjer sipër. Dhe u thotë : Nxirni tanî, e shpierini kryesofrësit, dhe i shpunë. Dhe kur e ngjëroj kryesofrësi ujën që ish bërë verë, (dhe nukë dinte ngaha, po shërbëtorët që nxuarë ujën dinin) thërret dhëndërin e i thotë : Ç' dô njeri më parë vë verën e mirë, dhe kur të dehen, atëhere vë të poshtërën ; po ti ke mbajtur verën e mirë gjer tanî. Këtë nisje të shënjave bëri Jesuj në Kanâ të Galilesë, dhe çfaqi lavdin' e tij ; dhe e besuan Nxënësit e tij.

DIAKU :

Le të thomi me gjithë shpirt...
O Zot i Tërëfuqishim.....
Mëshirô-na, ô Perëndî.....
Të lutemi dhe për mëshirë.....

Dhe kujton kumtërit.
PRIFTI me zë të lartë :

Se ti je Perëndî mëshirëplote dhe njerzidashëse, dhe ty të dërgojmë lavdî.....

DIAKU :

Le t' i lutemi Zotit.

Dhe PRIFTI thotë këtë

URIM

O Zot Perëndia jonë, që dignove me kujdesin tënt shpëtimtar t' a njohësh martesën të nderçime në Kanâ të Galilesë me ndodhjen tënde; ti dhe tanî ruaj-i më paqje e më njëmëndje shërbëtorët e tû (aksh e aksh) që i vlerësove të shoqërohen me njerjatërin. Rrëfej-a' u martesën të nderçime; ruaj-e shtratin e tyre të pacinuar; dignô të mbetet rrojtja e tyre e përbashkme faqe-bardhë; dhe vlerësoj-i t' arrijnë më pleqërî të lashtë, duke punuar urdhëratat e tua me zëmër të bardhë. Se ti je Perëndia jonë, Perëndî mëshire dhe shpëtimi, dhe ty të dërgojmë lavdî, bashkë me Atin tënt pa-nisje,....

DIAKU:

Përkrah-na, shpëtô-na.....
Ditën të tërë të mbarë.. .
Engjëll paqjeje.....
Ndiesë dhe falje....
Të mirat e të dobishimet...
Që të shkojmë kohën....
Bashkimin e fesë....

PRIFTI me zë të lartë:

Dhe vlerësô-na, ô Zot i Math, që të guxojmë të përthërresim ty Perëndinë qiellore si Atë sheshit e pa-dënim e të thomi:

POPULLI:

Ati ynë që je ndë qiell.....

PRIFTI me zë të lartë:

Se jotja është Mbretëria, edhe fuqia, edhe lavdia, e Atit.....

Paqje mi ju të gjithë...

DIAKU:

Krerët tona le t' i' a unjim Zotit.

Pastaj sillet Qelq'i përbashkmë dhe PRIFTI e bekon duke thënë këtë Urim:

Le t' i lutemi Zotit.

O Perëndî, që i bëre të gjitha me fuqinë tënde, dhe shigurove gjithësinë, dhe stolise kurorën e gjithë gjërave që ke bërë, bekô me bekim të shpirtëshm dhe këtë Qelq të përbashkmë që u fal këtyre që u-bashkuan më shokërî martese.

Se emëri yt është i bekuar dhe e lavdëruar është Mbretëri' e Atit.....

Pastaj Prifti merr më dorë Qelqin e përbashkmë dhe u ep për-së-treti më parë burrit dhe pastaj gruas. Pastaj Prifti i merr e i kthen rreth përqark, bashkë me Kumtërin, i cili mban kurorët që-prapazi.

Dhe PRIFTI a POPULLI këndojnë këtô Tropare:

TINGËLL TERTHOR I.

Luaj valle, ô Esaja, Virgjërseha mbeti me barrë,

dhe lindi një bir Emmanuel, Perëndî edhe njerî ; Lindje ësht emër' i tij ; të cilin duke madhështuar, Virgjëreshën lumërojmë.

TINGËLL II.

Dëshmorë të shëntë, që luftuat mirë dhe u-kurorëzuat, nërmjetoni te Zoti, të mëshirohen shpirtet tona.

Lavdî ty, ô Krisht Perëndî, mburrj' e Apostujve, ngazëllim' i Dëshmorëve, lëçitj' e të cilëve ish Trini' e bashkëqënurshme.

Pastaj ngrê Kurorët; dhe më të Dhëndërit thotë :

Madhoh-u, ô Dhëndër, si Abraami, dhe bekoh-u si Isaaku, dhe shumoh-u si Jakobi, duke baritur më paqje, e duke vepëruar me drejtësî urdhërimet e Perëndisë.

Dhe më të Nuses thotë :

Dhe ti, ô Nuse, madhoh-u si Sarra, e ngazëlloh-u si Rebekka, e shumoh-u si Raqela, duke u-gëzuar me burrin tënt, e duke ruajtur kondicjet e ligjës, se ashtû deshi mirë Perëndia.

Pastaj DIAKU :

Le t' i lutemi Zotit.

PRIFTI thotë këtë Urim:

O Perëndî, Perëndia jonë, që erdhe në Kanâ të Galilesë dhe bekove dasmën e atieshme, bekô dhe

këtâ shërbëtorët e tû, që u-bashkuan më shokëri martese pas providencës s' ate. Bekô hyrjet e daljet e tyre ; shumoj-e jetën e tyre me të mira ; merr-i Kurorët e tyre lart në Mbretëri tënde, duke i ruajtur faqe-bardhë, të pacinuar e të palakmuar më jetët të jetëve. Âmen.

Paqje mi gjithë ju.

DIAKU :

Krerët tona le t' i a unjim Zotit.

PRIFTI thotë këtë Urim :

Ati, Biri, edhe Shpirti Shënt, Trinia e tërëshëntë, e bashkëqënurshme dhe jetëdhënëse, Hynia e njëshmë dhe Mbretëria, ju bekoftë, e ju faltë jetë të gjatë, fëmijë të mirë, përparim jete dhe bese, ju mbushtë me gjithë të mirat e dheut, dhe ju vlerësoftë për gëzimin e të mirave të zotuara ; me nërmjetimet e Hyjlindëses së shëntë dhe të gjithë Shëntorëve. Amen.

Pastaj hyjnë dhe i urojnë ; dhe, si përshëndoshen, bëhet prej PRIFTIT Përlëshimi kështû :

Krishti, Perëndia jonë e vërtetë, që e rrëfeu martesën të ndershime, duke u-ndodhur në Kanâ, me nërmjetimet e Zonjës Shën-Marî, t' Apostujve të shëntë, të lavdëruar dhe emër-shkëlqyer, të Shën Kostantin dhe Shën-Elenës, Mbretërve të kurorëzuar prej Perëndie dhe një-me-Apostujtë, të Shën

Prokopit, Dëshmorit të Math, e të gjithë Shëntorëve, na mëshiroftë e na shpëtoftë, si i mirë dhe njerzidashës.

URIME MË ZGJIDHJEN E KURORËVE.

PAS TETË DITSH.

O Zot, Perëndia jonë, që bekove kurorën e motmotit, dhe na dhê lejë t' u vëmë këtô Kurorë më kryen e atyre që u-bashkuan me ligjë martese, dhe u' a fale si një çpagim të urtësisë, nga që u-shoqëruan të kulluar te dasma që u-vû si ligjë prej teje ; Ti dhe më zgjidhjen e këtyre Kurorëve, bekoj-i të martuarit, dhe ruaj-e bashkimin e tyre të papërndarë, që t' a përhirojnë nga herë emërin tënt të tërëshëntë, të Atit....

Paqje mi ju të gjithë.

Krerët tuaja unjiani Zotit.

URIM.

Shërbëtorët e tû, ô Zot, si mbetnë më një mëndje, dhe mbaruan shërbesën e martesës në Kanâ të Galilesë, dhe u-pajtuan më nyjet e saj, Ty të dërgojnë lavdî, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Dhe bëhet Përlëshimi.

SHËRBESA E RRËFIMIT

ATI SHPIRTOR e shpie atë që dô të rrëfehet përpara Korës së Zotit tonë Jesu Krisht, e thotë :

Shënt Perëndî...
Triní e tërëshëntë...
Ati ynë që je ndë qiell...
Se jotja është mbretëria...
Mëshirô, ô Zot. (12 herë.)

Eni le t' i falemi e t' i biem nër këmbë Perëndisë Mbretit tonë. Eni le t' i falemi e t' i biem nër këmbë Krishtit, Perëndisë dhe Mbretit tonë. Eni le t' i falemi e t' i biem nër këmbë vetë Krishtit, Perëndisë dhe Mbretit tonë. (Tri falje.)

PSALM 51.

Përdëllyes, përdëllê-më, ô Perëndî....

Pastaj këtô Tropare :

Mëshirô-na, ô Zot,... (Shëkô në 'Blatë.)

Lavdî :

Mëshirô-na, ô Zot...

Tanî :

Hap-na derën e zëmër-dhëmpshërisë....
Mëshirô, ô Zot. (12 herë.)

Pastaj thotë PRIFTI :

O Perëndî, shpëtimtari ynë, që i dhurove ndjesë fajesh Davidit që u-pendua me anën e Profetit tënt Nathan, dhe prite faljen e pendimit të Manasiut ; Ti, pas njerzidashjes s' ate së zakonëshme, prit dhe shërbëtorin tënt (aksh) që pendohet për fajet që ka bërë, duke çvështruar tërë atô që ka bërë, ti që fal paudhësitë dhe nuk i vë re paligjësitë. Se ti the, ô Zot : Nukë desha me dëshirë vdekjen e mëkatarit, po kthimin e rrojtjen e tij ; dhe që do t' i ndjesh fajet gjer më shtatëdhjetë herë shtatë ; se madhështia jote ësht e papërqasur dhe mëshira jote e panëmëruar ; se në vënç re paligjësitë, kush do t' qëndrojë ? Se ti je Perëndî e atyre që pendohen dhe ty të dërgojmë lavdî, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Pastaj këtë Urim :

Le t' i lutemi Zotit.

O Zot Jesu Krisht, Bir' i Perëndisë së gjallë, bariu dhe qëngji, që ngre mëkatën e botës, që u fale huan të dy detorëve, dhe i dhurove mëkatares ndiesë të mëkatave të saj ; Ti, ô Zot i Math, ndjej-i, fal-i mëkatat, paligjësitë, fajet e dashura dhe të padashura, me dijë, me padijë të cilat bënë shërbëtorët e tû. Dhe, në qoftë se si njerës me mish që rrinë në botë u-gënjyen prej Diallit, ose me fialë, ose me punë, ose me dijë, ose me padijë, ose në

shkelë fialë Prifti, a ranë në mallkim Prifti, ose n' anathemë të tij, ose shkelë ben' e tyre ; Ti, si Zot i mirë dhe zëmër-bardhë, dignô·t' i falësh shërbëtorët e tû pas mëshirës s' ate së madhe.

Po, ô Zot njerzídashës, dëgjô-na që po i lutemi mirësisë s' ate për këtâ shërbëtorët e tû, dhe mos i vër re si mëshirëplot fajet e tyre ; shpëtoj-i prej Ferrit të përjetëshm ; se ti the, ô Zot : Sa të lithni mi dhê, do të jenë të lidhura në qiell ; dhe sa të zgjithni mi dhê, do të jenë të zgjidhura në qiell. Se ti je i vetëmi i pamëkatëshm, dhe ty të dërgojmë lavdî, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Pastaj PRIFTI i thotë të penduarit :

Vëllâ, mos kî turp për atë që erdhe te Perëndia dhe te mua ; se nuk m' i thua mua, po Perëndisë, përpara të cilit qëndron.

Dhe më parë e pyet për besën e tij.

Beson, ô im-bir, m' atô që na mëson Kish' e shëntë e Përgjithëshme dhe Apostollore ?

I penduari thotë Symbolin e fesë :

Besoj më një Perëndî...

Pastaj Prifti e pyet me radhë për gjithë mëkatat dhe, passi mbaron, e këshillon që të mos i përsëdytë. Pasandaj i thotë :

Përgjunj-u.

I penduari përgjunjet, Prifti i vë dorën mi krye dhe thotë :

Le t' i lutemi Zotit.

O Zot, Perëndî e shpëtimit të shërbëtorëve tënt, hirëplot, mëshirëmath, e zëmërgjerë, që të vien keq për punët tona të liga dhe nuk dëshëron vdekjen e mëkatarit, po përpiqesh t' a kthesh nga udha e prapë që të rrojë me të vërtetë : Rrëfê mëshirën tënde dhe mi shërbëtorin tënt dhe fal-i shëmbëll pendimi, ndiesë të mëkatave, dhe çlirim prej ç' dô të keqeje. Fal-i ç' do faj të dashur a të padashur. Pajtoj-e dhe bashkoj-e me Kishën tënde të shëntë me anën e Zotit tonë Jesu Krisht, me të cilin të ka hie ç' do lavdî, bashkë me Shpirtin tënt Jetëdhënës, tanî e përherë e në jetë të jetëve. Amen,

Zoti ynë Jesu Krisht me hirë dhe njerzidashjen e tij le të t' i ndjejë gjithë fajet, ô biri im. Dhe unë, Prift i pavyershim, me fuqinë që më ka dhënë ay të ndjej e të çliroj prej gjithë mëkatave të tua, më emërin e Atit, e të Birit, e të Shpirtit Shënt. Amen.

Dhe i bën shënjën e Kryqit mi krye.

(Sh. K. Kiô Shërbesë është shkurtuar pas Librës së Shërbesave Rusishte.)

SHËRBESA E PRËHJES

PËR TË VDEKURIN

Kur vdes nonjë, thirret PRIFTI më shtëpî dhe, si vë Petrahilë dhe temian më temianicën, nis :

E bekuar është Perëndia jonë për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

VALLEJA :

Amen.

Shënt Perëndî, Shënt i Fuqishmë, Shënt i Pavdekur, mëshirô-na. (Tri herë.)

Lavdî Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt ; tanî e përherë e në jetë të jetëve. Amen.

Trinî e Tërëshëntë, mëshirô-na. O Zot, hirësoj-i mëkatat tona. O Zot i Math, ndjej-i paudhësitë tona ; O i Shëntë, vështroj-i dhe shëroj-i sëmundjet tona për emërin tënt.

Mëshirô, ô Zot. (Tri herë.) Lavdî ; Tanî.

Ati ynë që je ndë qiell, u-shëntëroftë emëri yt ; arthte mbretëria jote ; u-bëftë dëshira jote si ndë qiell edhe mbi dhê ; bukën tonë të përditëshme epna-e neve sot edhe fal-na-i fajet, sikundër edhe neve u' a falim fajtorëve tanë ; dhe mos na shtier ndë ngasje, po shpëtô-na nga i ligu.

PRIFTI :

Se jotja është mbretëria, edhe fuqia, edhe lavdia,

e Atit, e Birit, dhe e Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

VALLEJA:

Amen.

Pastaj këtô Tropare:

TINGËLL IV.

Bashkë me shpirtet e të drejtëve të mbaruar, prëh-e, ô Shpëtimtar, shpirtin e shërbëtorit tënt, dhe ruaj-e te jeta e lumur që është pranë teje, ô njerzidashës.

Te prëhja jote, ku prëhen gjithë Shëntorët tënt, prëh-e dhe shpirtin e shërbëtorit tënt, se ti je vetëm i pavdekur.

LAVDÎ.

Ti je Perëndia që zbrite në Ferr, dhe zgjidhe dhëmbjet e të lidhurve; ti pra, ô Shpëtimtar, prëh-e dhe shpirtin e shërbëtorit tënt.

TANÎ.

O Virgjëreshë e vetëm e kulluar dhe e pa pikluar, që linde Perëndî pa-farë, nërmjetô që të shpëtohet shpirt' i shërbëtorit tënt.

PRIFTI:

Mëshirô-na, ô Perëndî, pas mëshirës s' ate së madhe, të lutemi, dëgjô e Mëshirô.

VALLEJA

Mëshirô, ô Zot. (Tri herë.)

Të lutemi dhe për prëhjen e shpirtit të shërbëtorit të Perëndisë të fietur (aksh), dhe që t' i falet ç' dô faj i dashur a i padashur.

Që t' a vëndosë Zoti Perëndia shpirtin e tij, atjê tek prëhen të drejtët. Mëshirat e Perëndisë, Mbretërin' e qiejve, dhe ndjesë të mëkatëve të tij, Krishtit Perëndisë dhe Mbretit tonë të pavdekur le t' i lypim.

VALLEJA:

Fal-i, ô Zot.

PRIFTI:

Le t' i lutemi Zotit.

O Perëndî e shpirteve dhe e ç' dô mishi, që shkele vdekjen, abolite Diallin, dhe i dhurove botës jetën; ti, ô Zot, prëh-e shpirtin e shërbëtorit tënt të fietur (aksh) në vënt të ndriçim, në vënt të lëndinëshim, në vënt rifreshkimi, ngaha ka ikur ç' do dhëmbje, hidhërim dhe psherëtim; ç' dô mëkatë që ka bërë me fialë, a me punë, a me mëndje, fal-i' a si Perëndî e mirë dhe njerzidashëse; se s' ka njerî që të rrojë dhe të mos bierë në mëkatë; se ti je vetëm pa-mëkatë; drejtësia jote është drejtësî më jetët dhe fiala jote ësht e vërteta.

Se ti je ngjallja, jeta, dhe prëhja e shërbëtorit tënt të fietur (aksh), ô Krisht Perëndia jonë, dhe ty të dërgojmë lavdî, bashkë me Atin tënt pa-nisje, dhe me Shpirtin tënt tërëshënt, të mirë, e jetëdhënës, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

LAVDI; TANI.
PËRLËSHIM.

Dhe bekon përsërî dhe nisin të këndojnë nga-dale « Shënt Perëndî. » Dhe e ngrenë lipsanë dhe e shpien në Kishë. Priftëria venë përpara dhe Diaku pas me Temianicën. Kur hyjnë në Kishë, e vënë lipsanë në mest dhe nisin thonë Psalmin :

PSALM 91.

Kush rri nënë mbulesën e të Lartit, do të ketë të ndënjurit nënë hie të Fuqimadhit. I kam për të thënë Zotit: Ti je mpshtetja ime, e kështjella ime, ô Perëndia ime; dhe m' atë kam për të shpëryer. Se ay dö t' të shpëtojë prej kurthit të gjahtorit, prej murtajës së zezë. Do t' të mbulojë me pëndët e tija, e do t' përikësh nënë fletët e tij ; e vërteta e tij është shqyt edhe mburonjë. Nuk do t' frikësohesh prej tmerrit të natës, as prej shigjetës që hidhet ditën ; as prej murtajës që ecën n' errësirë, as prej dështrojtjes që shkreton në mest të ditës. Një mijë do të bien përanë teje, e dhjetë mijë së-diathti teje ; po ty do t' mos t' afrohet. Veç me syt' e tû do t' shëkosh, e do t' shohësh çpagimin e fajtorëve. Se ti, ô Zot, je shpresa ime; të Lartin më ke bërë vënt për të ndënjur. Nuk do t' t' avitet nonjë e keqe, edhe frushkullë nuk do t' afrohet në tendën tënde. Se do t' urdhërojë ëngjëjt e tij për ty që të ruajnë ndë gjithë udhët e tua. Do t' të ngrenë mi duar, që të mos përpieksh këmbën tënde më gur. Do të bareç mi luan e mi aspikë, e do t' përshkelësh këlysh luani dhe dragua. Se shtiu dashurinë mbi mua, përandaj

do t' a çliroj ; do t' a lartësoj se njohu emërin t' im. Do t' më përthërresë e do t'a dëgjoj ; do t' i jem pranë në shtrëngim ; do t' a shpëtoj e do t' a lavdëroj. Do t' a nginj me ditë të gjata, e do t' i dëftoj shpëtimin t' im.

Pastaj këndohen këtô me zë të fortë :

STANCË I. TINGËLL TËRTHOR II.

Faqebardhët mbë udhë. Alleluia. I bekuar je, ô Zot, mësô-më të drejtat tënde. Alleluia.

Shpirti im dëshëron për mallë që kam për gjyqet e tû përherë. Alleluia.

Shpirti im po kullon prej hidhërimit ; forcô-më pas fialës s' ate. Alleluia.

Unj zëmërën t' ime nër dëshmimet e tua dhe mos ndë lakmim. Alleluia.

M' u-ndes zëmërimi për mëkatarët që kanë hequr dorë prej ligjës s' ate. Alleluia.

Unë jam shok i gjithë atyre që të kanë frikë e ruajnë porosit' e tua. Alleluia.

Lavdî Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt.

Tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Alleluia.

STANCË II. TINGËLL TËRTHOR I.

Duartë tënde më bënë e më gatuan ; bë-më të mënçim, edhe do t' mësoj urdhërimet tënde. Mëshiroj-e shërbëtorin tënt.

Sepse u-bëra posi shakulli ndë tym ; po nukë har-

rova urdhërimet e tua. Mëshiroj-e shërbëtorin tënt.

Yti jam unë, shpëtô-më, se kërkova porosit' e tua. Mëshiroj-e shërbëtorin tënt.

Nukë dolla jashtë nga gjyqet e tû, se ti më mësove. Mëshiroj-e shërbëtorin tënt.

Unja zëmërën t' ime për të bërë urdhëret e tû përherë gjer në funt. Mëshiroj-e shërbëtorin tënt.

Eshtë kohë t' i shërbejmë Zotit, se e prishnë ligjën tënde. Mëshiroj-e shërbëtorin tënt.

Lavdî, Tanî. Mëshiroj-e shërbëtorin tënt.

STANCË III. TINGËLL III.

Shtjer sytë mbi mua edhe mëshirô-më, pas gjyqit që u bën atyre që duan emërin tënt. Alleluia.

Jam i ri dhe i pazënë për gjë ; po nuk harrova porosit' e tua. Alleluia.

Dëgjoj-e zënë t' im, ô Zot, pas mëshirës s' ate, dhe ngjall-më pas gjyqit tënt. Alleluia.

Të parët më kanë ndiekur më kot, po zëmërën t' ime e mori frika për fialën tënde. Alleluia.

Rroftë shpirti im, dhe do t' të lavdërojë, edhe gjyqet e tû më ndihçin. Alleluia.

U-arratisa posi dele e humbur ; kërkoj-e shërbëtorin tënt, se nuk i harrova urdhërimet tënde. Alleluia.

Dhe me një herë thohen këtô :

TINGËLL TËRTHOR I.

I bekuar je, ô Zot, mësô-më të drejtat tënde.

Shoqëri ' e Shëntorëve gjeti burimin e jetës dhe derën e Parrajsës; do t' a gjej dhe unë udhën me anën e pendimit; unë jam deleja e humbur; thirrmë prapë, ô Shpëtimtar, dhe shpëtô-më.

I bekuar....

Ti, që më gatove që-moti nga e mos-qëna, dhe më nderove me korën tënde të perëndishme, dhe më ktheve prapë te dheu, prej të cilit më more, nga baritja e porosisë, sill-më prapë te shëmbëllsia jote, dhe përlint-m'a bukurin' e motshime.

I bekuar....

Jam kora e lavdisë s' ate së patreguar, me-gjith'-që kam pikla prej fajesh; mëshirôj-e kriatyrën tënde, ô Zot, dhe spastroj-e me dhëmpshërinë tëndë; dhe fa-m' a atdhen' e përmallshim, duke më bërë përsërî qytetar të Parrajsës.

I bekuar....

Prëh-e, ô Perëndî, shërbëtorin tënt, dhe vëndos-e në Parrajsë, ku shoqërit' e Shëntorëve, ô Zot, dhe të drejtët shkëlqejnë si yj; prëh-e shërbëtorin tënt të fiëtur, duke mos vënë-'re tërë krimërat e tij.

Lavdî. TRINISORE.

Tri-shkëlqimin e Hynisë së njëshme, le t' a hymnojmë besërisht duke thirrur: I shëntë je, ô Ât' i panisjeshim, ô Bir i bashkëpanisjeshim, dhe Shpirt' i perëndishmë; ndriçô-na ne që t' adhurojmë me besë, dhe rrëmbê-na prej ziarrit të përjetëshm.

Tanî. HYJLINDËSORE.

Gëzoh-u, ô e nderuar, që linde Perëndinë mishë-

risht për shpëtimin e të gjithëve ; me anën tënde gjindja e njerësve gjeti shpëtimin ; me anën tënde gjeçim Parrajsën, ô Hyjlindëse, e kulluar dhe e bekuar.

Alleluia, alleluia, alleluia. Lavdî ty, ô Perëndî. (Për-së-treti.)

Pastaj thohet kanuni me këtë Shkurtore.

TINGËLL TËRTHOR IV.

Bashkë me Shëntorët prëh-e, ô Krisht, shpirtin e shërbëtorit tënt, atiê tek nukë ka as dhëmbje, as helme, as psherëtim, po vetëm jetë të pambaruar.

Pastaj këtô të Vetëzëshme të JOAN DAMASHKARIT.

TINGËLL I.

Cili gëzim i jetës mbetet i papërzier me hidhërim? cila lavdî qëndron mbi dhê e paçvëndosur? të gjitha janë më të dobëta se hieja, të gjitha janë më të rreme se ëndërrat ; një çast e të gjitha këtô i nëkëmbëson vdekja. Po te drit' e faqes s' ate, dhe te ëmbëlsir' e bukurisë s' ate, ô Krisht, prëh-e atë që zgjodhe, si njerzidashës.

TINGËLL II.

Si lule fishket, dhe si ëndërr shkon, e përndahet ç' dô njerî ; dhe prapë, kur të oshëtijë trumpeta, gjithë të vdekurit, si më një bashkëtronditje, do të ngrihen që të të dalin përpara, ô Krisht Perëndî ; atëhere, ô Zoti Krisht, vëndos-e shpirtin e shërbëtorit tënt që e more prej nesh nër tendat e shëntorëve tënt.

TINGËLL III.

Kotësira janë gjithë të njerëzishmet që s' qëndrojnë pas vdekjes; nukë mbetet pasuria, nukë vete pas lavdia; se vien vdekja, dhe këtô të gjitha përpihen; përandaj le t' i thërresim Krishtit, mbretit të pavdekur: Prëh-e atë që shkoj prej nesh atiê tek është ndënjia e gjithë të dëfryerve.

TINGËLL IV.

Me të vërtetë është fort i trëmpshim myster' i vdekjes; si ndahet me pahir shpirti prej harmonisë së trupit, dhe pritet me vullnet të perëndishmë legëtyra e natyrëshme e bashkëqënjes. Përandaj të lutemi: Prëh-e të jetë-ndërruarin nër tendat e të Drejtëve tënt, ô Jetëdhënës njerzidashës.

TINGËLL TËRTHOR I.

Kujtova Profetin që thërriste: Unë jam dhê e hí; dhe hodha synë prapë nër varret, dhe pashë eshtërat e çveshura, e thashë: Kush ësht' atëhere mbret, a ushtar, a i pasur, a i varfër, a i drejtë, a mëkatar? Po prëh-e, ô Zot, shërbëtorin tënt bashkë me të drejtët.

TINGËLL TËRTHOR II.

Urdhëri yt kriesor ka qënë krej' i im dhe qënja ime; se të pëlqeu të më formosh një kriatyrë të gjallë prej natyre të dukur e të padukur, dhe m' a përgatove trupin prej dheut dhe më ke dhënë shpirt

me frymën tënde të perëndishme dhe jetëdhënëse. Përandaj, ô Krisht, prëh-e shërbëtorin tënt në vënt të gjallësh e nër tenda të drejtësh.

TINGËLL I RËNDË.

O Jetëdhënës, Shpëtimtari ynë, prëh-e vëllanë tonë që e ngrite nga jeta e përkohëshme dhe që thërret : Lavdî më ty.

TINGËLL TËRTHOR IV.

Qaj e vajtoj, kur shkoj ndër mënt vdekjen dhe shoh bukurinë tonë të gatuar pas korës së Perëndisë të shtrirë në varr të çfytyruar, të palavdishim, pa formë. O çudî ! ç' është ky myster rreth nesh ? Si qënkemi të përdhënë te prishja dhe si qënkemi të marrtuar me vdekjen? Me të vërtetë, siç është shkruar, pas urdhërit të Perëndisë, i cili i fal prëhjen të jetë-ndërruarit.

Pastaj Lumërimet dhe pas atyre :

APOSTULLI.

Qoft' e lumur udha që po baret ti sot, se të është pregatitur vënd' i prëhjes. Te ty, ô Zot Perëndia ime thirra.

Këndimi prej Letrës së Parë të Palit nër Thësalonikasit :

Vëllezër, nukë dua të mos dini për të fieturit që të mos hidhërohi, si dhe të tierët që s' kanë nonjë shpresë. Se, në besojmë se Krishti vdiq e u-ngjall,

ashtu dhe Perëndia me anën e Jesujt do t' i shpierë të vdekurit bashkë me veten e tij. Se këtë e thomi pas fialës së Zotit, që ne të gjallët që do të mbetemi gjer më ardhjen e Zotit, nuk do t' i arrijmë të fieturit ; se vetë Zoti me urdhërim, me zë krye-ëngjëlli, dhe me trumpetë Perëndie, do të zbresë prej qiellit, dhe të vdekurit do të ngjallen të parët më emërin e Krishtit ; pastaj ne të gjallët të mbeturit, do të rrëmbehemi bashkë me tâ nër retë që të piekim Zotin në erë ; dhe ashtu do të jemi bashkë me Zotin ngaherë.

Alleluia. Lum' ay që zgjodhe dhe e more, ô Zot.

UNGJILLI (PAS JOANIT).

Tha Zoti nër Judejtë që i kishin ardhur. Me të vërtetë, me të vërtetë po ju thom që, ay që dëgjon fialën t' ime, dhe beson atë që më dërgoj, ka jetë t' ameshuar ; dhe nukë vien më gjyq, po shkon prej vdekjes te jeta. Me të vërtetë, me të vërtetë po ju thom, se vien ora, dhe tanî është, që të vdekurit do t' dëgjojnë zërin e Birit të Perëndisë dhe atâ që do t' dëgjojnë do të rrojnë. Se, sikundër Ati ka jetë më vete, ashtu i dha dhe Birit të ketë jetë më vete. Dhe i dha pushtet dhe për të bërë gjyq ; se është bir njeriu ; mos u-çuditni për këtë ; se vien ora, më të cilën gjith' atâ që janë nër varret do t' dëgjojnë zërin e tij ; dhe do të venë atâ që bënë të mira më ngjallje jete ; dhe atâ që bënë të këqia më ngjallje gjykimi. Nukë munt unë të bëj gjësendi prej

vetes s' ime ; sikundër dëgjoj, gjykoj ; dhe gjykimi im ësht i drejtë ; se nuk kërkoj dëshirën t' ime, po dëshirën e Atit që më dërgoj.

DIAKU :

Mëshirô-na ô Perëndî...
Të lutemi dhe për prëhjen e shpirtit...

Dhe si mbarohet kiô, i Par' i Priftërve, a Kryeprifti, thotë Urimin : « O Perëndî e shpirteve dhe e ç' dô mishi... » pranë lipsanit.

Pastaj me zë të lartë :

Se ti je ngjallja, jeta dhe prëhja...

Pasandaj bëhet përshëndoshja e fundit dhe këndohen këtô Vargësore të Përshëmbëllta.

TINGËLL II.

Pas : « Ote ek tu ksylu ».

Eni t' i apim të vdekurit përshëndoshjen e fundit, ô vëllezër, duke përhiruar Zotin ; se ky u-nda nga gjirij' e tij, dhe nxitohet për në varr, dhe s' përkujdeset më për kotësirat dhe mishin e mundimshim ; ku janë tanî gjirinjtë dhe miqtë ? tanî po ndahemi nga ky, për të cilin le të lutemi t'a prëhë Zoti.

Ç' është kiô ndarje, ô vëllezër ? ç' është kiô qarje, e ky vajtim më çastin e tanishmë ; eni pra të përshëndoshni atë që ish pak më parë me ne ; se përipet në varr, mbulohet me gur, vëndoset më t' errët, varroset bashkë me të vdekurit: të gjithë gjirinj e

m'q, tanî po ndahemi nga ky, për të cilin le të lutemi t' a prëhë Zoti.

Tanî përndahet gjithë panair' i prapë i kotësisë së jetës : se shpirti shkoj nga tendësimi ; balta është nxirë, ena u-ça, pa-zë, pa-ndienjë, e vdekur, e palëvizur, të cilin duke e përciellë më varr, le t' i lutemi Zotit t' í apë prëhjen më jetët.

Si është kiô jeta jonë? si lule, si avull, si ves' e mëngjezit me të vërtetë : Eni pra të hedhim një sy mi varret me gjithë fuqí ; ku është bukuri' e trupit ? ku është risia ? ku janë sytë dhe forma e mishit ? të gjitha u-fishknë si bar, të gjitha u-venitnë ; eni pra t' i biem Krishtit nër këmbë me lot.

Qarje e madhe dhe vajtim, psherëtim i math, dhe shtrëngim është ndarja e shpirtit ; Ferr dhe humbje është jeta e përkohëshme, hieja e paqënë, gjum' i rrejtjes, mundimi i kottë i jetës së dheut, le të i-kim lark ç' do mëkate të botës, që të trashëgojmë lumëritë qiellore.

HYJLINDËSORE.

Shpëtô atâ që shpresojnë më ty, ô Mëm' e Diellit të paperënduar Hyjlindëse ; lutni Fortmirit t' a prëhë me nërmjetimet e tua atë që ndrroj jetë tanî atiê tek prëhen shpirtet e të Drejtëve ; rrëfej-e trashëgimtar të të mirave të perëndishme nër hoboret e të Drejtëve, për kujtim të përjetëshm, ô e kulluar.

Lavdî. TINGËLL TRËTHOR II.

Duke më parë të shtrirë pa-zë e pa-frymë, përpara jush, qani të gjithë mbi mua, ô vëllezër dhe miq,

gjirinj e të njohur ; se ditën e dieshme bashkë me ju po flisja, dhe me një herë më erdhi mi krye ora e vdekjes. Po eni të gjithë atâ që më kini mall, dhe përshëndoshmëni përshëndoshjen e fundit; se do t' mos bares më bashkë me ju, as që do të flasim bashkë që tanî e tutje ; se shkoj te gjykatësi, ku s' ka hatër ; se robi dhe zoti qëndrojnë bashkë përpara, mbreti dhe ushtari, i pasuri dhe i varfëri më një radhë ; se cilido pas punët e tij, a do t' lavdërohet, a do t' turpërohet : Po ju lyp të gjithëve dhe ju lutem, pa pushuar t' i luti për mua Krishtit Perëndisë, që të mos vëndosem pas mëkatave të mia te vënd' i mundimit, po të më vëndosë atiê ku është drit' e jetës.

Tanî. HYJLINDËSORE.

Me nërmjetimet e asaj që të lindi, ô Krisht, dhe të Parërendësit tënt, t' Apostujve, të Profetëve, të Kryepriftërve, t' Oshënarëve, të Drejtëve, dhe të gjithë Shëntorëve, prëh-e shërbëtorin tënt të fietur.

Pastaj PËRLËSHIMI :

Krishti, Perëndia jonë e vërtetë, që u-ngjall së vdekurësh, me nërmjetimet e Zonjës s' onë Hyjlindëse Shën-Marî, t' Apostujve të shëntë, të lavdëruar dhe emër-shkëlqyer, t' Atërve tanë oshënarë dhe hyjprurës, dhe të gjithë shëntorëve, e vëndostë shpirtin e shërbëtorit të tij të jetëndërruar më tenda të Drejtësh, e prëhtë nër gjinjët e Abraamit, dhe e

nëmëroftë bashkë me të drejtët, dhe neve na mëshiroftë, si i mirë dhe njerzidashës.

I përjetëshm qoftë kujtimi yt, ô vëllai ynë i lumëruarshim dhe i përkujtuarshim. (Tri herë).

Pastaj e ngrenë lipsanë dhe shkojnë nër varret, duke kënduar « Shënt Perëndî ».

Kur vihet lipsani në varr, PRIFTI merr dhê me lopatën dhe e heth mi lipsanë kryqthi, duke thënë :

I Zotit është dheu dhe rrafshëri' e tij, gjithësia, dhe gjith' atâ që rrinë mi të.

Pastaj derth vaj dhe verë, a hin' e Temianicës. Pastaj e mbulojnë, duke kënduar pas zakonit Troparet « Bashkë me shpirtet e të Drejtëve... » dhe Përlëshim.

Lavdî Perëndisë që urdhëroj kështu.

Duhet ditur që kiô Shërbesë bëhet dhe për gratë e për diemt' e Orthodoxëve, veç që ndërrohet emëri më femër a më mashkull.

BKGH

SHËRBES' E BEKIMIT TË VOGËL TË UJIT

PRIFTI nis :

E bekuar është Perëndia jonë për gjithmonë, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Mbret qiellor, Ngushëllimtar, Shpirt' i së vërtetës, që ndodhesh kudo dhe mbush të gjitha, thesar' i të mirave dhe falësi i jetës, eja dhe tendësô nër ne dhe spastrô-na prej ç' dô pikle.

Shënt Perëndî...

Trinî e Tërëshëntë...

Ati ynë...

Se jotja është mbretëria...

Pastaj Psalmi 143 : « O Zot, dëgjô të folurit t' im ». — Shëkô nër 6 Psalmet. Pastaj :

Perëndia është Zoti dhe u-çfaq nër ne ; i bekuar ësht ay që vien më emërin e Zotit. (4 herë.)

Dhe thohen këtô Tropare :

TINGËLL IV.

Hyjlindëses le t' i rendim pranë tanî me gjithë zëmër ne mëkatarët, e të përunjur le t' i biem nër këmbë, duke thirrur me pendim thellazi prej shpirtit : O Zonjë, ndihmô-na, e dhëmpshëroh-u për ne ; shpejtô, se humbasim prej shumice fajesh. Mos i

kthê prapë shërbëtorët e tû të zbrazët ; se ty të kemi të vetëmën shpresë.

Lavdî ; Tanî.

Nuk do t' pushojmë kurrë, ô Hyjlindëse, së foluri për fuqit' e tua ne të pavyerit; se, po të mos na mpronje ti, duke nërmjetuar, kush do t' na shpëtonte prej kaqë rezikësh ; dhe cili do t' na ruante gjer më tanî të lirë ? Nuk do t' largohemi prej teje, ô Zonjë ; se ti shpëton përherë shërbëtorët e tû prej çfarëdo tmerresh.

Pastaj Psalm 51.

Përdëllyes, përdëllê-më, ô Perëndî...

(Shëkô në Mëngjes.)

Pastaj këndohen Troparet e Kanunit.

Pasandaj PRIFTI :

Se i Shëntë je, ô Perëndia jonë, dhe ty të dërgojmë lavdî, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Tropare. TINGËLL TËRTHOR II.

Tanî erdhi koha që i shëntëron të gjithë, dhe na pret Gjykatësi i drejtë ; po ktheh-u, ô shpirt, më pendim, si e Përdalmja që thërriste me lot : O Zot, mëshirô-më.

Duke derdhur si shi me lumënj burimin e shërimeve, ô Krisht, te Kisha e nderuar e Virgjëreshës sot, ndoqe sëmundjet e të sëmurëve me spërkatjen e bekimit tënt, ô mieku i shpirteve dhe i trupeve tona.

Virgjëreshë linde e pamarrtuar, Virgjëreshë mbete, ô Nën' e panusëruar, Hyjlindëse Marî ; lutni Krishtit Perëndisë s' onë të na shpëtojë.

Hyjlindëse Virgjëreshë e Tërëshëntë, drejtësoj-i veprat e duarve tona, dhe lyp ndiesën e fajeve tona, tanî që pô këndojmë hymnin e Engjëjve.

Shënt Perëndî, Shënt i Fuqishmë, Shënt i Pavdekur, mëshirô-na... etj.

APOSTULLI.

Zoti është ndriçimi im dhe Shpëtimtari im. Zoti është mprojtësi i jetës s' ime.

Këndimi prej Letrës së Palit nër Hebrejtë :

Vëllezër, ay që shëntëron dhe atâ që shëntërohen janë prej njëj, për atë shkak nuk i vien turp t' i quaj vëllezër, duke thënë : Do t' lajmëroj emërin tënt nër vëllezërit e mî, në mes të Kishës do t' të hymnoj. Dhe prapë : Unë do të kem besim te ay. Dhe prapë : Ja unë edhe diemtë që më dha Perëndia. Dhe me-qënë-që diemtë piesëtojnë prej mishi dhe prej gjaku, dhe ay përafërisht piesëtoj prej syresh, që me anën e vdekjes t' abolitë atë që ka pushtetin e vdekjes, do-me-thënë Diallin ; dhe t' i çlirojë atâ që ishin fajtorë robërie për tërë jetën e tyre nga frik' e vdekjes. Se nukë merr natyrë prej Engjëjsh, po prej farës së Abraamit. Përandaj detyronte t' u shëmbëllente vëllezërve më të gjitha, që të bëhet Kryeprift mëshirëplot dhe besnik më punët e Perëndisë, që t' i hirësojë mëkatat e popullit ; se

nga që pësoj dhe u-nga vetë, munt t' u ndihmojë të ngarëve.

Alleluia, alleluia, alleluia.

UNGJILLI (Pas Joanit).

M' atë kohë, u-ngjit Jesuj ndë Jerusalem. Dhe është në Jerusalem një liqen pranë Tregut të Dhënve, që quhet Hebraisht Bethesda, dhe që ka pesë kamare. Nër atô ish shtrirë shumic' e madhe prej të sëmurësh, të verbërish, të çalësh, të fishkurësh, që prisnin lëvizjen e ujit. Se Engjëll zbriste më një kohë në liqen dhe turbullonte ujën; dhe i pari që hynte pas turbullimit të ujit bëhej i shëndoshë prej çfarëdô sëmundjeje që të kishte.

DIAKU me një herë thotë Paqësorẹt :

Më paqje le t' i lutemi Zotit.
Për paqjen që-lartazi...
Për paqjen e tërë botës...
Për këtë Shtëpi të shëntë...
Për Kryepeshkopin...
Për Presidentin...
Për këtë qytet...
Për temperim të mirë...
Për atâ që lundrëzojnë...

Që të shëntërohet kiô ujë me fuqinë, vepërimin, dhe përmiardhjen e Shpirtit Shënt, le t' i lutemi Zotit.

Që të vinjë mi këtë ujë vepërimi paqësor i Trinisë së përmiqënëshme, le t' i lutemi Zotit.

Që të bëhet kiô ujë shërim shpirtesh e trupesh, dhe largim ç' dô fuqie kundrështare, le t' i lutemi Zotit.

Që të dërgohet mi të hir' i çpërblimit, dhe bekim' i Jordanit, le t' i lutemi Zotit.

Për gjith' atâ që kanë nevojë për ndihmën dhe përkrahjen e Perëndise, le t' i lutemi Zotit.

Që të ndriçohemi me ndriçimin e kupëtimit, me anën e Trinisë së bashkëqënurshme, le t' i lutemi Zotit.

Që të na bëjë Zoti Perëndia jonë bij dhe trashëgimtarë të Mbretërisë së tij, duke piesëtuar e duke u-spërkatur me këtë ujë, le t' i lutemi Zotit.

Që të na shpëtojë prej ç' do hidhërimi...

Përkrah-na, shpëtô-na....

Tëreshënten, të pacinuarën....

PRIFTI me zë të lartë:

Se ty të kahie ç' dô lavdí, nder, e adhurim, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve. Amen.

Pastaj thotë këtë Urim:

Le t' i lutemi Zotit.

O Zot, Perëndia jonë, i madhi në këshillë dhe i çuditshimi nër veprat, krijetar' i kriesës së dukur e së padukur; që ruan testamentin tënt dhe mëshi-

rën tënde mi atâ që të duan dhe mbajnë urdhërimet e tua ; që pret lott' e mëshirëshme t' atyre që ndodhen më shtrëngim ; se përandaj erdhe me fytyrë robi, jo që të na frikësosh me hiera, po nga që dëshëronje shëndet të vërtetë për trupin, duke thënë : Shëkô, u-bëre i shëndoshë, mos mëkatô më ; dhe me baltë shërove sy, dhe duke e urdhëruar t' i lajë, e pregatite me fialë të rrijë në dritë ; ti që trubullon tallazet e pasioneve kundrështare, dhe zbute detin e kripur të kësaj jete, dhe valat e rënda të dëfrimeve. Ti, ô Mbret njerzidashës, që na dhe të veshim stolî të ndriçime si dëborë prej uji dhe prej shpirti, dërgô-na me piesëtimin dhe spërkatjen e këtij uji bekimin tënt, që shpërlan ndyrësin' e pasioneve. Po, të lutemi : Vështroj-e, ô i Mirë, dobësinë tonë, dhe shërô-na'i sëmundjet e shpirtit dhe të trupit, me mëshirën tënde, me nërmjetimet e Zonjës s' onë së kulluar Hyjlindëses dhe gjithmon-virgjërës Marî ; me fuqin' e kryqit të çëmuar dhe jetëdhënës ; me mprojtjet e Fuqive qiellore të nderuara ; të ndershimit, të lavdëruarit Profet, Parërendës dhe Pagëzor Joan ; t' Apostujve të shëntë, të lavdëruar, dhe emër-shkëlqyer ; t' Atërve tanë ohënarë dhe hyjprurës ; t' Atërve tanë nërmjet Shëntorët, Kryepriftërve të mëdhej dhe Mësonjësve Ekumenikë, Basilit të Math, Gregorit Theolog, dhe Joan Gojartit ; t' Atërve tanë nërmjet Shëntorët, Athanas dhe Qyrill, Patrikë të Skënderisë ; t' Atit tonë nërmjet Shëntorët Spyridon peshkopit të Trimy-

thuntës, çudibërësit ; t' Atit tonë nërmjet Shën-torët Nikoll, peshkopit të Myrave të Lyqisë, çudibërësit ; të Dëshmorit të math të lavdëruar Shën-Gjergj Tropeprurësit ; të Dëshmorit të Math të lavdëruar Shën-Mitër Myrobletit ; të Hyjprindër-ve të shëntë e të drejtë Joaqim dhe Anna, të Anar-gjëndëve të shëntë, të lavdëruar dhe çudibërës, Kos-ma dhe Damian, Qyr e Joan, Pantelimon dhe Her-mola, Samson e Diomed, Moq e Aniqet, Thalele e Tryfon ; të Shënt (aksh) që po lusim sot, dhe të gji-thë Shëntorëve tënt. Dhe ruaj-i, ô Zot, shërbëtorët e tû, dhe Presidentin tonë (a po Mbretin,— *Trihersë*), fal'u shëndet shpirti dhe trupi, dhe rrëfeh-u i butë për këtë qytet të krishterësh, që po të shërben. Kujtô, ô Zot, ç' dô peshkopi Orthodoxësh, që presin drej-tërisht fialën e së vërtetës s' ate, dhe ç' dô urdhër priftëror dhe kllogjëror, dhe shpëtimin e tyre. Kuj-tô, ô Zot, atâ që na duan e na urrejnë ; vëllezërit tanë që shërbejnë, atâ që rrinë rrotull, dhe atâ që s' ndhodhen për shkake t' arësyshme, dhe atâ që na porositnë ne të pavyerit të lutemi për tâ. Kujtô, ô Zot, dhe vëllezërit tanë që ndodhen në robërî e nër hidhërime, dhe mëshiroj-i pas mëshirës s' ate së madhe, duke i shpëtuar prej ç' dô nevoje.

Se ti je burim' i shërimeve, ô Krisht Perëndi, dhe ty të dërgojmë lavdî, bashkë me Atin tënt pa-nisje, dhe shpirtin tënt tëreshënt, të mirë dhe jetëdhënës, tani e përherë, e në jetë të jetëve.

Amen.

Paqje mi ju të gjithë.
Krerët tuaja unjiani Zotit.

Dhe thotë këtë Urim fshehtazi :

Unj, ô Zot, veshin tënt, dhe dëgjô-na ne ti që dignove të pagëzohesh në Jordan, dhe shëntërove ujërat ; dhe bekô-na të gjithë ne që po të rrëfejmë se jemi robërit tënt duke unjur xverqet tona ; dhe vlerësô-na të rrafshohemi prej bekimit tënt, me piesëtimin dhe spërkatjen e këtî uji ; e na u-bëftë, ô Zot, për shërim shpirti dhe trupi.

PRIFTI me zë të lartë :

Se ti je shëntërimi ynë, dhe ty të dërgojme lavdî, për hirim, e adhurim, bashkë me Atin tënt pa-nisjc, dhe me Shpirtin tënt jetëdhënës, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.
Amen.

Pastaj merr Kryqin e çëmuar, bekon ujën për-së-treti, duke e zhytur e duke e ngritur, e duke kënduar :

O Zot, shpëtô popullin tënt dhe bekoj-e trashëgimin tënt ; dhuroj'u besëmirëve mundje kundër barbarëve, dhe ruaj-e Shtetin tënt me anën e Kryqit tënt. (Tri herë.)

Pastaj, duke spërkatur kryqthi, thotë këtë Tropar :

TINGËLL II.

Bë-na të vyer për dhuratat tënde, ô Virgjëreshë

Hyjlindëse; pa vënë 're fajet tona dhe fal'u shërim atyre që presin bekimin tënt me besë, ô e Kulluar.

Pastaj Prifti e puth Kryqin dhe gjithë populli dhe i spërkat të gjithë.

VALLEJA këndon këtë Tropar :

TINGËLL IV.

Duke patur burim shërimesh, ô Shënt Anargjëndë, dhuroni shërime tërë atyre që ju luten, si të vlerësuar për dhurata të mëdha prej burimit t' ameshuar të Shpëtimtarit tonë ; se Zoti ju thotë, si të bashkëzellshmë me Apostujtë : Ja tek ju kam dhënë pushtet kundër shpirtesh të ndyrë, që t' i nxirni, e të shëroni ç' dô sëmundje e ç' dô dobësî. Përandaj, duke u-siellë mirë pas urdhërimet e tij, darovisht muartë, darovisht i epni, duke shëruar pasionet e shpirteve dhe të trupeve tona.

Lavdí Atit...

Unj-u nër lutjet e shërbëtorëve tënt, ô e Kulluar, duke pushuar kryengritjet e tmerreve tona, e duke na çliruar prej ç' dô hidhërimi ; se ty vetëm kemi ankurë të shigurtë e të palajthitur, dhe kemi patur mprojtjen tënde. Mos u-turpërofshim, ô Zonjë, duke t' u-lutur ; shpejtô në lutjen e atyre që të thërresin me besë ; gëzoh-u, ô Zonjë, ndihma e të gjithëve, gëzimi, mburonja dhe shpëtim' i shpirteve tona.

Tanî...

O Zonjë, prit lutjet e shërbëtorëve tënt, dhe çpërblê-na prej ç' dô shtrëngimi dhe helmi.

DIAKU :

Mëshirô-na, ô Perëndî...

Të lutemi dhe për mëshirë, jetë,...

PRIFTI :

Dëgjô-na, ô Perëndî, Shpëtimtari ynë, shpresa e gjithë anëve të dheut dhe t' atyre që ndodhen nër detet lark ; dhe i hirëshim, i hirëshim rrëfeh-u, ô Zot i Math, për mëkatat tona dhe mëshirô-na.

Se ti je Perëndî mëshirëplote dhe njerzidashëse, dhe ty të dërgojmë lavdî, Atit, e Birit, edhe Shpirtit Shënt, tanî e përherë, e në jetë të jetëve.

Paqje mi ju të gjithë.

Krerët tanë le t' i'a unjim Zotit.

URIM.

O Zot mëshirëplot, Zoti Jesu Krisht, Perëndia jonë, me nërmjetimet e Zonjës s' onë së Pacinuar Hyjlindëses dhe gjithmon-virgjërës Marî ; me fuqin' e Kryqit të çëmuar dhe jetëdhënës ; me mprojtjet e Fuqive qiellore të nderuara ; të nderçimit dhe të lavdëruarit Profet, Parërendës, dhe Pagëzor Joan ; të Dëshmorëve të shëntë, të lavdëruar, dhe bukurmundës ; t' Atërve tanë oshënarë dhe hyjprurës ; të Hyjprindërve të shëntë e të drejtë Joaqim dhe Anna, dhe të gjithë Shëntorëve tënt ; prit-e mirë lutjen tonë ; dhurô-na ndjesën e fajeve tona ; mbulô-na nënë hien e krahëve tënt ; dbô prej nesh ç' do armik dhe kundrështar ; paqësô-na-e jetën O Zot, mëshirô-na ne dhe botën tënde, dhe shpëtoj-i shpirtet tona, si i mirë dhe njerzidashës.

PËRLËSHIM.

HYMNE TË NGJALLJES

MË TETË TINGËJTË

PREJ

LUTJESORES

VARGËZIME NGJALLJESORE TË THIRRTOREVE

TINGËLL I.

Lutjet tona të mbrëmëshme prit-i, ô Zot i Shëntë, dhe fal-na ndiesë mëkatash ; se ti je i vetëmi që rrëfeve në botë ngjalljen.

Rrethoni Sionë, ô popuj, dhe vëreni në mest dhe epini lavdî në të atî që u-ngjall prej së vdekurësh ; se ay është Perëndia jonë, që na çpërbleu nga paligjësitë tona

Eni, ô popuj, të hymnojmë e t' i falemi Krishtit, duke lavdëruar Ngjalljen prej së vdekurësh ; se ay është Perëndia jonë që çpërbleu botën prej rrejtjes s' armikut.

Dëfreni qiej, buçisni themelit' e dheut, klithni, ju male, me ngazëllim. Se ja Emmanueli mbërtheu në Kryq mëkatat tona, dhe vrau vdekjen ay që fal jetë, duke ngjallur Adamin, si njerzidashës.

Hyjlindësore.

Lavdin' e përbotëshme, që u-mbuall prej njerëzish dhe lindi Zotin, derën qiellore, Marinë Virgjëreshën le të hymnojmë, këngën e Engjëjve dhe zbukurimin e besnikëve. Se ajô u-rrëfye qiell dhe tempull i Hynisë. Ajô, duke dështruar murin e armiqësisë, kalli paqjen në vënt të saj dhe çeli mbretërinë. Duke patur pra këtë si ankurë të Besës, kemi për luftar atë që lindi prej saj. Le të ketë pra kurajë, le të ketë kurajë populi' i Perëndise; se ay do t' i luftojë armiqtë si i Tërëfuqishim.

Përlëshore dhe Hyjlindësore.

Guri kur u-shilua prej Judejve dhe ushtarët ruanin Trupin tënt të pacinuar, u-ngjalle pas tri ditsh, Shpëtimtar, duke i dhuruar botës jetën. Përandaj Fuqit' e Qiejve të thërrisnin, Jetëdhënës : Lavdî ngjalljes s' ate, ô Krisht; lavdî mbretërisë s' ate, lavdî ekonomisë s' ate, i vetëm njerzidashës.

Gabrieli kur të tha, Virgjëreshë, « Gëzoh-u », bashkë me zërin mishërohej Zot' i gjithësisë te ty Arka e shëntë, siç tha Davidi i drejtë. U-rrëfeve më e gjerë se Qiejtë, duke mbajtur Krijetarin tënt. Lavdî atî që ndënji te ty; lavdî atî që lindi prej teje; lavdî atí që na çliroj me lindjen tënde.

Vargëzime Ngjalljesore të Lavdërimeve.

Hymnojmë, ô Krisht, Pësimin tënt shpëtimtar dhe lavdërojmë Ngjalljen tënde.

O Zot, që durove Kryq dhe abolite vdekjen, dhe u-ngjalle së vdekurësh, paqësô-na-e jetën, si i vetëm i tërëfuqishim.

O Krisht, që plaçkove Ferrin, dhe ngjalle njerinë me Ngjalljen tënde, vlerësô-na të të hymnojmë e të të këndojmë me zëmrë të paqme.

Duke lavdëruar dignimin tënt të Perëndishmë, të hymnojmë, ô Krisht; linde prej Virgjëreshës dhe ishe i pandarë nga Ati; pësove si njerî dhe, duke dashur, durove Kryq; u-ngrite prej Varrit si prej nusëroreje që të shpëtosh botën; ô Zot, lavdî më ty.

TINGËLL II.

Vargëzime Ngjalljesore të Thirrtoreve.

Eni t' i falemi atî që lindi prej Atit para jetëve, Fialës Perëndî që u-mishërua prej Virgjëreshës Marí: Se, siç duroj Kryq, u-përdha te varrimi, sikundër deshi vetë: Dhe, si u-ngjall së vdekurësh, më shpëtoj mua njerin' e arratisur.

Krishti, Shpëtimtari ynë, shuajti sentencën e shkruar kundër nesh, duke e mbërthyer më Kryq, dhe aboliti pushtetin e vdekjes. Adhurojmë Ngjalljen e tij të triditëshme.

Bashkë me Krye-ëngjëjtë le të hymnojmë Ngjalljen e Krishtit; se ay është çpërblenjësi dhe Shpëtimtari i shpirteve tona; dhe me lavdî të trëmpshime e me fuqî të pushtetëshme prapë vien të gjukojë botën që gatoj.

Ty që u-kryqësove dhe u-varrose Engjëlli të lëçiti Zot dhe u thoshte grave : Eni të shëkoni ku ndodhej Zoti ; se u-ngjall, sikundër tha, si i tërëfuqishmë. Përandaj të falemi ty, të vetëmit të pavdekur, ô Jetëdhënës Krisht, mëshirô-na.

Hyjlindësore.

Shkoj hieja e ligjës, siç erdhi hiri. Se, sikundër ferra nukë digjej, me-gjithë-që nxirte flagë, ashtu dhe ti Virgjëreshë linde dhe Virgjëreshë mbete ; në vënt kollone ziarri, lindi diell drejtësie ; në vënt të Moisiut, Krishti, shpëtim' i shpirteve tona.

Përlëshore dhe Hyjlindësore.

Kur zbrite te vdekja, ti, ô jeta e pavdekur, atëhere Ferrin e vdiqe me shkëlqimin e Hynisë ; dhe, kur ngrite të vdekurit nga fundet e dheut, tërë Fuqitë qiellore të thërrisnin : Jetëdhënës Krisht, Perëndia jonë, lavdî më ty.

Të gjitha përmi mejtim, të gjitha të përmilavdishime mysteret e tua, ô Hyjlindëse ; e shiluar me kullim dhe e ruajtur me virgjërî, u-njohe Mëm' e vërtetë, duke lindur Perëndin' e vërtetë. Atî i' u-lut të shpëtohen shpirtet tona.

Vargëzime Ngjalljesore të Lavdërimeve.

Ç' do frymë dhe ç' dô Kriesë ty të lavdëron, ô Zot, se me anën e Kryqit abolite vdekjen, që t' u

rrëfesh popujve Ngjalljen tënde prej së vdekurësh, si i vetëm njerzidashës.

Le të thonë Judejtë si ushtarët e humpnë, kur e ruanin Mbretin; përse guri nuk e ruajti gurin e jetës? ose t' apin të varrosurin, ose t' i falen të ngjallurit, duke thënë bashkë me ne : Lavdî shumicës së dhëmpshërive tënde, ô Shpëtimtari yne, lavdî më ty.

Gëzohuni, popuj, dhe ngazëllohuni; Engjëlli ndënji mi gurin e varrit; ay na mirëlajmëroj, duke thënë : Krishti u-ngjall prej së vdekurësh, Shpëtimtar' i botës, dhe i mbushi të gjitha me erë lulesh. Gëzohuni, popuj, dhe ngazëllohuni.

Engjëll, ô Zot, i solli Hirëplotes përshëndoshjen « Gëzohu » para zënjes s' ate ; Engjëll rrugullizi dhe gurin e varrit tënt të lavdëruar më Ngjalljen tënde. Njëri, duke lajmëruar symbole ngazëllimi në vënt të helmit ; tiatëri, duke na lëçitur Zotin jetëdhënës në vënt të vdekjes. Përandaj po të thërresim: ô Zot, mirëbërës i të gjithëve, lavdî më ty.

TINGËLL III.

Vargëzime Ngjalljesore të Thirrtoreve.

Me anën e Kryqit tënt, ô Krisht Shpëtimtar, u-përndâ pushtet' i vdekjes, dhe rrejtja e Diallit u-abolit. Dhe gjindja e njerësve, që shpëtohet me besë, hymnë për dita të 'blaton.

U-ndriçuan të gjitha me Ngjalljen tënde, ô Zot,

Parrajsa u-çel përsëri; dhe tërë Kriesa, duke të lëvduar, hymnë për dita të 'blaton.

Lavdëroj fuqin' e Atit e të Birit, dhe hymnoj pushtetin e Shpirtit Shënt, Hynin' e pandarë dhe të pakrijuar, Trinin' e bashkëqënurshme, që mbretëron më jetë të jetës.

Kryqin tënt të çëmuar adhurojmë, ô Krisht, dhe Ngjalljen tënde hymnojmë e lavdërojmë; se me plagën tënde ne të gjithë u-shëruam.

Hyjlindësore.

Si të mos çuditemi për lindjen tënde të hyjnjerishme, ô e Nderuarë? Se pa njohur burrë, ô e Kulluarë, linde Bir pa âtë trupërisht atë që lindi prej Atit para jetëve pa mëmë, i cili s' pësoj fare ndryshim, a trazim, a ndarje, po ruajti të fieshttë cilësin' e cilësdo qënjeje. Përandaj, o Zonjë mëmë-virgjëreshë, lut-i' u atí të shpëtohen shpirtet e atyre që të njohin me besë të drejtë Hyjlindëse.

Përlëshore dhe Hyjlindësore.

Le të dëfrejnë Qielloret, le të ngazëllohen të dheshmet, se rrëfeu fuqí me krahun e tij Zoti; shkeli vdekjen me vdekje, u-bë i parëlindur' i të vdekurve, prej barkut të Ferrit neve na shpëtoj dhe i fali botës përdëllimin e math.

Ty, që nërmjetove për shpëtimin e gjindjes s' onë të përhymnojmë, ô Hyjlindëse Virgjëreshë; se, duke dignuar Pësimin e Kryqit me trupin që mori prej

teje Biri yt' dhe Perëndia jonë, na çpërbleu prej prishjes, si njerzidashës.

Vargëzime Ngjalljesore të Lavdërimeve.

Eni gjithë kombet njihni fuqin' e mysterit të trëmpshim. Se Krishti, Shpëtimtari ynë, Fiala e kryes, u-kryqësua për ne, dhe, duke dashur, u-varros dhe u-ngjall së vdekurësh që të shpëtojë të gjitha. Atî le t' i falemi.

I rrëfyen gjithë çudirat ruajtësit e tû, ô Zot ; po kështilla e kotësisë, si mbushi me dhurata të diathtën e tyre, pandehte se fshihte Ngjalljen tënde, që e lavdëron Bota. Mëshirô-na.

Të gjitha u-mbushnë me gas, kur muarrë lajmen e Ngjalljes. Se Maria Magdalena erdhi më varrt, gjeti një Engjëll që rrinte mi gur që i shkëlqenin robat e i tha : Si kerkoni të gjallin me të vdekurit ? s' është këtu, po u-ngrit, siç tha, dhe ju pret në Galilê.

Me dritën tënde, ô Zot, do t' shikojmë dritë, ô njerzidashës ; se u-ngjalle së vdekurësh, duke i dhuruar shpëtim gjindjes së njerësve, që të të lavdërojë gjithë Kriesa ty të vetëmin të pamëkatëshm. Mëshirô-na.

TINGËLL IV.

Vargëzime Ngjalljesore të Thirrtoreve.

Duke adhuruar Kryqin tënt jetëdhënës pa pushuar, ô Krisht Perëndî, lavdërojmë Ngjalljen tënde

të triditëshme ; se me atë përsërite natyrën e përprishur të njerësve, ô i Tërëfuqishim, dhe na tregove ngjitjen nër Qiejtë, si i vetëm i mire dhe njerzidashës.

Mallkimin e çdëgjimit të drurit e zgjidhe, ô Shpëtimtar, duke u-mbërthyer vullnetarisht më drurin e Kryqit, dhe, duke zbritur në Ferr, ô i Fortë, dërmove vargojt' e vdekjes si Perëndî. Përandaj i falemi Ngjalljes s' ate prej së vdekurësh, duke thirrur me ngazëllim : ô Zot i tërëfuqishim, lavdî më ty.

I dërmove dyert' e Ferrit, ô Zot, dhe me vdekjen tënde e përndave mbretërin' e vdekjes ; dhe gjindjen e njerësve e çlirove prej prishjes, duke i dhuruar Botës jetë dhe paprishje dhe përdëllimin e math.

Eni të përhymnojmë, ô popuj, ngritjen e triditëshme të Shpëtimtarit, me anën e së cilës u-çpërblyem nga vargojt' e pazgjidhur të Ferrit, dhe muarmë të gjithë jetë dhe paprishje, duke thirrur : Ti që u-kryqësove, e u-varrose, e u-ngjalle, shpëtôna me Ngjalljen tënde, ô i vetëm njerzidashës.

Hyjlindësore.

Profeti David që u-bë Hyjprint me anën tënde i parëthirri me melodî për ty atî që të madhështoj ; qëndroj Mbretëresha më të diathtë tënt ; Se Perëndia, që dignoj të bëhet njerî prej teje pa âtë, të rrëfeu Mëmë shkakësore të jetës, që të gatojë përsëri ko-

rën e tij, të prishur prej pasioneve, dhe, duke gjetur delen e arratisur nëpër malet, t' a marrë mi supet e t' i a shpierë Atit, dhe me dëshirën e tij t' a bashkojë me Fuqitë qiellore, dhe t' a shpëtojë botën, ô Hyjlindëse, Krishti që ka përdëllimin e math e të pasur.

Përlëshore dhe Hyjlindësore.

Lëçitjen gazmore të Ngjalljes, kur mësuan prej Engjëllit Nxënëset e Zotit, dhe hodhë dënimin prindëror, duke u-mburur, u thoshnin Apostjuve : U-kusarua vdekja, u-ngrit Krishti Perëndî dhe i dhuroj botës përdëllimin e math.

Mysteri i fshehur prej jete dhe i panjohur nër Engjëjtë u-çfaq nër të dheshmit me anën tënde, ô Hyjlindëse ; Perëndia, që u-mishërua më bashkim të papërzierë, dhe dignoj Kryq për ne, duke dashur: me të cilin ngjalli të Parëgatuarin, dhe shpëtoj prej vdekjes shpirtet tona.

Vargëzime Ngjalljesore të Lavdërimeve.

O Zot i Tërëfuqishim, që durove kryq e vdekje dhe u-ngjalle prej së vdekurësh, lavdërojmë Ngjalljen tënde.

Me kryqin tënt, ô Krisht, na çlirove prej mallkimit të motshim, dhe me vdekjen tënde abolite Diallin që shtyranoj natyrën tonë ; dhe me Ngjalljen tënde i mbushe të gjitha me gas. Përandaj po të thërresim : O Zot, që u-ngjalle së vdekurësh, lavdî më ty.

Me kryqin tënt, ô Krisht Shpëtimtar, hiq-na udhën mi të vërtetën tënde dhe shpëtô-na nga leqet e armikut; ti, që u-ngjalle së vdekurësh, ngjall-na ne që ramë nga mëkata, duke ndehur dorën tënde, ô-Zot njerzidashës, me nërmjetimin e Shëntorëve tënt.

Pa u-ndarë nga gjiri yt prindëror, ô Fial' e Vetëmlindur' e Perëndisë, erdhe mi dhê nga njerzidashja, duke u-bërë njerî pa ndryshuar, dhe durove kryq e vdekje trupërisht ti i papësuari pas Hynisë; dhe, si u-ngjalle së vdekurësh, i fale gjindjes së njerësve pavdekjen, si i vetëm i tërëfuqishim.

TINGËLL TËRTHOR I.

Vargëzime Ngjalljesore të Thirrtoreve.

Me kryqin tënt të çëmuar, ô Krisht, turpërove Diallin dhe me Ngjalljen tënde e theve bodecin e mëkatës, dhe na shpëtove nga dyert' e vdekjes. Të lavdërojmë, ô i Vetëmlindur.

Ay, që i ep Ngjalljen gjindjes së njerësve, u-hoq më therrje si dele U-tmerruan prej tij krerët e Ferrit dhe u-çelë dyert' e helmuara. Se hyri Krishti, Mbret' i lavdise, duke u thënë të burgosurve: Dilni; dhe atyre, që ishin n' errësirë: Zbulohuni.

Çudî e madhe! Krijetar' i të padukurave, si pësoj trupërisht nga njerzidashja, u-ngjall i pavdekuri. Eni, ô breza kombesh, t' i falemi këtî; se, passi shpëtuam prej rrejtjes me dhëmpshërin' e tij, mësuam të hymnojmë një Perëndî më tri qënjera.

Adhurim të mbrëmëshmë të 'blatojmë ty dritës së paperënduar. që shkëlqeve në botë, si në pasqyrë, me trup në mbarim të jetëve, dhe zbrite gjer në Ferr, dhe përndave errësirën e atieshme, dhe u rrëfeve kombeve dritën e Ngjalljes. O Zot dritëdhënës, lavdî më ty.

Hyjlindësore.

Në Det të kuq u-përshkrua një herë korë e Nuses së pamarrtuar. Atiê Moisiu përndanjës' i ujit; këtu Gabrieli shërbëtor' i çudisë; atëhere Israeli shkoj më këmbë detin pa u-lagur; dhe tanî Virgjëresha lindi Krishtin pa farë; deti pas shkimit të Israelit mbeti i pashkuar; e pabiashmuara pas lindjes së Emanuelit mbeti e pacinuar. O Perëndî, që je dhe ishe më parë, dhe u-duke si njerî, mëshirô-na.

Përlëshore dhe Hyjlindësore.

Fialën e panisëshme bashkë me Atin e me Shpirtin Shënt, që lindi prej Virgjëreshës për shpëtimin tonë, le t' a përhymnojmë, ô besnikë, e le t' i falemi; se dignoj të ngjitet më kryq trupërisht dhe të durojë vdekje, dhe t' i ngrerë të vdekurit më Ngjalljen e tij të lavdëruar.

Gëzoh-u, ô der' e Zotit, e pashkuar; gëzoh-u, ô mur dhe mprojtje e atyre që përikin te ty; gëzoh-u, ô liman i padimëruar, dhe e pamarrtuar. Ti, që linde trupërisht bërësin tënt dhe Perëndi, mos resht së nërmjetuari për atâ që përhymnojnë dhe adhurojnë birin tënt.

Vargëzime Ngjalljesore të Lavdërimeve.

O Zot, kur ish varri i shiluar prej të paligjëve, dolle prej tij, sikundër linde prej Hyjlindëses; nuk kupëtuan si u-mishërove Engjëjt' e tû Pa-trup; nukë ndienë kur u-ngjalle ushtarët që të ruanin; se që të dyja këtô janë të shiluar për atâ që kërkojnë; dhe janë çfaqur çudirat nër atâ që adhurojnë mysterin me besë; neve që e përhymnojmë ep-na si çpagim ngazëllimin dhe përdëllimin e math.

O Zot, duke dërmuar llozet e përjetëshme dhe duke çarë vargojt' e varrit, u-ngjalle, passi lê prokofet si dëshmim të varrimit tënt të vërtetë për tri ditë, dhe shkove përpara në Galilê ti, që të ruanin në shpellë. O Shpëtimtar i pakuptuarshim, mëshirô-na.

O Zot, gratë rentnë më varr të shëkojnë ty Krishtin, që pësove për ne, dhe, kur erdhë pranë, gjetnë një Engjëll që rinte mi gurin, i cili u-rrugullis nga frika, dhe ay u thirri duke thënë: U-ngjall Zoti; thuajuni nxënësve që u-ngjall së vdekurësh ay që shpëton shpirtet tona.

O Zot, sikundër dolle nga varr' i shiluar, ashtu hyre dhe nga dyert' e mbyllura nër nxënësit e tû, dhe u rrëfeve pësimet e trupit, që dignove, ô Shpëtimtar, nga zëmër-gjerësia. Si nga far' e Davidit, durove plaga, dhe, si Bir' i Perëndisë, çlirove botën. Mëshira jote ësht' e madhe! O Shpëtimtar i pakuptuarshim, mëshirô-na.

TINGËLL TËRTHOR II.

Vargëzime Ngjalljesore të Thirrtoreve.

Duke patur mundjen kundër Ferrit, ô Krisht, u-ngjite më Kryq, që të ngjallësh bashkë me vete atâ që rrinin n' errësirë të vdekjes ; ô Shpëtimtar i tërëfuqishim, i liri nër të vdekurit, që buron jetë prej dritës së vetë, mëshirô-na.

Sot Krishti, duke shkelur vdekjen, sikundër tha, u-ngjall dhe i fali Botës ngazëllimin, që të thomi të gjithë kështu, duke thirrur hymne : burim' i jetës, drit' e paafëruar, ô Shpëtimtar i tërëfuqishim, mëshirô-na.

Ty, ô Zot, që je më tërë kriesën, ku do t' ikim ne mëkatarët ? më Qiell ? ti rri atiê vetë ; më Ferr ? atiê shkele vdekjen ; nër thellësirat e detit ? atiê është dora jote, ô Zot. Te ty përikim, ty të biem nër këmbë e të lutemi : Ti, që u-ngjalle së vdekurësh, mëshirô-na.

Më Kryqin tënt, ô Krisht, mburremi dhe Ngjalljen tënde hymnojmë dhe lavdërojmë. Se ti je Perëndia jonë, veç teje nukë njohim tiatër.

Hyjlindësore.

Cili do mos të lumëroje, ô Hyjlindëse Virgjëreshë ? cili do mos përhymnojë lindjen tënde të kulluar ? se Biri i vetëmlindur që shkëlqeu prej Atit pa-mot, gjith' ay lindi prej teje të Kulluarës, i mishëruar pa tregim, duke qënë prej natyre Perëndî,

dhe duke u-bërë njerî për ne prej natyre : i pandarë më dysî vetash, po i njohur më dysî natyrash pa-përzierë. Atî lut-i' u, ô Zonj' e Lumur, të mëshirohen shpirtet tona.

Përlëshore dhe Hyjlindësore.

Fuqira Engjëllore erdhë mi varrin tënt, dhe atâ që ruanin u-bënë si të vdekur; dhe qëndronte Maria më varr, duke kërkuar Trupin tënt të pacinuar. E plaçkove Ferrin, pa u-ngarë prej tij; e poqe Virgjëreshën, duke dhuruar jete. O Zot, që u-ngjalle së vdekurësh, lavdî më ty.

Ti që quajte Mëmën tënde të bekuar, erdhe te Pësimi me vullnetin tënt, dhe shkëlqeve më kryq, duke dashur të kërkosh Adamin, dhe duke u thënë Engjëjve : Përgëzomëni se u-gjet drakma e humbur. Ti, që i urdhërove të gjitha urtësisht, lavdî më ty.

Vargëzime Ngjalljesore të Lavdërimeve.

Kryqi yt, ô Zot, është jetë dhe Ngjallje për popullin tënt; dhe, duke patur besim mi të, hymnojmë ty Perëndinë tonë që u-ngjalle; mëshirô-na.

Varrimi yt, ô Zot, i çeli Parrajsën gjindjes së njerësve; dhe, si u-çepërblemë prej prishjes, hymnojmë ty Perëndinë tonë që u-ngjalle; mëshirô-na.

Bashkë me Atin e me Shpirtin le të përhymnojmë Krishtin, që u-ngjall së vdekurësh, e le t' i thërresim : Ti je jetë dhe ngjallje për ne ; mëshirô-na.

U-ngrite pas tri ditsh prej varrit, ô Krisht, sikundër është shkruar, duke ngritur bashkë dhe Stërgjyshin tonë. Përandaj të lavdëron gjindja e njerësve dhe përhymnon ngjalljen tënde.

TINGËLL I RËNDË.

Vargëzime Ngjalljesore të Thirrtoreve.

Eni të ngazëllohemi më Zotin, i cili dërmoj pushtetin e vdekjes dhe ndriçoj gjindjen e njerësve, duke thirrur bashkë me Engjëjtë: O Krietar dhe Shpëtimtari ynë, lavdî më ty.

Kryq durove, ô Shpëtimtar, dhe varrim për ne; dhe me vdekje vrave vdekjen si Perëndî. Përandaj adhurojmë ngjalljen tënde të triditëshme; ô Zot, lavdî më ty.

Kur panë Apostujtë Ngritjen e Krietarit, u-çuditnë, duke thirrur lavdërimin ëngjëllor. Kiô është lavdi' e Kishës; kiô është pasuri' e Mbretërisë. O Zot, që pësove për ne, lavdî më ty.

Me-gjithë-që u-zure, ô Krisht, prej burrash të paligjët, po ti je Perëndia ime, dhe nuk e kam për turp; u-frushkullove në kurrist, nuk e mohoj; u-mbërtheve më Kryq, s' e fsheh; më Ngjalljen tënde mburrem; se vdekja jote është jeta ime. O Zot i tërëfuqishim dhe njerzidashës, lavdî më ty.

Hyjlindësore.

Mëmë u-njohe përmi natyrë, ô Hyjlindëse, dhe Virgjëreshë mbete përmi arësye dhe mejtim; dhe

çudin' e lindjes s' ate gjuhë s' munt t'a spiegojë ; se nga që është e çuditshime zënja, ô e Kulluarë, përandaj është e pakuptuarshime dhe mënyra e lindjes ; se atiê ku dô Perëndia, mundet regull' e natyrës. Përandaj, duke të njohur të gjithë si Mëmë të Perëndisë, të lutemi nxehtërisht : nërmjetô të shpëtohen shpirtet tona.

Përlëshore dhe Hyjlindësore.

Dështrove vdekjen me Kryqin tënt ; i çele Kusarit Parrajsën ; e ndryshove vajtimin e Myrrëprurseve, dhe Apostujve tënt u urdhërove të lëçitin ; se u-ngjalle, ô Krisht Perëndî, dhe i fale botës përdëllimin e math.

Si thesar i ngjalljes s' onë, ô e Tërëhymnuar, nxir-i prej thellësirës dhe gropës së fajeve atâ që kanë besim më ty. Se ti i shpëtove fajtorët e mëkatës, duke lindur sphëtimin, ti që ishe Virgjëreshë para lindjes, Virgjëreshë më lindjen, dhe mbete dhe pas lindjes Virgjëreshë.

Vargëzime Ngjalljesore të Lavdërimeve.

U-ngjall Krishti prej së vdekurësh, duke zgjidhur vargojt' e vdekjes ; ungjillëzô, ô dhê, gas të math ; këndoni, ô qiej, lavdin' e Perëndisë.

Me-qënë-që pamë Ngjalljen e Krishtit, le t' i falemi Shënt Zotit Krisht, të vetëmit të pamëkatëshm.

Ngjalljen e Krishtit nuk pushojmë s' adhuruari ;

se ay na shpëtoj prej paligjësive tona. Shënt Zoti Krisht, që na rrëfeu Ngjalljen.

Si t' i a çpaguajmë Zotit gjith' atô që na fali? Për neve erdhi Perëndia nërmiet njerësve ; për natyrën e përprishur Fiala mori trup dhe tendësoj nër ne ; për të ngratët mirëbërësi ; për robërit çlirimtari ; për atâ që rrinin n' errësirë diell' i drejtërisë ; mi Kryqin i papësuari ; në Ferr drita ; më vdekjen jeta ; Ngjallja për të rënët. Atî le t' i thërresim : Perëndia jonë, lavdî më ty.

TINGËLL TËRTHOR IV.

Vargëzime Ngjalljesore të Thirrtoreve.

Hymnë mbrëmësore dhe adhurim t' arësyshmë të 'blatojmë, ô Krisht. se dignove të na mëshirosh me Ngjalljen tënde.

O Zot, ô Zot, mos na hith tej prej faqes s' ate ; po dignô të na mëshirosh me anën e Ngjalljes.

Gëzoh-u, ô Sion' e shëntë, mëm' e Kishërave, ndënjja e Perëndisë ; se ti prite e para ndiesë mëkatash me anën e Ngjalljes.

Fiala, që lindi para jetëve prej Atit Perëndisë, dhe nër kohërat e fundit gjith' ay u-mishërua prej së Pamarrtuarës, duroj kryqësim vdekjeje vullnetarisht, dhe shpëtoj njerin' e vdekur që-moti me anën e ngjalljes së tij.

Hyjlindësore.

Mbret' i Qiejve u-duk mi dhê nga njerzidashja dhe u-shokërua me njerëzit ; se, duke marre trup

prej Virgjëreshës së Kulluar, lindi prej saj me këtë mishërim, dhe është një Bir, i dypalëshm nga natyra, po jo nga substanca. Përandaj, duke e lëçitur Perëndî përfekte dhe njerî përfekt me të vërtetë, rrëfejmë Krishtin Perëndinë tonë; atî lut-i'u, ô mëm' e panusëruar, të mëshirohen shpirtet tona.

Përlëshore dhe Hyjlindësore.

Që-lartazi zbrite, ô i zëmërdhëmpshur, varrim dignove të triditëshm, që të na çlirosh neve prej pësimeve. O Zot, jeta dhe ngjallja jonë, lavdî më ty.

Ti, që linde për ne prej Virgjëreshës dhe durove Kryqësim, ô i mirë, që plaçkove vdekjen me vdekje dhe rrëfeve ngritjen si Perëndî, mos i çvështrô atâ që gatove me dorën tënde: rrëfê njerzidashjen tënde, ô mëshirëplot; prit Hyjlindësen që të lindi të nërmjetojë për ne; dhe shpëtô, ô Shpëtimtari ynë, një popull të dëshpëryer.

Vargëzime Ngjalljesore të Lavdërimeve.

O Zot, me gjithë që vajte në gjukatore dhe u-gjukove prej Pilatit, po nuk u-lipse nga froni duke ndënjur bashkë me Atin, dhe, si u-ngrite prej së vdekurësh, e çlirove botën nga robëri' e të huajit, si i dhëmpshur dhe njerzidashës.

O Zot, me gjithë që të vunë Judejtë si të vdekur në varr, po, si mbret që flinte, ushtarët të ruanin,

dhe të shiluan me shilë si thesar të jetës; po u-ngjalle dhe u fale shpirteve tona paprishjen.

O Zot, armë kundër Diallit Kryqin tënt na ke dhënë ne; se tmerrohet e dridhet, nga që s'duron të shëkojë fuqin' e tij; se ngjall të vdekurit dhe aboliti vdekjen. Përandaj po lusim varrimin tënt dhe ngritjen.

Engjëlli yt, ô Zot, që lëçiti ngjalljen, ruajtësit i trëmbi, dhe grave u thirri, duke thënë: Si kërkoni të gjallin me të vdekurit? u-ngjall, se ish Perëndî, dhe i dhuroj botës jetën.

Dërgimësore dhe Hyjlindësore të Ngjalljes.

I.

Bashkë me nxënësit le të mblidhemi në mal të Galilesë të shëkojmë Krishtin me besë që thotë se mori pushtet mi atô që janë lart e poshtë; le të nxëmë si i mëson të pagëzojnë gjithë kombet më emërin e Atit, e të Birit, e të Shpirtit Shënt, dhe që do të jetë bashkë me nxënësit, siç u-zotua, gjer në mbarim te jetës.

Bashkë me nxënësit gëzoheshe, ô Hyjlindëse Virgjëreshë, se pê Krishtin që u-ngrit prej varrit pas tri ditsh, sikundër tha; nër të cilët u-duk, duke i mësuar, e duke u çfaqur më të mirat, e duke i urdhëruar të pagëzojnë më Atin, e më Birin, e më Shpirtin, që të besojmë Ngjalljen e tij e të lavdërojmë ty, ô Vashë.

II.

Kur panë gurin të rugullisur, myrrëprurset gëzoheshin; se panë një dialosh që rrinte më varr dhe ay u tha atyre : Ja Krishti u-ngjall; thuajuni nxënësve bashkë me Pietrin : Arrini në mal të Galilesë, atiê do t' j' u-duket siç u tha më parë miqve.

Engjëll i solli Virgjëreshës përshëndoshjen « Gëzoh-u » para zënjes s' ate, ô Krisht; Engjëll të ruggullisi dhe gurin prej varrit; njëri sillte symbole gazi të patreguar, në vënt të helmit, tiatri të lëçitte falësin e jetës në vënt të vdekjes dhe të madhështonte e u thoshte ngjalljen grave dhe nxënësve.

III.

Se Krishti u-ngjall asnjë të mos dyshojë; se i' u-duk Marisë, pastaj e panë atâ që shkonin nd' arë; dhe prapë u-çfaq nër të njëmbëdhjetët, kur hanin, të cilët si i dërgoj të pagëzojnë, u-ngjit nër qiejtë ngaha zbriti, duke vërtetuar lëçitjen me shumicë shënjash.

Ti Diell, që linde sot prej varrit, si Dhëndër, prej nusëroreje, dhe plaçkove Ferrin, dhe abolite vdekjen, me nërmjetimet e asaj që të lindi, dërgô-na dritën neve, dritën që ndriçon zëmrat dhe shpirtet, dritën që na shpie të gjithëve të baresim nër patekat e urdhërimeve tënde dhe nër udhët e paqjes.

IV.

Të shkëlqyer me virtyte, le të shëkojme burrat që qëndruan te varri jetëprurës me roba që shkrepë-

tinin përpara Myrrprurseve që unjnë faqen mbi dhê; le të mësohemi Ngjalljen e atî që zotëron mi qiellin, dhe le të rendim te jeta në varr bashkë me Pietrin dhe, të çuditur për ngjarjen, le të mbetemi të shohim Krishtin.

Duke thënë « Gëzohuni », e ndrrove helmin e Stërgjyshërve, ô Zot, duke futur në vënt të tij gazin e ngjalljes s' ate më botën ; dërgô-na pra, ô Jetëdhënës, me anën e saj që të lindi, dritën e dhëmpshërive tënde, që të të thërresim : Njerzidashës Perëndî-njerî, lavdî Ngritjes s' ate.

V.

Krishti, jeta dhe udha, si u-ngjall së vdekurësh, udhëtoj bashkë me Kleopën e me Lukën, nër të cilët u-njoh në Emmaus më të thyer bukën ; të cilëve u digjej zëmra dhe shpirti, kur u fliste mb' udhë, e u spiegonte pas Shkronjave atô që pësoj ; me atâ le të thërresim « U-ngjall », dhe i' u-duk dhe Pietrit.

Hymnoj mëshirën tënde të panëmëruar, ô Bërësi im, se dignove të veshësh e të shpëtosh natyrën e ligësuar të njerëzive ; dhe, duke qënë Perëndî, tolerove të lindësh për mua prej Vashës së kulluar dhe të zbreç gjer në Ferr, nga që deshe të shpëtohem, me nërmjetimet e asaj që të lindi, ô Zot i zëmërdhëmpshur.

VI.

Duke treguar, ô Shpëtimtar, që je njerî pas natyrës, qëndrove në mest e po predikonje, si u-

ngrite prej varrit, dhe more piesë më të ngrënë, ô pagëzim i pendimit; dhe me-një-herë u-ngjite te Ati qiellor, dhe u-zotove t' u dërgosh nxënësve Ngushëllimtarë. I permihyjëshmë Perëndî-njerî, lavdî ngjalljes s' ate.

Bërësi i Kriesës dhe Perëndî' e të gjithëve mori trup të njerëzishmë nga gjakrat e tua të kulluara, ô Virgjëresh' e Tëreshëntë; se e përsëriti prapë tërë natyrën e prishur, duke të lënë pas lindjes si para saj. Përandaj të lëvdojmë të gjithë me besë, duke thirrur: Gëzoh-u, ô Zonj' e botës.

VII.

Kur tha Maria se e ngritnë Zotin, rentnë më varrt Simon Pietri dhe nxënësi tiatër i Krishtit, që e deshte; vrapuan pra që të dy dhe gjetnë brënda pëlhurat vetëm të shtrira, dhe mbules' e kokës ish veç këtyre; përandaj u-qetësuan prapë gjer sa panë Krishtin.

Të mëdha e të çuditshime punove për mua, ô Krishti im mëshirëplot; se linde prej Çupe të Virgjërë pa-spiegim dhe dignove Kryq; dhe, si durove varrim, u-ngjalle me lavdî, dhe e çlirove natyrën tonë prej vdekjes. Lavdî, ô Krisht, lavdisë s' ate, lavdî fuqisë s' ate.

VIII.

Kur pa dy Engjëj brënda në varr, Maria çuditej, dhe, duke mos njohur Krishtin, e pyeste si kopsh-

tare : O Zot, ku e ke vënë Trupin e Jesujt t' im? dhe, kur e thirri ay, dhe e njohu që ish vetë Shpëtimtari, dëgjoj : Mos më prek ; thuaj 'u vëllezërve të mi, që shkoj te Ati.

O Vashë, ke lindur pa-tregim njerinë prej Trinisë, i cili qe i dypalëshm nga natyra, i dypalëshm nga vepërimi, po një nga substanca; këtî pra lut- i'u përherë për atâ që t' adhurojnë me besë t' i çpërblejë prej ç'dô keqdashjeje t'armikut; se te ty përikim të gjithë tanî, ô Zonjë Hyjlindëse.

IX.

Kur hyre, ô Zot, nga dyert' e mbyllura, i mbushe Apostujtë me Shpirtin e Tërëshëntë, si u fryve paqërisht, dhe u thê të lidhin e të zgjidhin mëkatat; dhe tetë ditë pas i dëftove Thomajt brinjën tënde dhe duartë, me të cilin thërresim : ti je Zoti dhe Perëndia.

Kur pê Birin tënt të ngrihet prej varrit pas tri ditsh, ô Virgjëreshë e Tërëshëntë, Nus' e Perëndisë, hodhe gjithë hidhërimin, që ndjeve si mëmë kur e pê të pësojë, dhe plot me gas, duke e lëvduar nër nxënësit e tij, e hymnonje. Përandaj shpëtô tanî atâ që të lavdërojnë si Hyjlindëse.

X.

Në det të Tiberiadës ishin që-moti për pishq Thomaj me diemt, e Zebedeut, Nathanaelë, Pietrin dhe dy të tierë ; këtâ, pas urdhërit të Krishtit, i

hodhë rietat më të diathtë dhe hiqnin shumicë pishqësh; Pietri e njohu dhe u-lëshua me not për te ay; dhe, duke u-çfaqur nër tâ për të tretën herë, u rrëfeu bukë dhe peshk mi thëngjijtë.

Zotit, që u-ngrit prej varrit pas tri ditsh, ô Virgjëreshë, lut-i'u për atâ që të hymnojnë e të lumërojnë me mall; se ty të kemi të gjithë përikje shpëtimtare dhe nërmjetare te ay; se njerëzia dhe shërbëtorët e tû jemi, ô Hyjlindëse, dhe te përkrahja jote e kemi të gjithë synë.

XI.

Pas ngritjes së Hyjëshme, si e pyeti Pietrin tri herë Zoti: « A më dô? » e vuri për kryebarî të dhënve të tij; ay, duke parë të vinjë pas i dashur' i Jesujt, e pyeti Zotin. Po ky ç'dô? Në dua, tha, unë të mbetet ky gjer sa të vij prapë, ç'të ha malli ty, ô mik Pietër?

O myster i frikshim! ô çudî e habitshime! me vdekjen vdekja u-venit. Kush pra do mos përhymnojë dhe kush do mos adhurojë ngjalljen tënde, ô Fialë, dhe Hyjlindësen që të lindi e kulluar trupërisht; me nërmjetimet e së cilës përblej-i të gjithë prej gjëhennës.

LAVDIRA MËNGJEZORE.

I. TINGËLL I.

Kur nxitoheshin nxënësit në mal për shestjen prej dheut, u qëndroj përpara Zoti; dhe, si i'u-falë dhe

mësuan pushtetin q'i ish dhënë kudô, dërgoheshin në botë të lëçitin Ngjalljen prej së vdekurësh dhe vëndosjen nër qiejtë ; me të cilët u-zotua i vërteti të jetë bashkë për jetë, Krishti Perëndia dhe Shpëtimtar' i shpirteve tona.

II. TINGËLL II.

Nër gratë rreth Marisë që erdhë me myrra dhe çuditeshin si do t' a shëkojnë të përmallshëmin, uduk gur i ngritur dhe një dialosh i perëndishmë që u paqësonte trubullimin e shpirtit : Se u-ngrit, tha, Zoti Jesu ; përandaj lëçituni nxënësve të tij lëçitës të rendin në Galilê dhe atiê t' a shëkojnë të ngjallur prej së vdekurësh, si Jetëdhënës dhe Zot.

III. TINGËLL III.

Maria Madalena kur lajmëronte Ngjalljen prej së vdekurësh dhe çfaqjen e Shpëtimtarit, nxënësit dyshuan dhe qërtoheshin për gurësin' e zëmërës ; po, si u-armatisnë me shënja e me çudira, dërgoheshin te lëçitja. Dhe ti, ô Zot, u-shestjove te At' i kryendritshim ; dhe atâ lëçitnin kudô fialën, duke e provuar me çudira. Përandaj ne të ndritshuarit prej syresh lavdërojmë Ngjalljen tënde prej së vdekurësh, ô Zot njerzidashës.

IV. TINGËLL IV.

Agim ish i thellë dhe gratë erdhë më varrin tënt, ô Krisht ; po nuk u-gjet Trupi për të cilin kishin mall.

Përandaj atiê tek çuditeshin u qëndruan përpara atâ me robat që shkrepëtinin e u thoshin : Si e kërkoni të gjallin me të vdekurit ? u-ngrit, siç parëthâ. Përse i harroni fialët e tija ? Nër të cilët u-bintnë dhe lëçitnë atô që panë ; po u dukeshin si marrësî Mirëlajmet ; aqë të ngathët ishin êdhe nxënësit ; po Pietri rendi dhe, si pâ, lavdëroj më vete çudirat e tua.

V. TINGËLL TËRTHOR I.

O gjykimet e tua të urta, ô Krisht ! si i dhê Pietrit të kupëtojë Ngjalljen tënde me pëlhurat vetëm, dhe Lukajt e Kleopës u flisnje duke udhëtuar bashkë, e më të kuvënduar nuk e çfaqe veten tënde me një herë ? Përandaj pra qërtohesh si i vetem që rri në Jerusalem e nukë di mejtimet e saj të fundit. Po ti, që i urdhëron të gjitha për te mirën e kriatyrës, spiegove profetitë për ty, dhe më të bekuar bukën u-njohe nër tâ, që zëmrat u digjeshin dhe më parë për njohjen tënde ; të cilët u lëçitnë pastaj dhe nxënësve të mbledhur me zë të lartë Ngjalljen, me anën e së cilës mëshirô-na.

VI. TINGËLL TËRTHOR II.

O Krisht që je paqja me të vertetë për njerëzit e Perëndisë, kur u epnje paqjen tënde nxënësve pas Ngritjes, i trëmbe nga që pandehnin se shëkonin fantasmë. Po u-a paqësove trubullimin e shpirtit, duke u rrëfyer duartë dhe këmbët e tua ; po, siç nuk besonin êdhe, duke marrë piesë më të ngrënën, e

duke u kujtuar mësimet, u-a çele mëndjen të kupëtojnë Shkronjat ; dhe, si u dhê zotimin atëror dhe i bekove, shkove në qiell. Përandaj po të falemi bashkë me tâ, ô Zot, lavdî më ty.

VII. TINGËLL I RËNDË.

Ja errësirë dhe mëngjes, dhe përse, ô Marî, qëndron më varrt, duke patur errësirë të madhe në mëndje ? përandaj pyet ku është vënë Jesuj ? po shëkô nxënësit që rentnë bashkë si e muarë vesh Ngjalljen nga pëlhurat dhe nga prokofi dhe kujtuan Shkronjat për të. Bashkë me të cilët dhe me anën e të cilëve si besuam dhe ne, përhymnojmë ty Krishtin jetëdhënës.

VIII. TINGËLL TËRTHOR IV.

Lott' e Marisë nukë derdhen nxehtërisht më kot; se ja ku vlerësohet të shëkojë Engjëj që e mësojnë dhe ty, ô Jesu, po êdhe mejton të dheshme, sa grua e pafuqishme ; përandaj nuk e qase të mpshtetet, ô Krisht. Mirpo dërgohet si lëçitëse nër nxënësit e tû, të cilëve u dha ungjillëzimet, dhe u lajmëroj ngjitjen më vëndin e Atit. Bashkë me të cilën vlerësôna dhe ne për çfaqjen tënde, ô Zot i Math.

IX. TINGËLL TËRTHOR I.

Më kohën e fundit, më të gëdhirë e para dit' e Javës, u qëndrove miqve përpara, ô Krisht, dhe vërteton Ngjalljen tënde prej së vdekurësh, çudî me çudî, me hyrjen nga dyert' e mbyllura. Po i mbushe

nxënësit me gas dhe u dhê prej Shpirtit Shënt, dhe u fale pushtetin për ndjesë mëkatash, dhe Thomanë nuk e lê të përmbytet te shqota e pabesisë. Përandaj fal-na dhe neve dijë të vërtetë dhe ndiesë fajesh, ô Zot i zëmërdhëmpshur.

X. TINGËLL TËRTHOR II.

Pas zbritjes në Ferr dhe Ngjalljes prej së vdekurësh, nxënësit të hidhëruar, siç dihej, për ndarjen tënde, ô Krisht, u-shtinë më punë ; dhe përsëri lundra e rieta, po gjah gjëkunt. Po ti, ô Shpëtimtar, u-çfaqe si Zot i gjithësisë dhe urdhërove t' i hedhin rietat më të diathtë ; dhe fiala u-vû më punë menjë-herë, dhe u-zû shumic' e madhe pishqësh, dhe një dark' e çuditshime ish gatî mbë dhê. Nga ajô që piesëtuan atëhere Nxënësit e tû, vlerësô-na të dëfrejme dhe ne tanî mëndërisht, ô Zot njerzidashës.

XI. TINGËLL TËRTHOR IV.

Kur e çfaqe veten tënde, ô Shpëtimtar, nër nxënësit e tû pas Ngjalljes, i dhê Simonit ruajtjen e dhënve, duke i lypur kujdesin e kullotjes si çpagim të dashurisë. Përandaj dhe i thoshe : Në më dô, ô Pietër, kullot shqerat e mia ; kullot dhënt' ë mia. Dhe ay, duke treguar me një herë dashurinë, pyeste për nxënësin tiatër. Me nërmjetimet e të cilëve, ô Krisht, ruaj-e grigjën tënde nga ujqërit që e përçajnë.

ZBRITËSORET

QË KËNDOHEN MË TËRË MOTIN.

TINGËLL TËRTHOR IV

[ŚTAVRON HARAXAS MOSIS]

I. Moisiu, duke përvijosur Kryq drejt me shkopin, e preu Detin e Kuq për Israelë që shkoj më këmbë; dhe më të kthyer, duke trokitur, e bashkoj për qeret e Firaunit, duke përshkruar për-së-gjeri armën e pamundur; përandaj le t' i këndojmë Krishtit Perëndisë s' onë, se u-lavdërua.

III. Shkopi merret si shtyp i mysterit; se me burbuqin parëtregon priftin; dhe Kishës që ish shterpë më parë i lulëzoj tanî drurin e Kryqit për pushtet e mpshtetje.

IV. Kam dëgjuar, ô Zot, mysterin e urdhërimit tënt, kupëtova veprat e tua, dhe lavdërova hyninë tënde.

V. O drur' i trish-lumur! më të cilin u-ndê Krishti, mbreti dhe zoti; me anën e të cilit ka rënë ay që rrejti me drurin, si u-gënjye prej teje, Perëndisë që u-mbërthye trupërisht, që u fal paqjen shpirteve tona.

VI. Në mushkërit' e egërsirës së detit, Jonaj, duke shtirë pëllëmbat kryqthi, parështypte kjarisht pësimin shpëtimtar; përandaj, duke dalë jashtë pas

tri ditsh, pikturoj Ngjalljen e përmibotëshme të Krishtit Perëndisë, që u-mbërthye trupërisht dhe ndriçoj botën me ngritjen e triditëshme.

VII. Urdhëri i çmëndur i shtyranit cpietos, që frymoste frikësim dhe blashfemî hyjshamëse, popujtë tronditi; po tre Diemtë nuk i trëmbi tërbimi egërsor, as ziarri që buçiste; dhe, kur qëndronin bashkë në ziarr, dhe oshtëtinte era vesëprurëse, këndonin: Perëndî e përmihymnuar e Atërve tanë, i bekuar je.

VIII. Bekoni, ô Diem të njënumërtë me Trininë, Perëndinë Atin Krietar; hymnoni Fialën që dignoj të zbresë dhe të ju ndryshojë ziarrë më vesë; dhe përmilartësoni më jetët Shpirtin Tëreshënt që u fal jetë të gjithëve.

IX. Parrajsa mystike je, ô Hyjlindëse, që burbuqose Krishtin pa lërim, prej të cilit është mbiellur mbë dhê druri jetëprurës; duke adhuruar atë që po ngrihet, ty të madhështojmë.

Kiô Zbritësore këndohet që më 1 të Vieshtës së 1 gjer më 21 t' atî muajî.

[ANIKSO TO STOMA MU]

I. Do t' a çel gojën, dhe do t' më rrafshohet me shpirt, dhe fialë do t' i thom Mëmës mbretëreshë, dhe do të dukem të kremtëroj buzëqeshur, dhe do t' këndoj i gëzuar çudirat e saj.

III. O Hyjlindëse, ne këngëtorët e tû, që po mblidhemi më një shoqërî shpirtore, shigurô-na, si burim i gjallë dhe i pasosur, dhe më lavdinë tënde të hyjëshme vlerësô-na për kurorë lavdie.

IV. Dëshirën tënde të perëndishme të pagjurmësuar, që do t'mishërohesh ti i Larti prej Virgjëreshës, Profeti Abakum duke kupëtuar, thërriste : Lavdî fuqisë s' ate, ô Zot.

V. U-çudit gjithësia prej lavdisë s'ate së hyjëshme; se ti, ô Virgjëresh' e pamarrtuar, pate ndë gjî Perëndin' e të gjithëve dhe linde Bir pa-mot duke u dhuruar shpëtimin gjith' atyre që të hymnojnë.

VI. Ne hyjmëndësit që lusim këtë të krëmte të hyjëshme e të nderçime të Mëmës së Perëndisë, eni të trokasim duartë, duke lavdëruar Perëndinë që lindi prej saj.

VII. Nuk adhuruan kriesën Hyjmëndësit, po Krietarë ; dhe, duke shkelur burrërisht frikësimin e ziarrit, me gas këndonin : I përmi-hymnuar, Zot dhe Perëndî e Atërve, i bekuar je.

VIII. Diemat e lumur në furrë piellja e Hyjlindëses i shpëtoj, atëhere duke u shëmbëllyer, dhe tanî duke u vepëruar ; tërë botën e mbleth për të kënduar : Zotin hymnoni, ju veprat e tij, dhe e përmilartësoni më gjithë jetët.

IX. Ç' dô dhê-lindurë le të kërcejë, i shkëlqyer prej shpirtit ; e le të krëmtërojë natyra e mëndjeve të palëndëshme, duke lavdëruar panair' e shëntë të Mëmës së Perëndisë, e le t' thërresë : Gëzoh-u, ô Hyjlindëse e gjithlumur, e kulluar, e gjithmon-virgjërë.

Këndohet që më 22 të Vieshtës së 1 gjer më 20 të Vieshtës së III.

[HRISTOS JENNATE. TINGËLL I]

I. Krishti lindet, lavdërojeni; Krishti prej qiejve, përpara dilini; Krishti mi dhê, lartësojeni; këndojini Zotit tërë dheu, dhe me ngazëllim përhymnojeni, popuj, se u-lavdërua.

III. Birit, që lindi para jetëve prej Atit pa mëmë, dhe u-mishërua më në fùnt prej Virgjëreshës pa atë, Krishtit Perëndisë le t' i thërresim; O Zot, që lartësove ballën tonë, i shëntë je.

IV. Shkop prej rënjës së Jeseut, dhe lule prej saj, ô Krisht i lavdëruar, u-burbuqose prej Virgjëreshës; prej mali hieploti të dëndur erdhe ti i palëndëshmi dhe Perëndia, si more trup prej së pamarrtuarës; lavdî fuqisë s' ate, ô Zot

V. Duke qënë Perëndî paqjeje, dhe Atë mëshirash, na dërgove Engjëllin e këshillës s' ate të madhe që fal paqjen. Përandaj, të udhëhequr te drita e hyjnjohjes. duke mënguar që me-natë, të lavdërojmë, ô njerzidashës.

VI. Egërsira e detit e volli Ionanë prej mushkërive, sikundër e priti; dhe Fiala, kur ndënji te Virgjëresha dhe mori trup shkoj, duke e ruajtur të pacinuar; se, sikundër u-zû pa âtë, ashtu e la të papësuar atë që e lindi.

VII. Diemat, të ritur me pietet, duke kontemnuar urdhërin çpietos, nuk u-ndrojtin prej frikësimit të ziarrit; po në mes të flagës duke qëndruar këndonin: O Perëndî e Atërve, i bekuar je.

VIII. Furra vesëplote korësoj shtypin e një çudie të përminatyrëshme; se nuk i dogji diemt' e rinj që priti, sikundër dhe ziarri i Hynisë nukë cënoj gjirin e Virgjëreshës ku hyri; përandaj le të këndojmë, duke hymnuar: Tërë kriesa le të bekojë Zotin e le t' a përmilartësojë më gjithë jetët.

IX. Një myster të huaj shoh e të çuditshim: shpellën për qiell; Virgjëreshën për fron qerubik; grazhdin për vënt, ku u-ndê Krishti Perëndia i panxënë, të cilin, duke përhymnuar, po madhështojmë.

Këndohet që më 21 të Vieshtës së III gjer më 1 të Janarit.

[VYTHU ANEKALYPSE. TINGËLL II]

I. Zbuloj fundin e detit, dhe nëpër sterê i udhëheq të tijtë, duke mbuluar atiê armiqtë, Zoti i pushtetshim nër luftërat, se u-lavdërua.

III. Zoti, që u ep fuqî mbretërve tanë dhe lartëson ballën e të lyerve të tij, lindet prej Virgjëreshe, dhe vien më pagëzim; përandaj, ô besnikë, le të thërresim: S' ka të shëntë si Perëndia jonë, dhe s' ka të drejtë veç teje, ô Zot.

IV. Kam dëgjuar, ô Zot, zërin tënt që thê: zër' i atî që thërret në shkretëtirë, se gjëmove më ujërat e shuma, duke dëshmuar për Birin tënt; i rrafshuar tërësisht prej Shpirtit që ndodhej atiê, thirri: Ti je Krishti, urtësia dhe fuqi' e Perëndisë.

V. Jesuj, kryetar' i jetës, erdhi të zgjidhë mallki-

min e Adamit të parëgatuar; dhe, me gjithë që si Perëndî s' kish nevojë për spastrim, spastrohet në Jordan për të rënin; në të cilën si vrau armiqësinë, fal paqjen që përshkon ç' dô mëndje.

VI. Zër' i Fialës, kandil' i dritës Agimprurës, Parërendës' i Diellit në shkretëtirë u thërret të gjithë popujve : Pendohuni dhe spastrohuni që më parëza. Se ja ku vien Krishti të çpërblejë botën prej prishjes.

VII. Diemat pietozë, që kuvënduan me furrën e ziarrit, i ruajti pa pësuar dëm një frymë prej vese që vërshëllente dhe zbritja e Engjëllit të perëndishmë; përandaj, të vesuar në flagë, duke përhiruar këndonin : I përmihymnuar Zot dhe Perëndî e Atërve, i bekuar je.

VIII. Një myster të çuditshim rrëfeu furra e Babylonës që buroj vesë; se nër valat e tij kish për të pritur Jordani ziarr të palëndëshm dhe për të mbuluar Krietarë që pagëzohej trupërisht; të cilin e bekojnë popujtë dhe e përmilartësojnë më gjithë jetët.

IX. Asnjë gjuhë s' di si të të lëvdojë pas vlerës; dhe vertikohet dhe mëndja e përmibotëshme si të të hymnojë, ô Hyjlindëse; po, duke qënë e mire, prit besën; se e di mallë tonë të perëndishmë; se ti je mprojtesh' e të Krishterëve, dhe ty po madhështojmë.

Këndohet që më 1 të Janarit gjer më 14 t' atî muaji.

[HERSON AVYSSOTOKON. TINGËLL III.]

I. Mi burrimin e avushave u-ngrit një herë dielli si më fushë ugar; se uja qëndroj më të dyja anët si mur për popullin që shkoj më këmbë në det dhe këndoj me mënyrë të pelqyer për Perëndinë : Le t' i këndojmë Zotit, se u-lavdërua lavdërisht.

III. O Zot, mpshtetja e atyre që kanë besim më ty, mpshtet-e kishën. të cilën e zapëtove me gjakun tënt të çmuar.

IV. I mbuloj qiejtë virtyti yt, ô Krisht ; se kur linde prej arkës së shëntërimit tënt, Mëmës s' ate së pacinuar, u-duke te tempull' i lavdisë s' ate si foshnjë e mbajtur në pëlqî ; dhe u-mbushnë të gjitha me lavdinë tënde.

V. Kur pâ Isaia symbolërisht më fron të lartë Perëndinë me Engjëj lavdie pas, thirri : Mieri unë ; se parëshëkova Perëndinë që trupëzohet dhe zotëron mi dritën e paperënduar dhe mi paqjen.

VI. Kur pâ plaku me sy shpëtimin që u erdhi popujve të thirri : O Krisht, ti je Perëndia ime prej Perëndie.

VII. Ty, që vesove më ziarrt Diemtë që theologjisnë,dhe ndënje te Virgjëresha e pacinuar, Fialën Perëndî hymnojmë, duke kënduar me pietet : I bekuar je, ô Perëndî e Atërve tanë.

VIII. Kur u-hodhë në ziarr të paduruar dialoshët

që ishin të parët më hyjnderim, dhe nukë pësuan dëm nga flaga, këndonin hymnë të perëndishmë : Bekoni Zotin, gjithë veprat e Zotit, dhe e përmilartësoni më gjithë jetët.

IX. Në ligjën, në hien e në Shkronjën, e pamë symbolin te besnikët ; ç' do mashkull që hap gjirin ësht i shëntë te Perëndia : përandaj Fialën e parëlindur, Birin e Atit pa-nisje, që lindet i pari prej Mëmës së pamarrtuar, po madhështojmë.

Këndohet që më 14 të Janarit gjer të Dielën e të Lidhurave.

[VOITHOS KAI SKEPASTIS. TINGËLL TËRTHOR II.]

I. Ndihmës dhe mprojtës m' u-bë për shpëtim ; ky është Perëndia ime dhe do t' a lavdëroj ; Perëndi' e t' im-ati dhe do t' a lartësoj ; se u-lavdërua lavdërisht.

III. Shigurô, ô Zot, mi gurin e porosive tënde zëmërën t' ime të tronditur, se ti je vetëm i shëntë dhe Zot.

IV. Dëgjoj Profeti ardhjen tënde, ô Zot, dhe utrëmp, se do të lindëshe prej Virgjëreshe, dhe do t' u rrëfeheshe njerësve, dhe thoshte : Dëgjova zërin tënt dhe u-trëmba. Lavdî fuqisë s' ate, ô Zot.

V. Ndriçô-më, ô njerzidashës, mua që mëngoj që me-natë, të lutem, dhe hiq-m'a udhën dhe mua nër urdhëratat e tua, dhe mësô-më të bëj ngaherë dëshirën tënde.

VI. Thirra me gjithë zëmërën t' imë te Perëndia e

zëmërdhëmpshur, dhe më dëgjoj prej Ferrit më të posthmë dhe m'a ngjiti jetën prej prishjes.

VII. Mëkatuam, shkelmë ligjat, bëmë padrejtësî përpara teje, dhe as mbajtmë, as bëmë, sikundër na porosite ; po mos na përep në funt, ô Perëndi' e Atërve.

VIII. Atë që e lavdërojnë ushtërit' e qiejve, dhe i dridhen Qerubimet dhe Serafimet, tërë kriesa e ndërtesa hymnojeni, bekojeni dhe përmilartësojeni më gjithë jetët.

IX. E paspieguar është lindja prej zënjes pa-farë të Mëmës së pamarrtuar. Se lindja e Perëndisë i përsërit natyrat; përandaj tërë brezat, si Mëmë të Perëndisë s' onë, me besë të drejtë po të madhështojmë.

Këndohet të Dielën e të Lidhurave. Të Dielat e tiera të Kreshmëve këndohet Zbritësorja « Do t' a çel gojën... »

[O THIOTATOS PROETYPOSE. TINGËLL I.]

I. Moisiu i përmihyjëshm parështypi që-moti në Det të Kuq, kur shkoj përtej Israelë, duke prerë ujërat me shkopin, me Kryqin tënt, dhe duke të kënduar këngën e daljes, ô Krisht Perëndî.

III. Shigurô-më, ô Zoti Krisht, te guri i besës me Kryqin tënt, që të mos më tronditet mëndja nga goditjet e armikut keq-dashës ; se ti vetëm je i Shëntë.

IV. Yll' i math u-droth prej tmerri, kur të pa mi

Kryqin, ô i Fortë, dhe i përmblodhi rezet e i fshehu ; dhe tërë kriesa hymnoj me frikë zëmërgjerësinë tënde ; se dheu u-mbush me lavdinë tënde.

V· Duke mënguar ty të përhymnojmë, ô Shpëtimtar' i botës, se gjetmë pasjen te Kryqi yt ; me të cilin përsërite gjindjen e njerësve, duke na hequr udhën te drita e paperënduar.

VI. Shtypin e Kryqit tënt të hyjëshmë parëvijosi Ionaj me pëllembë të ndera te barku i balenës dhe kërceu i shpëtuar prej egërsirës me fuqinë tënde, ô Fialë.

VII. Ay që shpëtoj Diemtë prej flagëzimit, duke marrë trup, erdhi mbi dhê, e, duke u-mbërthyer më Kryq, na dhuroj shpëtimin Perëndi' e Atërve tanë, i vetëmi i bekuar dhe i përmilavdëruar.

VIII. I madhi nër Profetët Daniel, kur u-hoth në gropë të luanëve një herë, duke shtrirë kryqthi duartë, shpëtoj nga goj' e tyre i pacinuar, duke bekuar Krishtin Perëndinë më jetët.

IX. O Mëmë Virgjëreshë dhe Hyjlindëse e vërtetë që linde pa-farë Krishtin Perëndinë tonë, që u-ngrit maj Kryqit trupërisht, ty gjithë besnikët siç të ka hie bashkë me të po të madhështojmë.

Këndohet të Dielën e III të Kreshmëve.

[OFTHISAN AI PIJAI. TINGËLL IV.]

I. U-duknë burimet e avushës pa ujë, dhe u-zbuluan themelit' e detit që valon prej shqotës ; se me

një shënjë e nëme, dhe shpëtove popullin e zgjedhur që të këndonte hymnë mundëse, ô Zot.

III. Popull' i Israelit thëthiti shkëmbin e përpjetë e të thatë që buroj me urdhërin tënt ; se ti, ô Krisht, je shkëmbi dhe jeta, mi të cilin u-shigurua Kisha, duke thirrur : Hosanna i bekuar je ti që vien.

IV. Krishti, Perëndia jonë që vien faqeza, do të vijë dhe do të mos mënojë prej mali hieplot e të dëndur, i lindur prej Vashe të pamarrtuar, siç tha Profeti që-moti. Përandaj të gjithë thërresim : Lavdî fuqisë s' ate, ô Zot.

V. Ngjit-u maj malit të Sionës ti që ungjillëzon, dhe lartësoj-e zërin me fuqî ti që lëçit Jerusalemin. Lavdërime janë folur për ty, ô qytet i Perëndisë ; paqje mi Israelë dhe shpëtim për kombet.

VI. Thirrë me ngazëllim shpirtet e të Drejtëve : Tanî një dhiat' e rê shkruhet për botën ; e le të përsëritet populli me spërkatje gjaku të perëndishmë.

VII. Ti që shpëtove Diemt' e tû Abramianë në ziarr, dhe i arratise Haldejtë që u shtinë lak të drejtëve me padrejtësî, ô Zot i përmihymnuar, Perëndî e Atërve, i bekuar je.

VIII. Ngazëlloh-u, ô Jerusalem, kremtëroni ju dashamirët e Sionës ; se erdhi Zoti i Fuqive që mbretëron më jetët ; le të falet përpara faqes së tij tërë dheu e le të thërresë : Gjithë veprat, hymnoni Zotin.

IX. Perëndia është Zoti dhe u-çfaq nër ne ; prem-

toni një të krëmte dhe eni të madhështojmë Krishtin të ngazëlluar, hymne duke thirrur me vaja e me degë : I bekuar ësht ay që vien më emërin e Zotit Shpëtimtarit tonë.

Këndohet të Dielën e Luleve.

[ANASTASEOS IMERA. TRINGËLL I.]

I. Dit' e Ngjalljes! le të ndriçohemi, ô popuj ; Pashka e Zotit, Pashka; se prej vdekjes te jeta dhe prej dheut në qiell na shpuri Krishti Perëndia jonë, duke kënduar këngë mundëse.

III. Eni të pimë një të pirë të rê, që s' del çuditërisht prej një shkëmbi të thatë, po burimin e paprishjes që kërcen prej varrit të Krishtit, më të cilin shigurohemi.

IV. Le të qëndrojë bashkë me ne Hyjfolësi Abakum më ruajtje të perëndishme dhe le të rrëfejë Engjëllin dritësiellës që thërret sheshit. Sot vien shpëtimi te bota, se u-ngjall Krishti si i tërëfuqishim.

V. Le të mëngojmë që me-natë e le t' i 'blatojmë Zotit hymnë në vënt të myrrës, dhe do t' shëkojmë Krishtin Diellin e drejtësisë që u lint jetë të gjithëve.

VI. Zbrite në më të poshtmet e dheut dhe dërmove llozet e përjetëshmë që mbanin të burgosurit, ô Krisht, dhe pas tri ditsh, si Jonaj prej balenës kërceve jashtë prej varrit.

VII. Ay që shpëtoj Diemtë prej furrës, passi u-bë njerî, pëson si i vdekshim, dhe me pësimin e tij vesh njerinë me mirhiesin' e paprishjes, Perëndi' e Atërve tanë, i vetëmi i bekuar dhe i përmilavdishim.

VIII. Kiô është dit' e zgjedhur dhe e shëntë, e para dit' e javës, mbretëresha dhe zonja, e krëmt' e të krëmteve dhe panair' i panaireve, më të cilën bekojmë Krishtin më jetët.

IX. Engjëlli i thërriste Hirëplotes : Gëzoh-u, ô Virgjëresh' e Kulluar, dhe prapë të thom, gëzoh-u ; se Biri yt u-ngjall pas tri ditsh prej varrit.

Ndriçoh-u, ndriçoh-u, ô Jerusalem i ri, se lavdi' e Zotit lindi përmi ty : Loj valle tanî dhe ngazëlloh-u, ô Sion ; dhe ti, ô Hyjlindës' e kulluar, dëfrê më ngritjen e t' yt-Biri.

Këndohet për Pashkë gjer të Dielën e të Verbërit.

[TO SOTIRI THEO. TINGËLL TËRTHOR I.]

I. Perëndisë shpëtimtare, që i hoqi udhën popullit në det me këmbë të palagura dhe përmbyti Firaunë me gjith' ushtërî, atî vetëm le t' i këndojmë, se u-lavdërua.

III. Me fuqin' e Kryqit tënt, ô Krisht, shigurô-m'a mëndjen për të hymnuar e për të lavdëruar Shestjen tënde shpëtimtare.

IV. Dëgjova famën e pushtetit të Kryqit, si u-çel Parajsa me anën e tij, dhe thirra : Lavdî fuqisë s' ate, ô Zot.

V. Duke mënguar të thërresim, ô Zot : Shpëtôna; se ti je Perëndia jonë, veç teje nukë njohim tiatër.

VI. Më qarkoj avusha, balena m' u-bë për varr, dhe unë thirra te ty njerzidashësi, dhe më shpëtoj e diathta jote, ô Zot.

VII. E bekuar është Perëndi' e Atërve tanë që shpëtoj në furrë të ziarrit Diemat këngëtorë.

VIII. Birin dhe Perëndinë, që lindi prej Atit para jetëve, dhe nër kohërat e fundit u-mishërua prej Mëmës Virgjëreshë, priftër e hymnoni, popull e përmilartësoni më gjithë jetët.

IX. Ty, Mëmën e Perëndisë përmi mëndje e arësye, që linde pa-tregim më kohë të pakohëshmin, ne besnikët me një mëndje po të madhështojmë.

Këndohet të Dielën e të Verbërit gjer më Shestjen.

[THIO KALYFTHIS. TINGËLL IV.]

I. I mbuluar prej miegulle të hyjëshme bëlbëcaku oratoroj ligjën e hyjshkruar: se, duke shkundur baltën e syrit të mëndjes, shëkon të qënin dhe nisjohet më dijën e Shpirtit, duke lavdëruar me këngë të perëndishme.

III. I dërmoj vargojt' e barkut shterp dhe sharjen e pambajtur të mirpiellores lutja vetëm e Profeteshës së motshime Anna, që u-përunj me shpirt të dërmuar te Fuqimadhi dhe Perëndi' e dijave.

IV. O Mbret' i mbretërve, ô Fialë, që linde vetëm prej Atit panisje i tillë prej të tillit, u dërgove si

mirëbërës Shpirtin tënt të njëfuqishim e të pavdekur Apostujve që këndojnë: Lavdî fuqisës'ate, ô Zot.

V. Pritni vesën e Shpirtit të frymëziarrtë, si spastrim zgjidhës të paudhësive, ô diem te dritëfytyrëshm të Kishës; se tanî ka dalë prej Sionës ligja, hir' i Shpirtit me formë gjuhërash ziarri.

VI. Si mëshirim dhe shpëtim na shkëlqeve prej Virgjëreshës, ô Zoti Krisht, që të rrëmbesh nga prishja gjithë Adamin, që ra me tërë gjindjen e tij, sikundër shpëtove Profetin Jona prej krahërorit t' egërsirës së detit.

VII. Me një zë buçiti këngë shtrumentesh për të nderuar veprën pa-shpirt të gatuar me ar; po hiri dritëprurës i Ngushëllimtarit thërret me venerim: O Trini' e vetëm, e njëfuqishme dhe pa-nisje, e bekuar je.

VIII. I zgjith vargojtë dhe e veson flagën sh'ypi i trishkëlqimshim i thearqisë; e hymnojnë Diem'ë dhe tërë ndërtesa e krijuar bekon të vetëmin Shpëtimtar dhe vepërimtar të gjithësisë si mirëbërës.

IX. Gëzoh-u, ô Mbretëreshë, ô lavdî mëmë-virgjërore; se asnjë gojë që flet, sadô e mirlëvizur dhe e ëmbël-fialtë, nukë munt të të këndojë si të ka hie; dhe ç'dô mëndje vertikohet të kupëtojë lindjen tënde; përandaj me një zë të lavdërojmë.

Këndohet më Shestje. Dhe të Dielën e Shën-Trinisë (Rushaje a Pesëdhjetore) këndohet gjithë kiô Zbritësore bashkë me këtë që vien pas.

[PONTO EKALYPSE. TINGËLL I RËNDË.]

I. Në det e mbuloj Fraunë me qerret ay që dërmon armiqtë me krahun e tij të lartë ; atî le t' i këndojmë, se është lavdëruar.

III. Rrini në Jerusalem gjer sa të vishi me fuqinë që-lartazi, u thê Nxënësve ô Krisht ; dhe unë do t' ju dërgoj një tiatër Ngushëllimtar si mua, Shpirtin t' im dhe të Atit, më të cilin do të shigurohi.

IV. Duke kupëtuar Profeti, ô Krisht, ardhjen tënde në kohën e fundit, thërriste : Kam dëgjuar pushtetin tënt, ô Zot, se ke ardhur të shpëtosh gjithë të lyerit tënt.

V. Shpirti i shpëtimit, që u-zû në bark të Profetëve nga frika jote dhe lindi mi dhenë, paqëson zëmërat e Apostujve dhe përsërit drejtërî nër besnikët ; se urdhëratat e tua janë dritë dhe paqje.

VI. I andralluar prej shqotës së kujdeseve të rrojtjes, i zhytur prej mëkatash bashkëplevatëse, dhe i hedhur te cgërsira shpirt-prishëse, si Jonaj po të thërrës, ô Krisht : Nxir-më jashtë prej thellësirës vdekje-prurëse

VII. Diemtë oshënarë që u-hodhë në furrë të ziarrit, e ndrruan ziarrë më vesë me këngët e tyre, duke thirrur kështu : I bekuar je, ô Zot, Perëndi' e Atërve tanë.

VIII. Ferra e padiegur nga ziarri, që foli në Sina, i bëri të njohur Perëndinë Moisiut bëlbëcak dhe të likzëshmë ; dhe zell' i Perëndisë tregoj të pangadhënuar prej ziarrit tre Diemtë që këndonin : Gjithë

veprat hymnoni Zotin dhe e përmilartësoni më tërë jetët.

IX. O Mëm' e pamarrtuar dhe Hyjlindëse Virgjëreshë, që linde pa pësuar prishje dhe i hove trup Fialës, mieshtërit të gjithësisë, ô enë e të pakulmëtit dhe katund' i Gatonjësit t'ënt të paanëshm, ty të madhështojmë.

Pas Rushajève « Do t' a çel gojën». Më 1 të Gushtit « Moisiu, duke përvijosur ».

[HORI ISRAIL. TINGËLL II.]

I. Vallet e Israelit, kur shkuan Detin e Kuq dhe thellësirën e notshime me këmbë të palagura, dhe panë luftarët dhe kalorësit armiq nënë det, me ngazëllim këndonin : Le t' i këndojmë Perëndisë s' onë se u-lavdërua.

III. Arka e të fortëve u-dobësua, dhe të pafuqishmit u-ngjeshnë me fuqî ; përandaj u-shigurua zëmëra ime te Zoti.

IV. Kam dëgjuar providencën tënde të lavdëruar, ô Krisht Perëndi, si linde prej Virgjëreshës që të shpëtosh prej rrejtjes atâ që të thërresin : Lavdî fuqisë s' ate, ô Zot.

V. Ti që ndave kauzin e kryehershim prej dritës, që të të hymnojnë veprat e tua në dritë, ô Krisht, drejtësoj-i udhët e mia te drita jote.

VI. Më hidhërimin t' im, thirra te Zoti; dhe më dëgjoj Perëndi' e shpëtimit t' im.

VII. Diemtë Abramianë një herë shkelë flagën e

furrës dhe, duke hymnuar, këndonin : O Perëndi' e Atërve, i bekuar je.

VIII. Diemtë në Babylonë, të flagosur prej zelli të perëndishmë, shkelë burrërisht frikësimin e shtyranit dhe të flagës ; dhe, të hedhur në mest të ziarrit, të vesuar këndonin : Gjithë veprat e Zotit, bekoni Zotin.

IX. Lindja jote u-rrëfye pa prishje ; Perëndia dolli prej gjirit tënt me trup, që u-duk mbi dhê, e u-shokërua me njerëzit ; përandaj ty, ô Hyjlindëse, të gjithë po të madhështojmë.

Këndohet më 6 të Gushtit. Një javë pas përsërî thohet « Do t' a çel gojën »

[PEPIQILMENI TI THIA DOKSI. TINGËLL I.]

I. I stolisur me lavdi të perëndishme, kujtimi yt i shëntë dhe i lumur përmblodhi të gjithë besnikët më ngazëllim, të cilët nënë kryesin' e Mariamit i këndojnë Birit tënt të vetëmlindur me valle e me tympane, se u-lavdërua lavdërisht.

III. O Krisht, urtësia dhe fuqi' e Perëndisë, që kriove dhe përmban gjithësinë, mpshtet-e Kishën të paepur dhe të patronditur ; se i Shëntë je vetëm ti i prëhuri nër Shëntorët.

IV. Thënjet dhe enigmat e Profetëve parëtreguan mishërimin tënt prej Virgjëreshës, ô Krisht ; që shkëlqimi i shkrepëtimit tënt do të dalë si dritë për kombet, dhe do t' të thërresë avusha me ngazëllim : Lavdî fuqisë s' ate, ô njerzidashës.

V. Bukurin' e perëndishme dhe të patreguar të virtyteve tënde, ô Krisht, kam për të rrëfyer ; se ti, që ndrite prej lavdisë s' ameshuar si shkëlqim i bashkameshuar dhe i njëqënurshim, si more trup prej gjiri virgjëror, lindo si diell për atâ që ishin në hie e në errësirë.

VI. Ziarri brënda te balena e detit avushë-lindura, ku hyri Jonaj, u-tregua parëkorëzim i varrimit tënt të triditëshm ; se, si shpëtoj pa-dëm si para se të përpihej, thërriste : Do t' të sakrifikoj, ô Zot, me zë lavdërimi.

VII. Mall' i perëndishmë, duke qëndruar kundër mërisë guximtare dhe ziarrit, ziarrin e vesonte, dhe qeshte për mërinë, duke folur kundër shtrumenteve muzikore në mest të flagës me lyrën e trikordhëshme të Oshënarëve me arësye të frymëzuar prej Hyjit : Perëndia jonë i lavdëruar dhe i Atërve, i bekuar je

VIII. Engjëll' i Perëndisë fuqimadhi u rrëfeu Diemve flagën, që veson Oshënarët dhe diek të pabesët, dhe Virgjëreshën e bëri burim të kryes së jetës, që rrieth prishjen e vdekjes dhe jetën për atâ që këndojnë : Vetëm Krijetarë hymnojmë ne të çpërblyerit dhe e përmilartësojmë më gjithë jetët.

IX. U-mundë kanunet e natyrës më ty, ô Virgjëresh' e pacinuar ; se lindja virgjëron, dhe me jetën vlesohet vdekja. O Hyjlindëse, Virgjëreshë pas lindjes, dhe e gjallë pas vdekjes, ti shpëton ngaherë trashëgimin tënt.

Këndohet më 15 të Gushtit, më Fietjen e Shën-Marisë. Pasandaj këndohet prapë « Do t' a çel gojën ».

FIALOR

I TERMAVE TË KISHËS

Alltar = Ἁγία Τράπεζα.
Bekimtore = Εὐλογητάρια.
'Blatë e Hyjëshme = Θεία Προσκομιδή.
Bres = Ζώνη.
Qelq' i shëntë = Τὸ Ἅγιον Ποτήριον.
Qenq = 'Αμνός.
Dëgjim = Ὑπακοή.
Der' e Bukur = Ὡραία Πύλη.
Dërgimësore = 'Εξαποστειλάρια.
Erë = 'Αήρ.
Ferri = Ἅδης.
Font = Κολυμβήθρα.
Gjashtë Psalmet = Ἑξάψαλμος.
Hirëplote = Κεχαριτωμένη.
Hyjlindëse = Θεοτόκος.
Hyjlindësore = Θεοτοκίον.
Hyjmëndës = Θεόφρων.
Hyjprindër = Θεοπάτορες.
Hyjpritës = Θεοδέγμων.
Hymni Qerubik = Χερουβικὸς Ὕμνος.
Hyrje = Εἴσοδος.
Kanun = Κανών.
Këndonjës = 'Αναγνώστης.
Kryq-ngjalljesor = Σταυραναστάσιμος.
Kungatore = Κοινωνικόν.
Kurorëzim = Στεφάνωμα.
Litani'e Madhe = Συναπτή Μεγάλη.
Litani'e Gjerë = Συναπτὴ Εκτενής.

KISH

Litani'e Vogël = Συναπτὴ Μικρά.
Lanjëtore = Νιπτήρ.
Lavdërime = Αἶνοι.
Lavdî Mëngjezore = Δοξαστικὸν Ἑωθινόν.
Lumërime = Μακαρισμοί.
Lutjesore = Παρακλητική.
Mbrëmësore = Ἑσπερινός.
Mëngjes = Ὄρθρος.
Mimëngë = Ἐπιμανίκιον.
Myrrëprurëse = Μυροφόροι.
Ndënjësore = Κάθισμα.
Ngjalljesor = Ἀναστάσιμος.
Ngushëllimtar = Παράκλητος.
Paqësore = Εἰρηνικά.
Parëvarg = Προκείμενον.
Parëvënje = Πρόθεσις.
Pasvark = Ἀπόστιχον.
Përlëshim = Ἀπόλυσις.
Përlëshore = Ἀπολυτίκιον.
Prelat = Προεστώς.
Psalmi Nisëtor = Προοιμιακὸς Ψαλμός.
Sfyngjer = Μοῦσα.
Shëntërore = Ἱερόν.
Shërbesë = Ἀκολουθία.
Shkallesë = Ἀναβαθμός.
Shkurtore = Κοντάκιον.
Shtëpia = Οἶκος.
Shtijëzë = Λόγχη.
Temianicë = Θυμιατόν.
Thirrtore = Κεκραγάρια.
Tingëll = Ἦχος.
Tingëll Tërthor = Ἦχος Πλάγιος.
Tribunë e Shëntë = Ἅγιον Βῆμα.
Trini' e Shëntë = Ἁγία Τριάς.

Trishënt = Τρισάγιος.
Tërëshënt = Πανάγιος.
Urim = Εὐχή.
Urimtore = Εὐχολόγιον.
Valleja = Χορός.
Vark = Στίχος.
Vargëzime = Στιχηρὰ.
Vargëzime Ngjalljesore = Στιχηρὰ Ἀναστάσιμα.
Vargëzime të Vetëzëshme = Στιχηρὰ Ἰδιόμελα.
Vargëzime të Përshëmbëllta = Στιχηρὰ Προσόμοια.
Vlesim = Ἀροσβών.
Vlesor = Μνήστωρ.
Yllthi = Ἀστερίσκος.
Zbritësore = Καταβασίαι.

BKSH

LISTA E NDIHMËTARËVE

MAGAGAH, HAUTE ÉGYPTE

Vëllazëria Mirëbënjëse . . . . *Lira Englize* 20.—

BUKURESHT, RUMANÎ

	Copë	Dollarë
Shoqëria « Bashkimi »	56	$ 56.00

PARIS, FRANCË

Prince Aladro Kastrioti	5	5.00

BOSTON, MASS.

Nikolla Kristofor	5	5.00
Vasil Filip	5	5.00
N. Petro	2	2.00
Thimi Tasi	2	2.00
Stefan Kosta.	3	5.00
Josif Kristo	1	1.00
Kosma Joan	1	1.00
Gjergj Athanas	2	2.00
Gjergj Konda	2	2.00
Dimitri Katundi	1	1.00
Thoma Filip	1	1.00
Gjergj Filip	1	1.00
Alexandër Filip.	1	1.00
Andrea Athanas	1	1.00
Stavre Mihal.	1	1.00
Xheli Sotir	1	1.00
Vasil Stavre	1	1.00
Naci Taci	1	1.00

*

BKSH

EAST CAMBRIDGE, MASS.

« Shën Gjergj' » i Dardhës	1	1.00
« Shën Thanas' » i Dardhës	1	1.00
Dimitri E. Tsikës	1	1.00
Themistoklî Millona	1	2.00
Thoma Ktona	1	1.00
Jani Ktona	1	1.00
C. E. Ratsi	1	1.00
A. Damas	1	1.00
H. Latsi	1	1.00
Jani Isaak	1	1.00
Spiro N. Skende	1	1.08
Sotir Nitsi	1	1.00
Thoma Zengo	1	1.00
Nikolla P. Zengo	1	1.00

HUDSON, MASS.

Vëllazëria Mile	1	1.00
Andrea A. Dishnitsa	5	5.00
Rako H. Katundi	1	1.00
Mitka E. Dishnitsa	1	1.00
Sotir Kotta	1	1.00
Vëllazëria G. Anche	1	1.00
Pandeli Kristo	1	1.00
Theodos Avrazi	1	1.00
Vani Koto Tenecexhî	1	1.50
Pandeli Dishnitsa	1	1.00
Janaq Stefan Përmeti	1	1.00
Vangjel Dishnitsa	1	1.00
Ilia Kristo	1	1.00
Sotir Drenova	1	1.00

Kotsi Bratko	1	1.00
Zisi Ligor	1	1.00
Dhori Koli	1	1.00
Filip V. Econom	1	1.00
Dhori Anastas	1	1.00
Kristaq Puchi	1	1.00
Dhori Manoli	1	1.00
Thoma P. Qafëzezi	1	1.00
Loni Peristeri	1	1.00
Ilo Naum Duro	1	1.00
Mantho Grigor	1	1.00
Gaqi Bualli	1	1.00
Tacio Viska	1	1.00
Theodor Mano	1	1.00
Ilo Samara	1	1.00
Zoi Athanas Petra	1	1.00
Oncho Efthim Vera	1	1.00
Sotir V. Baze	—	0.50
Vani Thimaj	—	0.50
Mihal Dionis	—	0.50
Kosta Bostanxhî	—	0.25
Efthim Mile	—	0.25
Todi Bostanxhî	—	0.50
Spiro Anastas	—	0.25
Irak Opingaxhî	—	0.25
Themel Jani	—	0.25
D. Th. M.	—	0.25
School st. No. 22	—	0.50
Vëllazëria Misa	—	0.25
Naum Luka	1	1.00

DYSH

SOUTHBRIDGE, MASS.

Naum Stefan.	1	1.00
Lazar Kosma	1	1.00
Dimitri G. Kosma	1	1.00
Koli Tasi Naum.	1	1.00
Gjergj Tasi Naum	1	1.00
Naum-Filip	1	1,00
Klimë Dimitri	1	1.00
Lambi Kostantin	1	1.00
Lipi Jova Llënga	1	1.00
Gaqi V. Venetiku	1	1.00
Lazar Mihal	1	1.00
Andrea Berati	1	1.00
Vani A. Tërpini.	1	1.00
S. Gramo Vrashgjët	1	1.00
Nikolla A. Vithkuqi	1	1.00
Vangjo Dishnica	1	1.00
Ila Bardho	1	1.00
Leoni Karameta	1	1.00
Naum J. Prifti	1	1.00
Vasil Jovan	1	1.00
Kristo Nacho.	1	1.00
Trifon J. Markani	1	1.00
Luka Josif Prifti	1	1.00
Nikolla Kristo Boboshitsa	1	1.00
Tushi G. Marko.	1	1.00
Miti Lazar	1	1.00
Petraq S. Afezollu.	1	1.00
Jani Ochishti.	1	1.00
Pandeli Kosma	1	1.00
Jani Lubonja	1	1.00

FITCHBURG, MASS.

Simo Athanas Trebitska	1	1.00
Lipe Nikolla Trebitska	1	1.00
Spiro Nikolla Trebitska	1	1.00
Thoma Theodos Katundi	1	1.00
Thimi Theodos Katundi	1	1.00

WORCESTER, MASS.

Kristo Theodor	1	1.00

LONSDALE, R. I.

Mihal Kosmo	1	1.00

SYRACUSE, N. Y.

P. A. Sinitsa	2	2.00
Panajot G. Belkamen	1	1.00
Gjergj Marko Kotori	1	1.00
Apostol Athanas Belkamen	—	0.50
Nikolla Narto Negovan	1	1.00
Stavro A. Ekonomi	1	1.00
Apostol Gjorgji Lehova	1	1.00
Jani Z. Belkameni	—	0.50
Sterjo Gjorgji	—	0.50
Kosta Naum Negovani	—	0.50

BUFFALO, N. Y.

Vëllazëria Gaqi	1	1.00
Kristo M. Opingari	1	1.00

STONEGA, VA.

Lazar Doka	1	1.00
Mihal Ticho	1	1.00

DIJSH

Sif Gega	1	1.00
Zoj Sharra	1	1.00

CINCINNATI, O.

Mihal Vaska Rëmbetsi	1	1.00

KENNETH, IND.

Vasil V. Treni	2	2.00
Tego Dini Treni	1	1.00
N. P. Treni	2	2.00

CHICAGO, ILL.

Peter Kosta	1	1.00
Ilo Mela	1	1.00

NORTHBORO, MASS.

Kosta Vasil	1	1.00

PHILADELPHIA, PA.

Efthim G. Kondasi	1	1.00
Thimi Hondro	2	2.00
Peter A. Papa-Mihali	1	1.00
Giergj Lavda	1	1.00
Demetrio Bida	1	1.00

BIDDEFORD, ME.

Ilia Vasil Korcha	1	1.00
Gregor Adam Trebitska	1	2.00
Kosma Prift Trebitska	1	2.00
Athanas Ilia	1	1.00
S. Adam	1	1.00

PKSH

Naum Papa	1	1.00
Andon Adam	1	2·00

PORTLAND, ME.

Thoma K. Ekonom	1	1.25
Theodos Lazar	1	1.00
Andrea Naum	1	1.00
Nini F. Papa Katundi	—	0.50
Nisi i Ndrios Katundi	—	0.25
Thimi Pedro	—	0.50
S. D.	—	0.25
Kondil Dimitri Stratobërdha	—	0.50
Spire Kiritsi Goshtivishti	1	1.00
Spiro Adamid Goshtivishti	—	0.50
Pandeli Sotir Goshtivishti	—	0.25

SANFORD, ME.

Theodos Adam	1	1.00
Apostol Papa-Vasil	1	1.00
Filip Papa-Vasil	1	1.00

LEWISTON, ME.

Stavre Josif	1	1.00
Sotir Vasil Peno	1	1.00
Gjini Petro Sheku	1	1.00

SAN FRANCISCO, CAL.

Giergj N. Bochari	1	3.00
Giergj Kosta Anastas	1	3.00
Gjini Naum	1	2.00
Kristo Pr. Nikolla	1	2.00
Giergj A. Gitsi	1	2.00

BKSH

Shkëmbi i Labanovës	1	2.00
Sotir M. Koke	1	1.00
Andon D. Zugraf	1	4.00
Nasho D. Luka	1	2.00
Thoma Andrea	1	1.00
Anastas' i Roidhës	1	1.00
Anastas N. Kolonja	1	2.00
Vëllezërit Nikolla Ilia Giergj	1	2.00
Dima H. Apostolu	—	0.50
Gjini G. Vasho	1	1.00
Vëllezëria H. Tona	1	1.00
Paolo Anastas	—	0.50
Giergj N. Dimo	1	2.00
Nikolla D. Zugraf	1	2.00
Dimitri Apostolescu	1	1.50
Pando V. Andreoff	1	1.50
Vasil Nikoloff	1	2.00
Rifat Gotsi	—	1.00
Thomas John	1	1.00
Xhemal Protoprapë	—	1.00
Suleiman Fetah	—	1.00
Ibraim Biliali	—	1.00
Rystem Banushi	1	1.00
Kristo Biboli	—	1.00
Thoma Biboli	—	1.00
Theodos Biboli	1	1.00
Spiro Koka	1	2.00
Suleiman Seit	—	1.00
Spiro Dimitrescu	1	1.00
Dhamo Anastas	1	1.00
Tachi Kota Tona	1	1.00
Giergj Exark	1	2.00

DYSH

Miti Karapatachi	1	1.00
Byli Nikolla	—	1.00
Thoma Vangjeli	1	2.00
Dhespo Sterjo Kokë	—	0.50
Petro Grameno	1	2.00

ST. LOUIS, MO.

Angelo Liasko	1	1.00
Ligor G. Lavdari	1	1.00
Sotir Liasko	1	1.00
Sterjo S. Negovani	1	1.00
Koli Zambas	1	1.00
Sotir Kapuran	1	1.00
Koço Dërpo	1	1.00
Stefan Eft. Barkaj	1	1.00
Kostantin Dimitrimadhi	1	1.00
Sotir Adam Ziçishti	1	1.00
Thanas Rosho	1	1.00

MANCHESTER, N. H.

Një Shqipëtar	1	1.00

FARMINGTON, N. H.

Andrea Naum	1	1.00

SHIBIN-EL-KOM, MISIR.

	Copë	Frënga
Arqimidi D. Opari	1	5.00
Miltiadi Marko	1	5.00
Giergj Papa-Kosta	1	5.00
Spiro Dine	1	5.00
Vangiel Sotir	1	5.00
Petro Nuni	1	5.00

BKSH

Kristo Ndreko	1	5.00
Lambi Kotta	1	5.00
Dimitri Ndrichi	1	5.00
Vasil Avramushi	1	5.00

ELBASAN, SHQIPËRI

I Përnd. Arqimandrit Germanò	4	20.00
Mustafa Shqiptari Qelshitësi	1	5.00
Photius N. Papajani	1	5.00
Sifi Papa-Kostantini	1	5.00
Taqi A. Buda	1	5.00
Simon B. Poppa	1	5.00

ODESA, RUSI.

	Copë	Ruble
Pandeli Petro	1	2.00
Spiro Papa-Sotir	1	2.00
Lazar Papa-Sotir	1	2.00
Mihal Naum Shërko	1	2.00
Vangjel Lambi	1	2.00
Vani Sp. Barmashi	1	2.00
Thoma Falli	1	2.00
Koste Sotir Dënasi	1	2.00
Petro Tërpo Drënova	1	2.00
Vasil Kristo Nacho	1	2.00
Stavro Dono Polena	1	2.00
Kristo Toshichi	1	2.00
Theodor Marko Dënasi	1	2.00
Lambi Pano Mborja	1	2.00
Lambi Teli	1	2.00

IRKUCKË, SIBERI

Lazar Dimitri Bezani	1	2.00
Dimo Dimitri Bezani	1	2.00
Plaku Janaq Marko Dibrani	1	2.00
Grigor « Express »	1	2.00
Kosta Thanasi Lehova	1	2.00
Vëllazëria Çote Lëngëza	1	2.00
Vëllazëria Nikote Goshtivishti	1	2.00
Spiro S. Panajoti Bezani	1	2.00
Spiro S. Panajoti « Jav' e madhe »	1	1.00
Vëllezër Kriste Rehova	1	2.00
Vangjel K. Marku « J. M. »	1	1.00
Kostantin Naum Goshtivishti	—	1.00
Dimitri Giergji Bezani	—	1.00
Rafail Naum Bukë-piekësi	—	1.00
Plaku Kosta Bullgari	—	0.50
Kara-Miço Perasi	—	1.00
Mihal Borova	—	1.00
Zisi Sterjo Bezani	—	1.00
Margarit A. Stefangazi	—	1.00
Margarit A. Stefangazi « J. M. »	1	1.00
Spiro Janaq	—	1.00
Stamul M. Goshtivishti	—	1.00
Lazar Naum Goshtivishti	—	1.00
Vëllezëria Çote Lëgaza	—	1.00
Ligor Nikolla Kreshova	—	1.00
Apostol Vasil Lali	—	1.00
Sotir Dh. Devolli	1	1.50
Dimitri K. Devolli	—	1.00
Kristo Kostantin Goshtivishti	—	1.00
Sotir Nikolla Barbaçi	—	1.00

K. D. Ziko Bezani	—		1.00
Dobri D. Hanxhia nga Sofia	—		1.00
Lazar B. Marko Bezani	—		1.00
Lazi T. Janovangjeli Bezani	—		1.00

BUKURESHT. RUMANÎ.

Andrea Alilozi	1		1.00
Ilia Stefan.	1		1.00

BKSH

BKSH

BKSH

BRUXELLES, VROMANT & Cie, IMPRIMEURS. 6-09. 518.